



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË  
MBAJTUR MË 12 SHKURT 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE  
12 FEBRUARA 2009. GODINE

SHKURT - FEBRUAR  
2009

**E enjte, 12. shkurt 2009, ora 10:00.**

**Drejtoi seancën: Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.**

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,

Para se të fillojmë punën e seancës, ju përkujtoj se seanca plenare fillon në orën 10, para dite.

Të nderuar deputetë,

I nderuari Kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare!

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 67 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Para se të fillojmë me pikat e rendit të ditës, fjalën e ka kërkuar deputeti Arsim Rexhepi, me kartelë të Agim Veliut. Mundesh edhe nga vendi, deputet! Dy minuta i ke kohë për diskutim.

ARSIM REXHEPI: I nderuar, zoti Kryetar!

Të nderuara kolege deputete dhe deputetë,

Zoti Kryeministër,

Në seancën e kaluar, kolegu ynë Nait Hasani informoi këtë Kuvend të nderuar për një kërcënim që në mënyrë të vazhdueshme i është bërë nga një eksponent i instaluar në gjyqësinë e Kosovës. Nga ajo që na informoi zoti Hasani, del se kërcënuesi i shpërfaqur si i tillë, si pasojë e angazhimit të kolegut tonë për të kundërshtuar emërimin e tij në një institucion edhe më të lartë të gjyqësisë së vendit tonë.

Si deputet dhe si koleg i zotit Hasani, ndjej të pa anashkaluara të mos e përmend këtu habinë dhe zhgënjimin tim që ky Kuvend e kaloi pa e diskutuar fare dhe pa e përfillur këtë akt sa të rrezikshëm, aq edhe sinjifikativ. I rrezikshëm, sepse është kërcënuar shteti i Kosovës, institucioni i deputetit dhe, me te, vullneti i materializuar politikisht i popullit të Kosovës. Drejtëpërdrejt, pra, është kërcënuar populli i Kosovës. Edhe më shumë domethënës është ky fakt për faktin se demaskon skema të rrezikshme dhe me valenca të dyshimta nga e kaluara e afërt e Kosovës...

KRYETARI: Për rend dite, deputet!

ARSIM REXHEPI: ... Skema këto, të cilat kanë zënë pozicione jo vetëm në hierarkinë e jurisprudencës, por edhe në atë politike, të sigurisë dhe në mjete të informimit masiv. Skema këto që lëvrinë me prirjen e tyre destabilizuese dhe shkatërrimtare, fosile të regjimit gjenocidist të Millosheviqit, individë të cilët kanë uzurpuar resorë me rëndësi të superstrukturës juridiko-politike në Kosovë, duke instaluar kështu destabilizim, sabotim dhe dështim, duke rrezikuar kështu ekzistencën dhe funksionalitetin e shtetit të Kosovës. Rasti i prokurorit nga Prizreni, që kërcënon deputetin Hasani, vë edhe njëherë në pah faktin se koha e inkubacionit të viruseve të tillë destabilizues....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe ashtu nuk je duke folur për rend dite. Ju lutem, u krye!

(Ndërhyrje e deputetit – nuk dëgjohet për transkriptim)

Unë, e di që është me rëndësi, por ju lutem, shkoni në vend! Fjalën e ka kërkuar deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari, zoti Kryetar i Kuvendit, Të nderuar qeveritarë, deputetë, Në konformitet me dispozitën e nenit 33, paragrafi 1, alineja c) dhe Rregullën 34, paragrafi 1 dhe 3, me datën 27 janar 2009 i është adresuar Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës një mocion shkrimor, krejtësisht sipas rregullave për punën e Kuvendit, ndërkaq Kryesia nuk ka vepruar sipas dispozitave të precizuara, të definuara, por se krejtësisht në kundërshtim me ato dispozita, ia ka kthyer propozuesit mocionin për ta përgatitur projektligjin, kurse është dashur, ju lutem, vetëm ta lexoj, Rregulla 34, paragrafi 1, alineja 3: Në rast se propozuesi, një deputet me 5 të tjerë, që është rasti konkret, e ka dhënë një mocion shkrimor, Kryesia atë e fut në procedurë për debat, jo më pak se 3 javë pune.

Prandaj, zoti Kryetar, unë kërkoj që kjo çështje prapë të trajtohet në Kryesi dhe të vepohet sipas rregullës së cituar. Faleminderit!

KRYETARI: Kryesia, konform Rregullores së Punës e ka dhënë përgjigjen dhe vazhdoni mbi bazën e përgjigjes që e ka dhënë Kryesia. Faleminderit! Të lajmëruar të tjerë nuk ka. Vazhdojmë me rendin e ditës.

Pika e parë e rendit të ditës për sot është:

**- Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 29 e 30 janar dhe më 2 shkurt 2009**

Të nderuar deputetë, Ju njoftoj se procesverbali dhe transkripti i seancës plenare, të mbajtur më 29 e 30 janar dhe 2 shkurt 2009, iu është shpërndarë deputetëve.

Pyes deputetët, nëse kanë vërejtje në procesverbal? Fjalën e ka kërkuar deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar! Unë e kam vetëm një vërejtje teknike, në faqen e transkriptim, më 29 e 30 janar dhe 2 shkurt, në faqet 136 dhe 137, por do t'ia dërgoj me shkrim zyrës përkatëse. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Vërejtje të tjera nuk ka. Atëherë, konstatoj se Kuvendi, me vërejtjen që e bëri deputetja, bëhet ai përmirësim në transkript, kurse në procesverbal nuk ka vërejtje, miratohet procesverbali i seancës së mbajtur më 29 e 30 janar dhe 2 shkurt 2009.

Pika e dytë e rendit të ditës është:

**- Koha për pyetje parlamentare.**

Ju njoftoj se në bazë të Rregullës 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare është 50 minuta. Procedimi i pyetjeve do të bëhet sipas kohës së parashtruar dhe sipas numrit rendor. Fillojmë me pyetjen e parë.

Deputetja Rita Hajzeraj – Beqaj, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, mund ta lexoni pyetjen!

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar!

I nderuar Kryeministër,

Para një muaji kam bërë pyetje parlamentare për Policinë e Kosovës. Ndërkohë, ju i keni rritur pagat e Policisë së Kosovës. Mua më intereson ta di se a i ka marrë Policia e Kosovës pagat për muajin janar-shkurt me rritjen që Ju e keni bërë. Dhe, më intereson ta di se kur do të realizohet Ligji për Policinë e Kosovës, i cili nuk po implementohet dhe nuk po vlerësohet ashtu siç duhet.

KRYETARI: Zoti Kryeministër?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar Kryetar i Parlamentit të Kosovës, zoti Krasniqi,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Hajzeraj, faleminderit për pyetjen tuaj! Unë, personalisht jam shumë i përkushtuar dhe shumë i dedikuar të punoj për ngritjen e mirëqenies për të gjithë oficerët e Policisë së Kosovës, pra për të gjithë policët e Kosovës. Tani e di se kemi një numër të policëve të cilët kanë nevojë për ndihmë shëndetësore, kemi një numër të oficerëve që kanë rënë në detyrë dhe ne ende nuk kemi mundësi të mirë për t'i ndihmuar familjet e tyre apo jemi në fund të procesit të zgjidhjes së problemeve të tyre.

Qeveria e Kosovës ka filluar me rritjen e pagave jo vetëm në Policinë e Kosovës, por në të gjithë segmentet e shërbimit civil. Jemi shumë të vetëdijshëm se ngritja e pagave për 10% nuk kënaq nevojën dhe kërkesat e arsyeshme të policëve të Kosovës. Por, nuk duhet harruar se Policia e Kosovës ka filluar së funksionuari më 6 shtator të vitit 1999. Që nga ajo kohë, deri më tani kemi pasur ngritje të pagave në Policinë e Kosovës vetëm tash. Pra, kemi filluar me rritjen e pagave nga Qeveria që e udhëheq unë. Qeveria që drejtoj unë ka futur në agjendë përmirësimin e kushteve të punës dhe ruajtjen e dinjitetit të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës.

Unë vlerësoj punën e çdo polici të Kosovës. Në këtë drejtim, është siguruar bazë e mirë legale me Ligjin e Policisë ku zyrtarëve policorë u garantohen disa të drejta në pagë, si shtesa në pagën bazë, kompensime dhe benificione tjera. Pastaj shtesat në pagën bazë të paraparë me Ligj janë: kompensimi për punë të rrezikshme, kompensimi për orar të punës me ndërrime, pagesa gjatë festave, pagesa për punë jashtë orarit dhe pagesa për caktim në punë të veçantë.

Kompensimet dhe benificiionet me Ligj, që janë paraparë, por nuk kufizohen janë: shpenzimet mjekësore dhe shëndetësore, shpenzimet për trajnime profesionale dhe teknike, shpenzimet jetësore për transferim të përkohshëm, pushimi me pagesë, kompensimet në raste të vdekjes, stazhi i benificuar dhe benificiionet e pensionet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër!  
Zonja deputete, ke pyetje?

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti Kryeministër!  
Unë thashë, a i kanë marrë pagat policët e Kosovës për muajin janar dhe shkurt, për të cilën ju jeni zotuar. Pyetja e parë.

Ndërsa, e dyta: Ligji për Policinë e Kosovës nuk po implementohet. Këto të cilat ju i cekët, janë në Ligjin për Policinë e Kosovës, që është miratuar në vitin 2008. Do me thënë, vitin e kaluar. Keni vetëm 6 muaj kohë për t'u stabilizuar dhe për të filluar implementimin e këtij Ligji.

Ju thatë se i keni ngritur edhe pagat e shërbyesve civilë! A është edhe gjyqësori në shërbyesit civilë? Kjo më intereson, kur pritet që këta të hyjnë tani në greva.

Dhe, zoti Kryeministër, si mendoni që marrëveshjet ad-hoc të cilat po i bëni ju vetëm në bazë të protestave dhe të kërcënimeve të grupeve të ndryshme të qytetarëve të Kosovës, ju bëni marrëveshje të tilla dhe nuk respektoni ligjin.

A mendoni se kjo është zgjidhje e problemeve të qytetarëve të Kosovës kur e dimë që, në krahasim me qeveritë e kaluara dhe në krahasim me vitet e kaluara, kostoja e jetës është shumë më e madhe se tani. Kostoja e jetës – e shportës familjare...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju, e nderuara deputete, tash hapët debat për këtë çështje, që mund të zgjasë gjatë tërë ditës. Nëse dëshironi, mund t'i argumentojmë edhe me shifra dhe fakte të gjitha përkushtimet tona, por e çmoj përkushtimin dhe interesimin tuaj për Policinë e Kosovës, ndërsa dua të theksoj se për të gjithë shërbyesit civilë nga 1 janari ka filluar rritja e pagave, por besoj që edhe ju, personalisht, siç e dinë të gjithë, unë nuk jam njeri që marr vendime as nën kërcënim, as nën diktate, por me vullnetin dhe përgjegjësinë më të lartë shtetërore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pyetja e radhës. Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete mund ta lexoni pyetjen!

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!  
Strukturat ekzistuese paralele në Kosovë janë të rrezikshme për vendin sepse cenojnë pavarësinë, integritetin dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Pyes Kryeministrin, Hashim Thaçi: Çfarë po bën Qeveria për këtë rrezik?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuar deputete, Gjylnaze,  
Jam i inkurajuar me përkushtimin tuaj të interesimit të vazhdueshëm për veri të Mitrovicës.

Atë se çka ka bërë Qeveria dhe unë deri më tani, është se kemi bërë atë punë, e cila nuk është bërë në 9 vitet e kaluara. Pra, kemi filluar me investimet e fuqishme, kemi investuar tanimë 5.5 milionë euro në infrastrukturë dhe në projekte të tjera integruese. Ka qenë sfidë veriu i Mitrovicës. Tash EULEX shtrihet në gjithë territorin e Kosovës. Institucionet

e Republikës së Kosovës gjithashtu, hap pas hapi, po shtrijnë autoritetin e kompetencat dhe do të kemi ligjshmëri të plotë në gjithë territorin e Kosovës.

E ardhmja e Mitrovicës është e ardhmja e Kosovës. Do të kemi përkushtime të pages, të stabilitetit, të integritetit, të zhvillimit ekonomik dhe krijimin e mundësive më të mira për jetë atje. Pra, institucionet e Republikës së Kosovës do të përkushtohen maksimalisht, bashkërisht me gjithë komunitetin ndërkombëtar, që të punojmë në përmirësimin dhe integrimin edhe të veriut të Mitrovicës.

Ju e dini, edhe në dogana kanë ndodhur përmirësime dhe do të kemi hapa tjerë të mëtutjeshëm dhe jam i bindur se edhe në veri do ta vëmë ligjshmërinë e plotë të Republikës së Kosovës.

Mirëpo, dëshiroj të theksoj se ende ka individë apo grupe ekstremiste që pretendojnë të ruajnë status kvon apo përfitimet nga kontrabanda në emër të çështjes nacionale serbe. Pra, këto grupe ekstremiste nuk e mbrojnë interesin serb, por i mbrojnë interesat e tyre personale e grupore, të kontrabandës që ka qenë e instaluar dhe që është goditur po nga Qeveria e Kosovës dhe do të jemi të pa kompromis edhe në të ardhmen.

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër!  
Zonja deputete, ke pyetje shtesë? Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Kryeministër, çdo qytetar i Kosovës e di që realiteti nuk është i tillë çfarë ju flisni dhe se e vërteta është ndryshe. Tani nuk mjafton më përkushtimi, por hapat konkretë. Unë pyeta konkret: çfarë keni ndërmarrë?

E dyta, po lidhem me atë që thatë për ekstremistët. Është e çuditshme që në prioritetet që i keni paraqitur ju, nuk e keni prioritet zgjidhjen e problemit të integritetit të veriut dhe, po ashtu, të shpërbërjes së strukturave paralele, duke marrë parasysh ndikimin të cilin e ka në zhvillimet në gjithë Kosovën.

KRYETARI: A ke përgjigje, Kryeministër?

KRYEMINISTRI: Unë besoj se çdo njeri që jeton në Kosovë, por edhe bota demokratike, e di se kufijtë e Republikës së Kosovës janë të paprekshëm, të pacenueshëm, të njohur dhe të pranuar ndërkombëtarisht.

Ju i dini përmirësimet që kanë ndodhur tash edhe në dogana, edhe në sistemin e drejtësisë, ku priten edhe hapa të mëtutjeshëm.

Për struktura paralele, duhet të them se tash ka ndodhur një ndryshim i madh, e nderuara deputete, Gjylnaze. Tash strukturat paralele nuk kanë asnjë rol ekzekutiv. Kanë mbetur disa njerëz me çanta të zeza e të zbrazura dhe që të përngjajnë në njerëzit e “jogurt-revolucionit” të kohës së Sllobodan Millosheviqit. Dhe, nuk do të kenë sukses!

Ndërsa, përkushtimet që pretendohen të paraqiten për zgjidhje të problemeve 60-ditëshe, 70-ditëshe, mendoj se e kanë lexuar “ollujën kroate” mbrapsht për Kosovën. Dhe, zgjidhje të problemeve, edhe në veri, do të ketë vetëm me paqe dhe jo me dhunë.

KRYETARI: Faleminderit! Ju i dini rregullat se si procedohen pyetjet dhe përgjigjet, ju lutem!

Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen!

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Parashihet që në hyrje të qytetit të Vushtrrisë, nga ana e Mitrovicës, të ndërtohet stacioni i pompave për furnizim me ujë të pijshëm të qytetarëve të kësaj komune, për të cilin projekt veç është hapur tenderi.

Vlera e këtij projekti është rreth 400.000 euro. Kryetari i komunës së Vushtrrisë dhe ekspertët e kësaj fushe në këtë komunë, kërkojnë që të anulohet tenderi për realizimin e këtij projekti, pasi që mendojnë se ndërtimi i këtij stacioni të pompave nuk do të jetë funksional dhe, si i tillë, nuk do të përmirësojë gjendjen e furnizimit të qytetit me ujë të pijes.

Pyetja ime është, zoti ministër, ku qëndron arsyeja e investimit në këtë projekt?

KRYETARI: Zoti ministër, mund të përgjigjesh!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuari, zoti Kryetar i Kuvendit!

I nderuar zoti Kryeministër,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete Pantina,

Pas marrjes së pyetjes tuaj, unë personalisht jam interesuar për të ditur detajet e këtij projekti dhe ashtu, siç thoni ju, në bashkëpunim me komunën e Vushtrrisë, ne nuk kemi gjetur arsyeshmëri që ky projekt të ekzekutohet, duke ditur se projekti tjetër i madh, në bashkëpunim me Bashkësinë Evropiane, do të ndërtohet me mbi 3.5 milionë euro dhe nuk do të kishte logjikë që 400.000 – 500.000 euro të investoheshin për të shërbyer një pjesë parciale të zgjidhjes ad-hoc, të cilat deri më tani kanë sjellë faktikisht që komuna e Vushtrrisë dhe e Mitrovicës të mos kenë ujë.

Andaj, plotësisht pajtohem me sugjerimin tuaj dhe është pajtuar edhe kryetari i Komunës. Unë, para se të vi këtu, kam folur me të personalisht me telefon dhe në buxhetin e vitit 2009 nuk ekziston financimi i atij projekti, por në buxhetin e vitit 2009, në bashkëpunim me Bashkësinë Evropiane, ne do të investojmë diku mbi 3.5 milionë në pompat e reja, përkatësisht në fabrikën e re të përpunimit të ujit, e cila do të ketë kapacitetin prej 350 litra për sekondë dhe do të jetë në gjendje të furnizojë me ujë edhe komunën e Mitrovicës, edhe të Vushtrrisë, dhe do të vjen deri në komunën e Kastriotit, kështu që shqetësimet tuaja janë marrë parasysh dhe, natyrisht, neve do të punojmë që projektin e madh ta realizojmë, jo parcialisht. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, ke pyetje shtesë? Vazhdoje!

MYRVETE PANTINA: Zoti ministër, a ka mundësi që ato mjete të barten në këtë projektin për fabrikën e ujësjellësit në Akrashticë, meqenëse parashihet që ai ujësjellës të plotësojë nevojat e qytetit 70%. Pra, a ka mundësi të bëhet rritja e kapacitetit të kësaj fabrike?

MINISTRI AHMET SHALA: Ato mjete nuk mund të përdoren në mënyrë ad-hoc. Ato mjete janë deklaruar të mbyllura në vitin 2008, por ne jemi angazhuar që në bashkëpunim

me kompaninë e Mitrovicës, në bashkëpunim me komunën e Vushtrrisë dhe të Mitrovicës dhe në bashkëpunim me Bashkësinë Evropiane ta zgjidhim problemin e ujit njëherë e përgjithmonë në mënyrën më të qëndrueshme të mundshme. Do të ketë mjete për projektin e madh. E kemi planifikuar në trevjeçarin e ardhshëm dhe çështja e ujit në këtë region do të zgjidhet njëherë e përgjithmonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pyetja e radhës, deputetja Kosara Nikoliq, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen!

KOSARA NIKOLIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Poštovani premijeru,

Obraćam vam se u ime Srpske zajednice, koja je zabrinuta povodom izgradnje nn stambenog kompleksa od strane nn lica na poljoprivrednom zemljištu izmedju dva srpska sela Lepinje i Preoca. To zemljište je isključivo poljoprivredno i u vlasništvu je poljoprivrednog dobra „Ratar“ iz Lapljeg sela, koje je izdato u zakup nn licu na 99 godina. Poljoprivredno dobro se u svim zemljama regije i u svim evropskim zakonima može koristiti samo i isključivo u poljoprivredne svrhe i u druge svrhe se ne može koristiti. Ovim činom je direktno prekršen Zakon za promovisanje i zaštitu prava zajednica i njihovih pripadnika u Republici Kosovo – videti član 2.3. pomenutog zakona, a čije kršenje direktno utiče na promenu demografske strukture stanovništva Kosova.

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete, Nikoliq,

Unë kam takuar një grup të bashkësisë serbe dhe kam biseduar edhe për këtë çështje dhe parashtrimi i pyetjes nga ana juaj vetëm sa përforcon domosdoshmërinë e zgjidhjes së kësaj çështjeje. Ne po ndërtojmë një vend demokratik, me shoqëri multietnike, me respektim afirmativ të minoritarëve dhe unë, në kuadër të Zyrës për komunitete pranë Kryeministrit, jam duke punuar në këtë drejtim dhe me hapa konkretë. Gjithashtu, edhe Ministria për Kthim. Pyetja juaj e parashtruar me shkrim është pak sa e komplikuar, sepse përmendet kompleksi i banesave nn nga persona nn, që unë nuk i njoh, por dua të potencoj për rastin që ju e potencuat. Qeveria ka marrë vendim që të shqyrtojë këtë rast se a është në kundërshtim me dispozitat ligjore apo jo. Po ashtu, Qeveria e Republikës së Kosovës është duke shqyrtuar anën legale të lejes së ndërtimit që e ka lëshuar komuna e Prishtinës dhe do të marrë masat adekuate për zgjidhjen e këtij problemi, gjithmonë në kuadër të autoritetit dhe të kompetencave që i ka Qeveria e Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, ke pyetje shtesë?

KOSARA NIKOLIĆ: Hvala, gospodine premijeru, ali ja nisam mogla da kažem da to gradi Janko Janković ili Murat Murati zbog toga što ne znamo ko to gradi. U stvari, ne zna Srpska zajednica i ne znamo da li postoji gradjevinska dozvola po urbanističkom planu.

KRYMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë do ta shikoj anën legale dhe do të marr vendim në përputhshmëri me aspektin ligjor, ndërsa dua të potencoj se në Kosovë ka territor të Kosovës dhe nuk ka pronë serbe, pronë shqiptare. Ka, pra, pronë të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Zylfije Hundozi, pyetje për ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen!

ZYLFIJE HUNDOZI: Në Raportin e progresit për Kosovën u jepet vërejtje institucioneve të drejtësisë që nuk kanë bërë strategji me të cilën do të zgjidhej çështja e përdorimit të tri palë ligjeve në gjykatat e Kosovës: të ligjeve të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë, të ligjeve të Republikës së Kosovës dhe të rregulloreve të UNMIK-ut. Njëri prej ligjeve të Republikës Federative të Jugosllavisë, i cili përmendet në këtë raport, është ai i procedurave ekzekutive.

Pyes ministren e Drejtësisë, kur do ta hartoni Ligjin për procedurat ekzekutive dhe ta sillni në Parlament?

KRYETARI: Ministre, e ke fjalën!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Faleminderit!

I nderuar Kryetar i Parlamentit të Kosovës,

I nderuar Kryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete Hundozi,

Ligji për procedurën përmbartimore numër 03/L-2008 ka qenë në procedurë parlamentare dhe i njëjti është miratuar më 02.6.2008 dhe është dekretuar me Dekretin e Presidentit të Kosovës numër DL-042-2008, datë 24.6.2008. Ky ligj është publikuar në “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës numër 33, datë 15 korrik 2008, kështu që Republika e Kosovës tani ka Ligjin e vet për procedurën përmbartimore dhe ai është duke u zbatuar.

Është e vërtetë se Komisioni i Komuniteteve Evropiane, me seli në Bruksel, në raportin e hartuar me datë 5. 11. 2008 numër SEC (2008-2697) në Raportin e progresit për Kosovën e përmend Ligjin për të cilin keni shtruar pyetjen, por unë këtë e konsideroj ose si mungesë të informatës për raportuesin, ose si gabim teknik të raportit në fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, ke pyetje shtesë?

ZYLFIJE HUNDOZI: Në përgjithësi, unë e shtrova pyetjen edhe për krijimin e strategjisë së harmonizimit të ligjeve dhe të rregulloreve të UNMIK-ut, si dhe të ligjeve të ish-Jugosllavisë dhe të ligjeve të Republikës së Kosovës. Deri tash nuk keni arritur të krijoni një strategji me të cilën do t’i eliminoni në përdorim nëpër gjykata këto ligje të ish-Jugosllavisë dhe të rregulloreve të UNMIK-ut. Krejt këto po krijojnë një konfuzion shumë të madh te gjykatësit, te avokatët dhe po i zgjasin procedurat gjyqësore dhe ky është njëri prej shkaqeve për të cilat bëhet grumbullimi aq i madh i lëndëve nëpër gjykata.

KRYETARI: Ministre?

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Unë u përgjigja në pyetjen konkrete të deputetes, kur thotë: kur do ta hartoni Ligjin për procedurën ekzekutive dhe ta sillni në Parlament. Prandaj, ju kisha lutur që si deputete t’i mbani mend ligjet që i votoni. Kurse, për ligjet e tjera, strategjinë, e tjera, për ato do të ushtroni pyetjet konkrete dhe do të merrni përgjigje.

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë me pyetjen e radhës. Deputetja Donika Kada-Bujupi, pyetje për ministrin e Arsimit, zotin Enver Hoxhaj. Deputetja nuk është këtu. As ministri, po më duket jo!

Deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministrin e Energjisë dhe të Minierave, zonjën Justina Shiroka-Pula. Ministria s'është këtu. Nëse doni, mund ta lexoni pyetjen!

NAIM RRUSTEMI: Unë e kam pyetjen e njëjtë që e kam pasur paraprakisht. Nëse dikush prej Qeverisë dëshiron të përgjigjet, është pyetje e njëjtë dhe që tregon se sa kemi humbje në Ferronikël, që unë e di, por po kam qejf ta dijë edhe populli i Kosovës, që vlerësohet diku rreth 30 milionë euro. Kështu që, po e lë për seancën e ardhshme!

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Po më vjen mirë që po e di ti. Deputeti Driton Tali, pyetje për Kryeministrin, zëvendëskryeministrin apo ministrin e Arsimit, Enver Hoxhaj. Këtu e kemi vetëm zëvendëskryeministrin prezent. Deputet, lexojeni pyetjen.

DRITON TALI: Do t'i kisha kursyer të dy zëvendëskryeministrat. Këtë pyetje po ia lë ministrit të Arsimit apo Kryeministrit, por asnjëri nuk janë këtu. Mendoj se ata janë më të thirrur për këtë pyetje.

KRYETARI: Faleminderit shumë! Deputetja Kosara Nikoliq, pyetje për ministrin e Shërbimeve Publike, zotin Arsim Bajrami. Deputete, e keni fjalën.

KOSARA NIKOLIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Poštovani ministre,

Obraćam vam se u ime manjinske zajednice u vezi načina dobijanja izvoda iz knjige rodjenih. Da li se na celoj teritoriji Kosova primenjuje ista odluka u vezi dostavljanja potrebnih dokumenata za izdavanje izvoda iz Matične knjige rodjenih. I sama sam bila izložena zahtevima za dostavljanje dodatnih dokumenata od strane šalterskih službenika zaduženih za izdavanje izvoda u opštini Priština, dok se u drugim opštinama to ne traži. Smatram da sa posedovanjem ličnih karata od strane UNMIK-a i fotokopija izvoda izdatih iz Matične knjige rodjenih pre 1999. godine, ne vidim svrhu neispunjavanja uslova za dobijanje kosovskog izvoda iz knjige rodjenih. Hvala!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar Kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuara deputete,

Faleminderit për pyetjen, edhe pse pyetja aktualisht i adresohet ministrit të Rendit, por ne kemi hulumtuar pyetjen tuaj dhe kemi përgatitur një përgjigje. Fillimisht, dëshiroj të theksoj se Qeveria e Republikës së Kosovës tani ka marrë përgjegjësi të plotë të mirëmbajtjes së librave dhe të gjendjes civile dhe furnizimit të qytetarëve me të gjitha dokumentet e gjendjes civile. Dhe, në kuadrin e procesit të reformës së administratës publike, Qeveria para ca kohësh ka miratuar edhe strategjinë e qeverisjes elektronike, e cila do t'ua lehtësojë jetën qytetarëve, sepse ata do të mund të furnizohen me dokumente personale, me certifikata të ndryshme të gjendjes civile pa pasur nevojë që të shkojnë në sportele të administratës, duke aplikuar përmes internetit nga shtëpia apo nga qendra më e afërt ku ka qasje interneti.

Sa i përket pyetjes tuaj konkrete, ju siguroj që Ministria Rendit është duke zhvilluar politika unike sa i përket formës së dokumenteve të gjendjes civile dhe këto dokumente lëshohen me forma standarde unike për të gjithë qytetarët e Kosovës, në gjuhët zyrtare në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për barazinë e gjuhëve, pa asnjë dallim në format e certifikatave të lindjes. Format e certifikatave të tjera që konstatojnë gjendjen civile, janë unike. Ministria e Punëve të Brendshme është duke

zhvilluar politikat e furnizimit të qytetarëve me dokumente të gjendjes civile dhe në këtë drejtim ne po dëshirojmë që tani edhe në pjesët ku aktualisht këto dokumente ende nuk lëshohen në formën e njohur për shkak të faktit se në disa pjesë të Kosovës këto zyre ende nuk janë në juridiksion të plotë të Qeverisë, të futen në juridiksion dhe në fakt forma dhe pajisja me këto dokumente të jetë unike për tërë territorin e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI XHEZAIR MURATI: Hvala, gospodine ministre! Da li imate dodatno pitanje? Izvolite, kolegkinice Kosara!

KOSARA NIKOLIĆ: Hvala, poštovani ministre! Ali ja ću vam reći da niste sada, momentalno, sa ovom vašom izjavom u pravu. Na teritoriji opštine Lipljan, pošto ja figuriram otuda i tamo sam rodjena, ja sam dostavila stari izvod i dobila sam novi kosovski izvod. Moja deca su rodjena u Prištini, jer ja sam živela do 99.godine u Prištini, podnela sam ista dokumenta u opštinu Priština i nisam mogla dobiti izvod iz matične knjige rodjenih. Tražili su mi da donesem kartone dece rodjenih iz bolnice. Ja to nisam bila u stanju da donesem, jer je to sve ostalo kada sam pobjegla iz Prištine. Hvala!

KRYESUESI: Ministre?

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Jam i sigurt se ministri i Rendit, përmes shërbimeve të veta do ta hulumtojnë këtë rast dhe në qoftë se ka pasur ndonjë qasje që s'ka qenë unike dhe që s'ka qenë një trajtim i barabartë i të gjithë qytetarëve, do të marrë masa të nevojshme dhe ju me siguri do të informoheni me kohë dhe me shkrim për këtë kërkesën tuaj.

KRYESUESI: Idemo na sledeće pitanje. Poslanica Sala Berisha-Shala, pitanje za ministra, odnosno ministarku energetike, koja nije prisutna. Da li ćete vi pročitati pitanje, kolegkinice Berisha-Shala?

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit! Unë po pres seancën e ardhshme dhe kur të jetë këtu ministrja e Energjisë dhe Minierave.

KRYESUESI: Idemo dalje. Poslanik Riza Smaka, pitanje za ministra Kulture, Omladine i Sporta, gospodina Valton Beqiri. Izvolite, kolega Smaka.

RIZA SMAKA: Hvala, predsedavajući!

Ministër i nderuar,

Para 8 vjetëve eshtrat e zotëri Isë Boletinit, me shokë të tij, janë sjellë në Kosovë për t'u varrosur në truallin e të parëve të tyre. Për atë qëllim ka qenë formuar Këshilli 23 anëtarësh për rivarrimin e eshtrave të Isa Boletinit. Mirëpo, deri më sot nuk është bërë ajo punë e ndershme dhe fisnike, përkatësisht nuk është kryer një nga obligimet publike për hir dhe nder të atij burri të madh të këtij vendi. Pse nuk është bërë? Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala, gospodine poslaniče! Izvolite, ministre Beqiri!

MINISTRI VALTON BEQIRI: I nderuar kryesues,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputet Smaka,

Para së gjithash, një akt solemn i rivarrimit të eshtrave të një heroi kombëtar, siç është Isa Boletini, është një ceremonial shtetëror dhe ushtarak. Marrë parasysh këtë fakt, deri më tani nuk kemi pasur mundësi të organizojmë, pra, ashtu siç duhet këtë ceremonial dhe, për këtë arsye, Ministria e Kulturës, megjithatë, që nga viti 2003, ka filluar punët dhe investimet në restaurimin e kullës së Isa Boletinit, investime të cilat kanë përfunduar dhe marrë parasysh se muaji janar është muaj kur ne përkujtojmë vrasjen e Isa Boletinit, muaji janar është, po ashtu, muaji kur është ditëlindja e Isa Boletinit, në këtë muaj, pra në muajin janar që kaloi, nuk kemi pasur mundësi ta realizojmë këtë akt solemn, meqë kemi pasur vështirësi në shtrirjen e EULEX-it, kemi pasur po ashtu ristrukturimin e Trupës së Mbrojtjes së Kosovës dhe themelimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Pra, marrë parasysh se për këtë akt solemn duhet të jetë medoemos prezente edhe struktura më e lartë shtetërore dhe ushtarake, shpresojmë se në një të ardhme të afërt do të mund të realizojmë këtë rivarrim.

Dua të theksoj se gjatë këtij viti, Ministria e Kulturës, po ashtu ka siguruar buxhet për ngritjen e shtatores së Isa Boletinit në Mitrovicë dhe, në kuadër të aktiviteteve shtesë, mund të organizohet edhe rivarrimi i këtyre eshtrave. Besoj se do të jetë një klimë më e përshtatshme për ta realizuar këtë nderim ndaj kësaj figure kombëtare dhe historike. Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala vam, ministre! Imate li dodatno pitanje?

RIZA SMAKA: Është mirë ta dimë përafërsisht, së paku, nëse datën jo, por muajin se kur Ministria e ka në agjendë këtë aktivitet të rëndësishëm, të nevojshëm dhe të dobishëm. Faleminderit!

MINISTRI VALTON BEQIRI: Unë e përmenda, edhe një herë, jo rastësisht se edhe ditëlindja, edhe përkujtimi i vrasjes së Isa Boletinit është muaji janar dhe do të ishte më i përshtatshëm si muaj për të realizuar këtë akt solemn, por megjithatë, në qoftë se realizohen të gjitha planet dhe procedurat e tenderimit të prokurimit me kohë, ne do të mundemi që deri në fund të vitit, pra, të realizojmë shtatoren e Isa Boletinit dhe ky akt – ceremonial mund të shfrytëzohet edhe për rivarrimin e këtyre eshtrave. Prandaj, është çështje e procedurave, jo çështje e dëshirës a vullnetit të ministrit.

KRYESUESI: Hvala vam, ministre! Isti poslanik, dakle gospodin Riza Smaka, pitanje za ministarku Pravde, gospodju Nekibe Kelmendi. Izvolite, poslaniče Smaka!

RIZA SMAKA: Faleminderit, kryesues!

Zonja Kelmendi, ministre e Drejtësisë,

Pyetje kuvendore për përgjigje gojore. Zonja ministre, me konsideratë ju pyes se në ç'mënyrë mund të sigurohet zgjidhja e numrit enorm të lëndëve gjyqësore, duke pasur parasysh rrjedhën e pandërprerë të lëndëve tjera në një anë, si dhe fluktuimin e kuadrove të gjyqësorit, kryesisht nëpërmjet braktisjes së tij, në anën tjetër. Faleminderit!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuari, zoti deputet Smaka,

Duhet ta pranoni se sot e ndryshuat pyetjen, sepse në pyetjen që e kam marrë, keni kërkuar sqarim për 160.477 lëndë të pakryera. Kur pritet këto që të kryhen? Nëse doni, mund t'ua lexoj pyetjen që e kam marrë.

Por, sido që të jetë, përgjigja ime është kjo. Zoti deputet, me konsideratë të lartë ju informoj, për të satën herë, se Ministria e Drejtësisë nuk i menaxhon as gjykatat e as

prokuroritë. Nëse ndonjëherë do t'i transferohen këto kompetenca, do të përgjigjet në pyetje të kësaj natyre. Sikur t'i kishte këto kompetenca Ministria e Drejtësisë, me siguri se gjendja në institucionet e drejtësisë do të ndryshonte për të mirë. Sepse Ministria e Drejtësisë ka aftësi profesionale dhe ka kapacitet kadrovik për t'i menaxhuar institucionet e drejtësisë pa interferime në vendimmarrje dhe pa e cenuar fare pavarësinë e tyre.

Meqë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës është rregulluar që Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial t'i menaxhojnë këto organe të drejtësisë, përgjigja në këtë pyetje duhet t'i adresohet Këshillit Gjyqësor e Prokurorial, i themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut numër 2005/52, datë 20 dhjetor 2005, i cili vepron sipas urdhërësës së UNMIK-ut numër 2008/2 për zbatimin e rregullores së UNMIK-ut 2006/25 mbi kornizën rregullative për sistemin e drejtësisë në Kosovë, datë 17 janar 2008, i cili Këshill duhet t'i raportojë një herë në vit Kuvendit të Kosovës për punën e institucioneve të drejtësisë.

KRYESUESI: Hvala vam, ministarka! Poslaniče Smaka, imate li dodatno pitanje?

RIZA SMAKA: Zonja Kelmendi,

Pikërisht pyetja numër 1665, e datës 9 shkurt, por ne jemi të hendikepuar se kemi krejt një minutë. Ja pasusi: Sipas të dhënave të publikuara, në tetorin e vitit 2008, vetëm në gjykatat komunale themelore ishin 160.477 lëndë të pakryera. Unë këtë e definova shkurtimisht dhe thuktë, gojarisht. Ndryshe, pyetja është korrekte, ajo pyetje të cilën e kam adresuar. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Hvala i vama! Izvolite! Idemo na poslednje pitanje, takodje, vi profesore, odnosno poslaniče Smaka. Imate poslednje pitanje za današnju sesiju pitanja, koje je upućeno zamenicima premjera, gospodinu Hajredin Kući ili Ram Manaj. Izvolite!

RIZA SMAKA: Pyetje: Gjatë pjesës së dytë të dhjetorit të vitit 2008 – DOPRI - Departamenti për operacione paqeruajtëse i OKB-së ka deklaruar publikisht pikëpamjet politike të veta, me të cilat strukturat paralele serbe ilegale i ka trajtuar legale, në një anë, ndërsa statusin politik të shtetit të pavarur të Republikës së Kosovës e ka definuar të diskutueshëm, madje çështje politike në pikëpyetje, në anën tjetër. Prapë, për të qenë ironia edhe më e madhe, madje edhe me pasoja praktike tepër të dëmshme, pikëpamjet e tilla të DOPRI-t iu kanë adresuar të gjitha strukturave institucionale të OKB-ës si interpretime, duke i quajtur ato autentike dhe qëndrime zyrtare obligative. Ky është një shqetësim, mendoj jo vetëm i imi, por i kujtdo. Kam bërë pyetje në këtë drejtim, ju lutem, dhe gjithsesi Qeveria si operativë ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Molim režiju, da dovrši pitanje gospodin Smaka!

RIZA SMAKA: ...do të veprojë çka do qoftë në këtë drejtim? Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala vam! Evo, priprema se zamenik premijera, gospodin Hajredin Kući. Izvolite!

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti deputet!

Ne na ka ardhur një pyetje tjetër, që ka të bëjë me mospërputhshmërinë e gjuhëve zyrtare, por edhe për këtë pyetje mendoj se e dimë të gjithë, çështja e Kosovës ende nuk është

legalizuar në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, përndryshe për Kosovën dhe shtetet që e kanë njohur Kosovës çdo gjë është e qartë.

KRYESUESI: Hvala vam, zameniče premijera! Imate li dodatno pitanje? Izvolite!

RIZA SMAKA: Ju lutem! Administrata duhet të jetë përgjegjëse për këtë, sepse ne, po e zëmë që i kam disa pyetje, kam shkuar sipas kronologjisë. Pyetja e datës 9 janar të vitit 2009, duke llogaritur se ajo pyetje, më pastaj pyetja tjetër që e përmendi zotëri Kuçi. Ju lutem, zotëri kryesues, që t'i jepni urdhëresë administratës që në të ardhmen në rendin e ditës të jenë pyetjet kuvendore, në mënyrë që deputeti me të vërtetë të dijë cila pyetje është dhe të jetë i pranishëm, eventualisht, sepse po ndodh shpeshherë që nuk është. Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala i vama! U ovoj našoj arhivi ovde, stoji datum od 9. februara. Evo, takodje i ja imam ovde u arhivi. Dobro, u redu!

Dakle, zaključuje se rasprava povodom današnjih poslaničkih pitanja. Pre nego predjemo na drugu tačku, zbog tehničkih priprema, daje se 5. minuta pauze poslanicima Skupštine.

#### Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Për të filluar me pikën e rendit të ditës në fjalë, ka kuorum. Momentalisht prezentë janë 82 deputetë. Prandaj, po fillojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

### **3. Zgjedhja e Avokatit të Popullit**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me rregullat e procedurës së Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, ka shqyrtuar propozimin e Panelit rekrutues për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit dhe rekomandimin me emrat e tre kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit, të renditur sipas alfabetit të mbiemrit, ia ka proceduar Kryesisë së Kuvendit.

Zotërinj deputetë, uluni nëpër vende dhe mundësisht përcillni seancën!

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2009, ka shqyrtuar rekomandimet e Komisionit dhe i ka proceduar për shqyrtim në seancë plenare. Rekomandimi i Komisionit, së bashku me tre emrat e kandidatëve, u është shpërndarë deputetëve.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, zotin Bahri Hyseni, që t'i shpjegojë procedurat e rekrutimit të kandidatëve dhe ta arsyetojë rekomandimin e Komisionit.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, duke u bazuar në nenin 134 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në Rregullën 9 të rregullave të procedurës së

Kuvendit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, duke pasur parasysh rëndësinë e Avokatit të Popullit si institucion, të cilën rëndësi ia ka dhënë Kushtetuta e Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh rëndësinë që ky institucion mbron të drejtat dhe liritë e individëve të atakuar nga veprimet e paligjshme të autoriteteve publike, dhe duke pasur parasysh që një kohë të gjatë kjo detyrë ushtrohet nga ushtruesi i detyrës, duke marrë për bazë edhe përfundimin e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, të datës 18 nëntor 2008, në të cilin kërkon që Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në bashkëveprim me Komisionin për të Drejtat e Njeriut, si komisione të përhershme, të marrin dhe bashkërisht të formojnë panelin rekrutues për Avokatin e Popullit, duke u bazuar në procedurat ekzistuese dhe brenda afatit të paraparë, kemi formuar panelin rekrutues. Paneli rekrutues është i përbërë nga të gjitha grupet parlamentare të cilat janë në Kuvend. Panelin rekrutues e ka udhëhequr kryetari i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione në Kuvendin e Kosovës, zoti Ismet Beqiri.

Gjatë vlerësimit edhe të CV-ve të kandidatëve, por edhe gjatë intervistës Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione dhe Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi e kanë mbështetur edhe Zyra e Komisionarit të lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Zyra e Sekretarit të Këshillit të Evropës, e kanë mbështetur edhe të gjitha organizatat të cilat e mbështesin Kuvendin e Kosovës, por në veçanti përfaqësuesit e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian, përfaqësuesit e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut. Me rastin e intervistimit, Komisioni Intervistues ka përdorur rregulla unike për të gjithë kandidatët, natyrisht, që në këto rregulla rol të rëndësishëm kanë pasur edhe mekanizmat që e kanë mbështetur procesin dhe Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi i kanë hartuar një raport përfundimtar, raport i cili ka dalë nga rezultatet që i kanë treguar kandidatët me rastin e intervistimit. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, pasi ka marrë raportin përfundimtar nga Komisioni Intervistues, më datën 20 janar 2009 e ka shqyrtuar raportin me të gjitha propozimet që kanë ardhur dhe duke u bazuar në rregullat për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, duke u mbështetur në vlerësimet të cilat i ka dhënë Komisioni në fjalë, i rekomandon Kuvendit të Kosovës këta kandidatë për Avokat të Popullit:

- Hilmi Jashari
- Diana Toska dhe
- Veton Vula.

Natyrisht, rekomandimi është bërë duke u mbështetur në bazë të alfabetit të mbiemrit, duke u bazuar në Rregullën 9.7.

Kandidatët e propozuar i plotësojnë kriteret sipas rregullave aktuale që janë në fuqi, prandaj unë shfrytëzoj rastin që në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi t'i falënderoj të gjithë ata që cilët kanë ndihmuar në këtë proces dhe në veçanti falënderoj Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, i cili e ka udhëhequr procesin rekrutues, kurse kandidatëve të propozuar u uroj sukses! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hyseni!

Njoftoj deputetët se votimi është i fshehtë dhe deputeti ka mundësi të votojë për njërin nga kandidatët e propozuar nga Komisioni. Për zbatim të procedurës së votimit, ftoj shefat e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtar të Komisionit votues. Komisioni votues do të mbështetet prej dy zyrtarëve të Administratës së Kuvendit. Zoti Buja, në emër të PDK-së, e keni fjalën!

RAMË BUJA: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së propozoj Hajredin Hysenin.

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, e ka fjalën deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në emër të Grupit Parlamentar LDK-së, deputeti Ismet Beqiri.

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, zoti Makolli e ka fjalën!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, propozojmë deputeten Suzan Novobrdaliu.

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e ka fjalën zoti Gjini

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Nga Grupi Parlamentar i AAK-së, deputeti Rasim Selmanaj.

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, zoti Zeneli e ka fjalën!

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, propozoj deputetin Naser Rugova.

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, zonja Şinik e ka fjalën!

MYFERA ŞINIK: “7+” Parlamentar grupundan Şpresa Murati.

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, zoti Stojanoviq.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući,

U ime Parlamentarne grupe SLS, predlażemo poslanicu Kosara Nikolić. Hvala!

KRYESUESI: Hvala!

Në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, e ka fjalën zoti Petković!

SLAVIŠA PETKOVIĆ: U ime Parlamentarne grupe „Zajedno“, predlażemo poslanika Dragišu Mirić.

KRYESUESI: Hvala!

Sipas kësaj, konstatoj se Komisionin e përbëjnë 8 grupe parlamentare dhe 8 kandidatë. Në Komision janë: Hajredin Hyseni, Ismet Beqiri, Suzan Novobrdaliu, Rasim Selmanaj, Naser Rugova, Şpresa Murati, Kosara Nikolić dhe Dragiša Mirić.

Komisioni votues, siç e thashë, do të mbështetet nga dy zyrtarë të Administratës së Kuvendit. Ftoj deputetët që sipas ftesës nga listat, t'i marrin fletëvotimet. Pas çdo rrethi të

votimit, konstatohet rezultati sipas raportit të Komisionit, domethënë kjo është pas votimit.

Ftoj Komisionin që të jenë prezentë te tavolina ose kutia e votimit, gjatë gjithë kohës të monitorojnë dhënien e fletëve të votimit që të mos i jepen dikujt dy fletëvotimi, pra ta mbikëqyrin votimin dhe numërimin.

Sipas radhës, ftoj deputetin:

- Adem Grabovci, për votim,

Ftoj deputetin:

- Adem Hajdaraj,

Deputeti:

- Adem Salihaj,

Deputeti:

- Agim Veliu,

Deputeti:

- Ahmet Isufi,

Deputeti:

- Ali Lajçi,

Deputeti:

- Alush Gashi,

Deputetja:

- Anita Morina, mungon,

Deputeti:

- Ardian Gjini,

Deputeti:

- Armend Zemaj,

Deputeti:

- Arsim Bajrami,

Deputeti:

- Arsim Rexhepi,

Deputeti:

- Bahri Hyseni,

Deputeti:

- Bajram Kosumi,

Deputeti:

Deputeti:

- Behgjet Pacolli, mungon,

Deputeti:

- Berat Luzha,

Deputeti:

- Berim Ramosaj, mungon,

Deputetja:

- Besa Gaxherri,

Deputeti:

- Bojan Stojanović,

Deputeti:

- Bransilav Grbić,

Deputeti:

- Bujar Bukoshi,

Deputetja:

- Donika Kadaj, mungon,  
Deputeti:  
- Dragiša Mirić,  
Deputeti:  
- Drita Kadriu, mungon,  
Deputeti:  
- Drita Maliqi,  
Deputeti:  
- Driton Tali,  
Deputeti:  
- Džezair Murati,  
Deputetja:  
- Edita Tahiri,  
Deputeti:  
- Elheme Hetemi,  
Deputeti:  
- Emrush Xhemajli,  
Deputeti:  
- Enis Kervan, mungon,  
Deputeti:  
- Enver Hoxhaj, mungon,  
Deputeti:  
- Eqrem Kryeziu,  
Deputeti:  
- Esat Brajshori,  
Deputeti:  
- Etem Arifi, mungon  
Deputeti:  
- Ethem Çeku,  
Deputeti:  
- Fatmir Limaj,  
Deputeti:  
- Fatmir Rexhepi,  
Deputetja:  
- Fatmire Berisha,  
Deputeti:  
- Fehmi Mujota,  
Deputetja:  
- Flora Brovina,  
Deputeti:  
- Gani Buçinca,  
Deputeti:  
- Gani Geci,  
Deputeti:  
- Gani Koci,  
Deputetja:  
- Gjylnaze Syla,  
Deputetja:  
- Hafize Hajdini,  
Deputeti:  
- Hajdin Abazi, mungon,

Deputeti:

- Hajredin Hyseni,

Deputeti:

- Hajredin Kuçi,

Deputeti:

- Haki Shatri,

Deputeti:

- Hashim Thaçi, mungon,

Deputeti:

- Heset Cakolli, mungon,

Deputeti:

- Hydajet Hyseni,

Deputeti:

- Ibrahim Gashi, mungon,

Deputeti:

- Ibrahim Makolli,

Deputeti:

- Ibrahim Selmanaj,

Deputeti:

- Ismet Beqiri.

Ju lutem, vazhdoni me votimin. Lus anëtarët e Komisionit që të mos bëjnë muhabet në tavolinë!

Deputeti:

- Jakup Krasniqi, mungon,

Deputetja:

- Kaçusha Jashari,

Deputeti:

- Kolë Berisha,

Deputetja:

- Kosara Nikolić,

Deputeti:

- Dragan Dimić

Deputetja:

- Luljeta Shehu,

Deputeti:

- Lulzim Zeneli,

Deputeti:

- Lutfi Haziri,

Deputeti:

- Mahir Yagcilar,

Deputeti:

- Mark Krasniqi,

Deputetja:

- Melihate Tërmkolli,

Deputeti:

- Memli Krasniqi, mungon,

Deputeti:

- Mihaillo Shqepanoviq,

Deputetja:

- Mimoza Ahmetaj

Deputeti:

- Myfera Shinik,  
Deputeti:  
- Mursel Halili,  
Deputetja:  
- Myrvete Pantina  
Deputetja:  
- Myzejene Selmani,  
Deputeti:  
- Naim Maloku,  
Deputeti:  
- Naim Rrustemi, mungon,  
Deputeti:  
- Nait Hasani,  
Deputeti:  
- Naser Osmani,  
Deputeti:  
- Naser Rugova,  
Deputetja:  
- Nekibe Kelmendi,  
Deputetja:  
- Nerxhivane Dauti,  
Deputeti:  
- Nexhat Daci,  
Deputetja:  
- Njomza Emini, mungon,  
Deputeti:  
- Numan Baliq,  
Deputetja:  
- Nurishahe Hulaj,  
Deputetja:  
- Qamile Morina,  
Deputeti:  
- Radmilla Vujoviq,  
Deputeti:  
- Ramadan Avdiu,  
Deputeti:  
- Ramadan Gashi,  
Deputeti:  
- Ramë Buja,  
Deputeti:  
- Ramë Manaj,  
Deputeti:  
- Rasim Selmanaj,  
Deputetja:  
- Rita Hajzeraj  
Deputeti:  
- Riza Smaka,  
Deputeti:  
- Rrustem Mustafa,  
Deputeti:  
- Sabri Hamiti,

Deputeti:  
 - Sadik Idriz,  
 Deputetja:  
 - Safete Hadergjonaj,  
 Deputetja:  
 - Sala Berisha- Shala,  
 Deputetja:  
 - Sanije Aliaj,  
 Deputetja:  
 - Selvije Halimi,  
 Deputeti:  
 - Shkumbin Demaliaj,  
 Deputeti:  
 - Skënder Hyseni, mungon,  
 Deputeti:  
 - Sllavisha Petković,  
 Deputeti:  
 - Sllobodan Petrović, mungon,  
 Deputetja:  
 - Shpresa Murati,  
 Deputetja:  
 - Suzan Novobrdaliu,  
 Deputetja:  
 - Synavere Rysha,  
 Deputetja:  
 - Teuta Hadri,  
 Deputetja:  
 - Vezira Emrush,  
 Deputeti:  
 - Vlladimir Todorović,  
 Deputetja:  
 - Vlora Çitaku, mungon,  
 Deputeti:  
 - Xhevdet Neziraj,  
 Deputeti:  
 - Zafir Berisha,  
 Deputeti:  
 - Zef Morina,  
 Deputeti:  
 - Zylfi Merxha,  
 Deputeti:  
 - Jakup Krasniqi,  
 Deputetja:  
 - Zylfije Hundozi,  
 Deputeti:  
 - Xhavit Haliti.

Lus Komisionin që emrat e atyre të cilët votohen, të thuhet nëpërmjet mikrofonit, me qëllim që edhe opinioni ta shohë mënyrën se si po procedohet.

(Konsultim)

( Kryesuesi i Komisionit votues, zoti Ismet Beqiri, i numëroi me zë votat një nga një, në prani të Komisionit)

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, konstatoj që Komisioni ka përfunduar punën e tij. Ftoj zotin Beqiri që ta komunikojë rezultatin e votimit.

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që ta lexoj këtë raport për rezultatet e votimit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit.

Në mbështetje të nenit 134.1 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe të Rregullës 11, të Rregullave procedurale të Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të Avokatit të Popullit, datë 21 qershor 2007, Komisioni votues në përbërje nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare:

- Hajredin Hyseni,
- Ismet Beqiri,
- Suzan Novobrdaliu,
- Rasim Selmanaj,
- Naser Rugova,
- Shpresa Murati,
- Kosara Nikoliq dhe
- Dragan Miriq,

Ky komision për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, me votim të fshehtë të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 12 shkurt 2009, pas numërimit të votave, konstatoi, si vijon:

Në votim kanë marrë pjesë 103 deputetë. Rezultatet e votimit janë kështu:

- Për Hilmi Jasharin kanë votuar 15 deputetë,
- për Diana Toskën, kanë votuar 28 deputetë,
- për Veton Vulën 31 deputetë,

Të pavlefshme janë 29 fletëvotime.

Në bazë të rezultateve të votimit të parë, në pajtim me nenin 134, paragrafi 1 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të Rregullës 11 të rregullave të procedurës së Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe të Rregullës 31.3 të Rregullores së Punës së Kuvendit, konstatohet se në pajtim me Rregullën 11.2, kandidati Hilmi Jashari hiqet nga lista e votimit për xhiron tjetër dhe vazhdohet me dy kandidatët e mbetur, zotin Veton Vula dhe zonjën Diana Toska.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Sipas rregullave që i lexoi kryesuesi i Komisionit, ne duhet ta përsërisim tani votimin dhe për ta përsëritur atë na duhen 10 minuta pauzë. Fiks në orën 12,45 fillojmë me votimin e dytë për dy kandidatët e mbetur.

Siç e dini, është e domosdoshme që njëri nga kandidatët t'i fitojë 61 vota.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,  
Po fillojmë me votimin e dytë për dy kandidatët e mbetur.

Ftoj anëtarët e Komisionit që të përgatiten sipas procedurave paraprahe për të filluar me votimin.

Ju lus që të konstatooni numrin e deputetëve në sallë. Anëtarët e komisionit ju lutem. Ok, përcillni ju të tjerët derisa të bëhen...

Atëherë, fillojmë.

- Adem Grabovci,
- Adem Hajdaraj,

Siç e thashë, do të votohet për dy kandidatët. Nëse edhe tani nuk i fiton 61 vota asnjëri nga kandidatët, përsëritet ose ai që ka fituar më shumë vota, futet në votim dhe i obliguar është që t'i ketë 61 vota.

- Adem Salihaj,
- Agim Veliu,
- Ahmet Isufi,
- Ali Lajqi,

Deputetët:

- Alush Gashi,
- Anita Morina, mungojnë,

Deputetët:

- Ardian Gjini,
- Armend Zemaj,

Deputetët:

- Arsim Bajrami,
- Arsim Rexhepi,

Deputeti:

- Bahri Hyseni,

Deputetët:

- Bajram Kosumi,
- Behgjet Pacolli, mungojnë të dytë,

Deputetët:

- Berat Luzha,
- Berim Ramosaj,

Deputetët:

- Bojan Stojanović,
- Branislav Grbić,

Deputetët:

- Bujar Bukoshi,
- Donika Kadaj, mungon,
- Dragiša Mirić,

Mos i jepni fletëvotimet pa i thirr unë, ata që kanë munguar në fund votojnë, tash askujt pa e thirr me emër, nuk ia jepni fletëvotim.

Deputetët:

- Drita Kadriu,
- Drita Maliqi,

Deputetët:

- Driton Tali,
- Džezair Murati,

Deputetët:

- Edita Tahiri,
- Elheme Hetemi,

Deputetët:

- Emrush Xhemajli,
- Enis Kervan, mungojnë të dytë,

Deputetët:

- Enver Hoxhaj, mungon,
- Eqrem Kryeziu,
- Esat Brajshori,

Deputetët:

- Etem Arifi, mungon,
- Et'hem Çeku,
- Fatmir Limaj, mungon,
- Fatmir Rexhepi,

Deputetët:

- Fatmire Berisha,
- Fehmi Mujota,

Deputetët:

- Flora Brovina,
- Gani Buçinca, mungon,
- Gani Geci,

Deputetët:

- Gani Koci,
- Gjylnaze Syla,

Deputetët:

- Hafize Hajdini,
- Hajdin Abazi, mungon,
- Hajredin Hyseni,

Deputetët:

- Hajredin Kuçi, mungon,
- Haki Shatri,
- Hashim Thaçi, mungon,
- Heset Cakolli, mungon,
- Hydajet Hyseni – Kaloshi,

Deputetët:

- Ibrahim Gashi,
- Ibrahim Makolli, mungojnë,

Deputetët:

- Ibrahim Selmanaj,
- Ismet Beqiri,

Zoti Beqiri, a doni të votoni?

Deputetët:

- Jakup Krasniqi,
- Kaqusha Jashari,

Deputeti:

- Kolë Berisha,

Deputetja:

- Kosara Nikolić,
- Dragan Dimić,

Deputetët:

- Luljeta Shehu,
- Lulzim Zeneli,

Deputetët:

- Lutfi Haziri,
- Mahir Yagcilar,

Deputetët:

- Mark Krasniqi,
- Melihate Tërmkolli,

Deputetët:

- Memli Krasniqi, mungon,
- Mahailo Šćepanović,
- Mimoza Ahmetaj,

Deputetët:

- Myfera Shinik,
- Mursel Halili,

Deputetët:

- Myrvete Pantina,
- Myzejene Selmani,

Deputetët:

- Naim Maloku,
- Naim Rrustemi, mungon,
- Nait Hasani, mungon,
- Naser Osmani, mungon,
- Naser Rugova,

Deputetët:

- Nekibe Kelmendi,
- Nerxhivane Dauti,

Deputetët:

- Nexhat Daci,
- Njomza Emini, mungojnë,

Deputetët:

- Numan Balić,
- Nurishahe Hulaj,

Deputetët:

- Qamile Morina,
- Radmila Vujović,

Deputetët:

- Ramadan Avdiu,
- Ramadan Gashi,

Deputetët:

- Ramë Buja,
- Ramë Manaj,

Deputetët:

- Rasim Selmanaj,
- Rita Hajzeraj,

Deputetët:

- Riza Smaka,
- Rrustem Mustafa, mungon,
- Sabri Hamiti,

Deputetët:

- Sadik Idriz,
- Safete Hadërgjonaj,

Deputetët:

- Sala Berisha – Shala,
- Sanije Aliaj,

Deputetët:

- Selvie Halimi,

- Shkumbin Demaliaj, mungon,
- Skender Hyseni, mungon,
- Slaviša Petković,

Deputetët:

- Slobodan Petrović, mungon,
- Špresa Murati,
- Suzan Novobrdaliu,

Deputetët:

- Synavere Rysha,
- Teuta Hadri,

Deputetët:

- Vezira Emruš,
- Vladimir Todorović,

Deputetët:

- Vlora Çitaku, mungon,
- Xhevdet Neziraj,
- Zafir Berisha,

Deputetët:

- Zef Morina,
- Zylfi Merxha,

Deputetja:

- Zylfije Hundozi,

Kush është kthye në sallë që nuk ka votua, Emrush Xhemajli, Ibrahim Makolli, ku mbet, a ka ndonjë që nuk ka votuar. Mirić, deputeti Dragiša Mirić,

Deputeti:

Khavit Haliti.

Unë i kisha lutur deputetët që të mos e lëshojnë sallën me qëllim që ta bëjmë numërimin shpejt dhe të fillojmë në qoftë se ka nevojë procedurën e dytë të votimit. Faleminderit!

Zoti Beqiri e ka fjalën si kryesues i Komisionit.

(Kryesuesi i Komisionit votues, zoti Ismet Beqiri, i numëroi me zë votat një nga një, në prani të Komisionit)

KRYESUESI: Zoti Beqiri, e ka fjalën për ta komunikuar rezultatin e votimit të dytë.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në mbështetje të nenit 134 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Rregullës 11 të rregullave të procedurës së Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të Avokatit të Popullit, datë 21 qershor 2007, Komisioni

votues në përbërje nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare, nuk po i lexoj emrat se i keni marrë vesh, pra, për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, me votim të fshehtë të deputetëve në Kuvendin e Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 12 shkurt 2009, pas numërimit të votave konstatohet, si vijon:

Në votim kanë marrë pjesë 89 deputetë.

- Për Diana Toskën, kanë votuar 26 deputetë,
- për Veton Vulën, kanë votuar 40, deputetë,
- të pavlefshme janë 23 fletëvotime.

Pra, në bazë të rezultateve të votimit të dytë, shkohet në rundin e tretë me kandidatin, zotin Veton Vula. Faleminderit!

Është e qartë që janë përcaktuara procedurat, duhet t'i ketë 61 votë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryesues i Komisionit!

Tani besoj që për një minutë dy fletëvotimet e reja vinë edhe ta vazhdojmë votimin dhe ta përfundojmë si proces. Duhet të votojmë për njërin kandidat, në qoftë se i fiton 61 vota, zgjidhet, kjo kupton shumicën e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Në qoftë se nuk e fiton, atëherë sipas Ligjit, sipas procedurave, konkursi përsëritet. Kryesia duhet të shpall konkurs të ri. Uroj që ta zgjedhin.

(Ndërprerje e incizimit)

Të nderuar deputetë, deputete, po fillojmë, po përgatitemi të fillojmë votimin e tretë. Lus Komisionit që të zë vendin për të mbikëqyrë votimin, dhe sekretarinë që të bëhet gati me listat

Po fillojmë, pra, me rrethin e tretë të votimit për zgjedhjen e Ombudspersonit. Tani është vetëm një kandidat, zotëri vula. Votohet sipas shemës “për” ose “kundër” dhe fillojmë menjëherë me procesin.

- Adem Grabovci,
- Adem Hajdaraj
- Adem Grabovci, mungon
- Adem Salihaj

Deputët

- Agim Veliu,
- Ahmet Isufi,

Deputetët:

- Ali Lajqi,
- Alush Gashi

Deputetët:

- Anita Morina,
- Ardian Gjini,
- Anita, mungon,

- Armend Zemaj,

Deputetët:

- Arsim Bajrami,
- Arsim Rexhepi, mungojnë të dytë,

Deputetët:

- Bahri Hyseni,
- Bajram Kosumi,

Deputetët:

- Behgjet Pacolli,
- Berat Luzha, mungojnë,

Deputetët:

- Berim Ramosaj,
- Besa Gaxherri, mungojnë,

Deputetët:

- Bojan Stojanović,
- Branislav Grbić,

Bojan Stojanović, mungon,

Deputeti:

- Bujar Bukoshi,

Deputetët:

- Donika Kada,
- Dragiša Mirić,
- Deputetja Kada, mungon,
- Drita Kadriu, mungon,
- Drita Maliqi,
- Driton Tali,

Deputetët:

- Xhezair Murati,
- Edita Tahiri,

Deputët:

- Elheme Ethem, i
- Emsush Xhamajli,

Deputetët:

- Enis Kervan,
- Enis Hoxha, mungojnë të dytë,

Deputetët:

- Eqrem Kryeziu,
- Esat Brajshori,

Deputetët:

- Ethem Arifi,
- Ethem Çeku.
- Ethem Arifi, mungon,

Deputeti:

- Fatmir Limaj, mungon,

Deputeti:

- Fatmir Rexhepi,

Deputetët:

- Fatmire Berisha,
- Fehmi Mujota,

Deputetët:

- Flora Brovina,
- Gani Buçinca

Deputetët:

- Gani Geci,
- Gani Koci,

Deputetët:

- Gjylnaze Syla,
- Hafize Ajdini,

Deputetët:

- Hajdin Abazi,
- Hajredin Hyseni,

Deputetët:

- Hajredin Kuçi,
- Haki Shatri,

Deputetët:

- Hashim Thaçi,
- Eset Cakolli
- Eset Cakolli, nuk është
- Hydajet Hyseni-Kaloshi,

Deputetët:

- Ibrahim Gashi,
- Ibrahim Makolli,
- Ibrahim Gashi, mungon
- Ibrahim Selmanaj,

Ju kisha lutur për pak qetësi, nëse bën!

Deputetët:

- Ismet Beqiri,
- Jakup Krasniqi, mungon,
- Kaqusha Jashari,

Deputeti

- Kolë Berisha,

Deputetët:

- Kosara Nikolić,
- Dragan Dimić,

Deputetët:

- Luljeta Shehu,
- Lulzim Zeneli,

Deputetët:

- Lutfi Haziri,
- Mahir Yagcilar,

Deputetët:

- Mark Krasniqi,
- Melihate Tërmkolli,

Deputetët:

- Memli Krasniqi,
- Mihajlo Šćepanović, mungojnë te dytë,

Deputetet:

- Mimoza Ahmetaj,
- Myfera Shinik,

Deputetët:

- Mursel Halili, nuk është,
- Myrvete Pantina,
- Myzejene Selmani,

Deputetët:

- Naim Maloku,
- Nait Hasani, nuk janë,
- Naim Rrustemi, nuk është këtu,

Deputetët:

- Naser Rugova,
- Naser Osmani, mungon,

Deputetet:

- Nekibe Kelmendi,
- Nerxhivane Dauti,

Deputetët:

- Nexhat Daci,

- Njomza Emini, mungojnë te dytë,

Deputetët:

- Numan Baliq,
- Nurishahe Hulaj,

Deputetët:

- Qamile Morina,
- Radmila Vujović, mungon,

Deputetët

- Ramadan Avdiu,
- Ramadan Gashi,

Deputetët:

- Ramë Buja,
- Ramë Manaj,

Deputetët:

- Rasim Selmanaj,
- Rita Hajzeraj,

Deputetët:

- Riza Smaka,
- Rrustem Mustafa, mungon,

Deputetët:

- Sabri Hamiti,
- Sadik Idriz,

Deputetët:

- Safete Hadergjonaj,
- Sala Berisha Shala,

Deputetët:

- Sanije Alijaj,
- Selvije Halimi,

Deputetët:

- Shkumbin Demalijaj, mungon,
- Skender Hyseni, mungon,

Deputetët:

- Slaviša Petković,
- Slobodan Petković,

Deputetët:

- Slobodan Petrović, mungon,
- Shpresa Murati,

Deputetët:

- Suzana Novobrdaliu,
- Synavere Rysha, mungon,

Deputetet:

- Teuta Hadri,
- Vezira Emruš,

Deputetët:

- Vladimir Todorović,
- Vlorë Çitaku, mungon,
- Xhevdet Neziraj

Deputetët:

- Zafir Berisha,
- Zef Morina,

Deputetët:

- Zylfi Merxha,
- Zylfije Hundozi,

Deputetët:

- Adem Grabovci,
- Fatmir Limaj,

Deputetët:

- Berim Ramosaj,
- Arsim Rexhepi,

A ka dikush që nuk ka votuar?

- Xhavit Haliti.

DŽEZAIR MURATI: Oni koji su zakasnili, mogu da se priključe glasanju. Izvolite, gospodine...!

- Dragan Dimić,
- Bojan Stojanović,
- Radmila Vujović.

KRYESUESI: Konstatoj se votimi ka përfunduar. Tani e thërras Komisionin që të fillojë me numrimin e votave dhe i lus deputetët që të ulen në vendet e tyre, veçanërisht ministrat.

Ju lutem, foltoren ia japni kryesuesit të Komisionit, zotit Beqiri.

(Kryesuesi i Komisionit votues, zoti Ismet Beqiri, i numëroi me zë votat një nga një, në prani të Komisionit)

KRYESUESI: Ju lutem, fjalën e ka zoti Beqiri, që në emër të Komisionit t'ua komunikojë rezultatin.

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që pas rundit të tretë ta lexoj raportin e Komisionit, i cili bëri mbikëqyrjen e votimit.

Rregulla u tha cila është, po e përsëris për hir të procedurave, rregullshmërisë në mbështetje të këtij neni, do me thënë 134, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të Rregullës 11 të Rregullave procedurale të Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të Avokatit të Popullit, datë 21 qershor 2007, Komisioni votues në përbërje nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare për zgjedhjen e Avokatit të Popullit me votim të fshehtë të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, në seancën plenare të mbajtur me 12 shkurt 2009, pas numërimit të votave, konstaton sa vijon:

Në votim kanë marrë pjesë 92 deputetë. Për zotin Veton Vula kanë votuar 37 deputetë, “Kundër” 30, të pavlefshme janë 25 fletëvotime.

Në bazë të rezultateve të votimit të tretë, në pajtim me rregullën, gjegjësisht nenin 134, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Rregullës 11, gjegjësisht Rregullave të procedurës së Kuvendit të Kosovës, për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe të Rregullës 31.3 të Rregullores së Punës së Kuvendit, konstatohet se kandidati për Avokat të Popullit, zoti Veton Vula, nuk ka fituar vota të mjaftueshme, prej 61 që është e paraparë për t’u zgjedhur Avokat i Popullit, andaj konform kësaj, i mbetet që Kuvendi, është e qartë, mbyll procesin e votimit dhe Kryesia e Kuvendit, sigurisht në të ardhmen merr vendim për rishpallje të konkursit për pozitën e Avokatit të Popullit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani, me qenë se rezultati është ky që u tha, Kuvendi e mbyllë procesin e votimit dhe Kryesia e Kuvendit, duhet të marrë vendim të ri për rishpallje të konkursit për pozitën e Avokatit të Popullit.

Ju faleminderit!

Marrim pauzë të drekës, deri në orën 16:00.

#### Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Të nderuar deputetë, ministra,  
Po vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

#### **- Rishqyrtimi i Ligjit për Avokatinë,**

Ligji për Avokatinë është miratuar në seancën plenare, të mbajtur më 20 nëntor 2008 dhe është proceduar për shpallje te Presidenti i Republikës së Kosovës.

Në pajtim me nenin 84, pika 6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Presidenti e ka kthyer në rishqyrtim Ligjin për Avokatinë.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka rishqyrtuar Ligjin për Avokatinë dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raporti me rekomandime u është shpërndarë deputetëve.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi, zotin Bahri Hyseni, që në emër të Komisionit, para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në mbledhjen e 20 dhe 27 janarit 2009 e shqyrtoi vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës, të datës 13 dhjetor 2008, për kthimin në rishqyrtim të Ligjit për Avokatinë, të miratuar nga Kuvendi në seancën plenare të 20 nëntorit 2008.

KRYESUESI: Ju lutem, nëse ka mundësi qetësi, sepse nuk po dëgjohe!

BAHRI HYSENI: U konstatua se me vendimin e Kuvendit, ligji është proceduar për t'u shpallur nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 80, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Presidenti i Republikës së Kosovës, me vendimin e përmendur, ia kthen në rishqyrtim Kuvendit të Kosovës ligjin e theksuar.

Komisioni, duke i vlerësuar thëniet në arsyetimin e vendimit të Presidentit se Ligji për Avokatinë, neni 6 pikë 1, pikë 4, paraqet kufizime që pamundësojnë regjistrimin në regjistrin e avokatëve të një grupi të caktuar të personave të interesuar për ta ushtruar detyrën e avokatit, duke analizuar këto thënie dhe theksimet e pikave 3 dhe 4 dhe me qëllim që të qartësojë dispozitën e nenit të lartpërmendur, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi në mënyrë unanime ka propozuar 2 amendamente. Prandaj, i rekomandojmë Kuvendit të Kosovës që t'i miratojë rekomandimet e propozuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Në bazë të nenit 80, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi me shumicën e votave të gjithë deputetëve, minimumi i nevojshëm 61 vota "për", vendos për miratimin e ligjit të rikthyer nga Presidenti dhe ligji përkatës konsiderohet i shpallur.

Të nderuar deputetë,

Tani po vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional të paraqitura në raport.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Amendamenti 1.

Votojmë tani.

Konstatoj se 56 vota janë "për" se një ka votuar me dorë, 5 "kundër" dhe 5 abstenime. Kanë votuar 65, prezentë janë 75 deputetë. Sipas normave kushtetuese, nuk kalon. Okej, nuk ka komente, kryetari i Komisionit po. Bahri Hyseni, në qoftë se ke ndonjë koment, urdhëro! Bahri Hyseni, fjalën e ka!

BAHRI HYSENI: Konsideroj se amendamenti duhet të kalojë, sepse e ka fituar shumicën e thjeshtë që kërkohet, nuk kërkohet shumica e deputetëve në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë e lexova nenin 4 të Kushtetutës, kryetari i Komisionit, në qoftë se është në kundërshtim me Kushtetutën për të konstatuar që ka kaluar.

Amendamenti 2.

Gati për votim. Unë nuk mund as t'ua jap, as t'ua marr të drejtat. Ju sillni deputetë më shumë, le të vijnë deputetë në sallë më shumë, le të votojnë “për” amendamentet. Pra, askush nuk ka të drejtë të flasë, as të votojë në emër të tjerëve, ju lutem! Me Kushtetutë të gjithë e kemi një votë, unë nuk di çka të bëj.

(Ndërpritet incizimi)

61 deputetë duhet të votojnë “ për” për të kaluar. Pra, tash unë nuk mund ta ndryshoj gjendjen. S'ka komente.

(Ndërpritet incizimi)

Unë dua t'ua lexoj nenin 80 të Kushtetutës, pika 4: “Kuvendi me shumicën e votave të të gjithë deputetëve vendos për miratimin e ligjit të rikthyer nga Presidenti i Republikës”, që ligji përkatësisht konsiderohet i shpallur. Unë, as ju, sot nuk mund ta ndryshojmë Kushtetutën, ju lutem!

Po, Bahri, ti si Kryetar i Komisionit, ka mundësi ta marrësh fjalën edhe dy herë, nëse dëshiron!

BAHRI HYSENI: Zoti kryesues,

Ju plotësisht keni të drejtë, por ju po kërkonಿ aprovimin e ligjit, ne po kërkojmë miratimin e amendamenteve. Është shumë e vërtetë, me rastin e amendamenteve nuk kërkohet shumica 61. Kërkohet shumica e votave e të pranishmeve që janë, kurse kur ta aprovojmë ligjin në tërësi, kërkohet që të ketë 61 vota. Prandaj, ky ishte sqarimi edhe në fillim, mirëpo mendoj që u keqkuptuam. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë i kam dy veta afër vetes që kanë obligim të ma bëjnë të njëjtën shpejtim ligjor, në qoftë se unë nuk jam në rregull. Prej tash, ne mund të vendosim ndryshe, ne mund ta trajtojmë problemin edhe një herë në qoftë se biem dakord të gjithë dhe në qoftë se ka vota në Parlament, por sipas rregullave dhe sipas Kushtetutës, amendamenti në fjalë nuk është votuar. Unë nuk mund ta ndryshoj gjendjen, ju lutem. Unë vazhdoj, e hedh në votim amendamentin e dytë të ligjit.

(Ndërpritet incizimi)

Të nderuar kolegë,

Unë po ju kuptoj drejt, sepse në qoftë se nuk i shkel të drejtat e njeriut, në qoftë se nuk është në kundërshtim me atë që po e thoni nuk ishte kthyer mbrapshtë, por konstatimi im ishte realiteti qysh u votua në sallë. Unë tjetër konstatim, më shumë vota s'munda të jap nga këtu. Tani, ndoshta, nga deputetët nuk kam qenë i qartë në shpjegimin që e kam bërë unë dhe në shpjegimin që e ka bërë Bahriu, që për t'u miratuar ligji, për t'u miratuar amendamenti duhen 61 vota, që do të thotë për të kaluar. Unë, të vetmen gjë që mund ta bëj është që të deklarohej kryetarët e grupeve parlamentare a janë për ta rikthyer në votim amendamentin në fjalë, për shkak se sqarimi nuk ka qenë, ndoshta, i nevojshëm, Ndërsa, debat unë nuk do të hap, vetëm duhet deklaruar, do të thotë, a jeni ju shefat e grupeve parlamentare që ta rikthejmë në votim amendamentin në fjalë?

Zoti Buja e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

RAMË BUJA: Zoti kryesues,

Me sa u lexua në Kushtetutë dhe sa e dëgjova, unë se nuk e kam Kushtetutën me veti, u tha që Ligji kërkon 61 vota për t'u miratuar, jo amendamenti. Nëse është kështu, atëherë domethënë amendamenti shkon me aq vota sa shkoi. Nëse është kështu, ju lutem, ju e lexuat, ligji do të duhej t'i ketë 61 vota për t'u votuar dhe për të shkuar, nëse është kështu, nuk e thatë për amendamentin, zoti kryesues.

KRYESUESI: Sabri Hamiti e ka fjalën!

SABRI HAMITI: Zoti kryesues i seancës, kolegu Xhavit Haliti, Unë mendoj që arsyeja pse mund të rivotohet, pa hezitim, dhe mendimi i Grupit Parlamentar të LDK-së është që mund të rivotohet për shkak se, ashikare, nuk ka pasur sqarim të plotë dhe ende po vazhdon diskutimi në mes deputetëve, i dyzuar në mes të asaj çka është votimi në përgjithësi i ligjit dhe i neneve. Tash, ne mendojmë që është e drejtë të rivotohet me sqarimin e plotë që kërkohen 61 vota me Kushtetutë edhe për nenet dhe deputetët le të rezonojnë. Me këtë kusht, ka arsye të plotë të rivotohet. Kaq!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Makolli, në emër të Grupit Parlamentar AKR-së.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, kryesues!

Në radhë të parë konsideroj se kur flitet për amendamentet, ka të drejtë debati. Në Kushtetutë thotë për ligjin në tërësi, ndërkaq jo për amendamentet. Dhe, e treta, që është shumë me rëndësi në këtë aspekt është, po qe se shkon ligji kështu, si është, pa ndryshim në këtë amendament, i cenon rëndë të drejtat e njeriut në Kosovë, prandaj si Komision jemi pajtuar me këtë vërejtje që ka qenë dhe konsideroj se duhet të kalojnë këto amendamente për shkak se cenojnë rëndë të drejtat e njeriut. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë ju pyeta a jeni për ta hedhur në rivotim, a jo? Okej.

Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj se arsyeja pse ekziston ky artikull në Kushtetutë, ky nen, edhe ky provizion kushtetues, është se Kuvendi ka të drejtë të mos pajtohet me një ligj që e ka kthyer Presidenti i Kosovës prapa në Kuvend dhe për ta shpallur një ligj që e ka kthyer Presidenti, Kuvendit i duhen 61 vota, e jo në rastin kur Kuvendi me shumicë të thjeshtë pajtohet me propozimin e Presidentit. Do të thotë, është një interpretim i gabueshëm i këtij provizioni kushtetues dhe unë pajtohem me zotin Hyseni, jo vetëm se nuk duhen 61 vota për nenin, por në rastin kur ne pajtohemi, nuk duhen 61 vota as për ligjin në tërësi. Do të ishin dashur 61 vota për ta kthyer propozimin e Presidentit krejt komplet mbrapsht edhe ta votojmë një ligj për të cilin Presidenti nuk është pajtuar. Ky është provizioni kushtetues për të cilin po flasim. Në fakt, unë pajtohem që të votojmë edhe një herë, nëse kemi dilema. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Zoti kryesues,

Interpretimi le të bëhet ashtu siç ekspertët mund ta vlerësojnë në mënyrë të drejtë interpretimin e Kushtetutës, mirëpo seanca plenare mori një vendim dhe votoi dhe e kemi atë rezultat çfarë e kemi. Ne nuk po ndërhyjmë cili është interpretimi i drejtë, mirëpo interpretimi le të bëhet mbi bazën e rezultatit për të cilin seanca u deklarua pak më herët.

Ne jemi kundër që çdo herë të kthehemi, pavarësisht cili është ai rezultat, pavarësisht se ai rezultat a shënon miratimin e atij amendamenti apo rikthimin. Prandaj, le të bëhet interpretimi i drejtë. Sekretarinë e keni në afërsi dhe Grupi Parlamentar i LDD-së konsideron se nuk është e drejtë dhe nuk është në të mirën tonë të krijohet një praktikë e tillë që të rikthehet në rivotim sa herë që dikush mund të kërkojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedavajući!

Mi mislimo da bi trebalo ponova da se glasa jer nije bilo dovoljno jasno. A ja imam razlog više jer nisam bio tu kad se glasalo.

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Bojan Stojanović, ju lutem ia jepjani fjalën!

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Mislim da je ovo glasanje bilo dovoljno jasno i kao jedan od razloga meni nije prihvatljivo to da nije jasno, jer se ovde radi o poslanicima. Ne radi se o nekom konkursu, pa sada da je ljudima jasno ili nejasno. To stoji u Poslovniku. Slažem se ako mi donesemo odluku da vratimo na ponovo glasanje, ali da stvarno malo uzmemo svi da proučimo taj Poslovnik i jednostavno i ako nešto ne prođe, nije toliko strašno. Tako je volja Skupštine i Skupština ima pravo da vrati sve to. Naravno, mi ćemo ovoga puta samo iz razloga pošto smo znači jedni od koalicionih partnera u Vladi, da prihvatimo to da se ponovo vrati na glasanje, ali vas molim da sledeći put takve razloge ne stavljamo kao formu da bi nešto ostvarili, da vraćamo. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, Petković.

SLAVIŠA PETKOVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Prvo, ne možete po poslovniku da vratite glasanje u nazad, jer ste vi proglasili rezultat. Sada da li je po čefu ili nije čefu, čitajte poslovnik. Ja razumem, bez da ulazimo da li amandman treba 61 glas ili ne treba 61 glas, ali malo pre, znači da se nadovežem, kada neko kaže da su ugrožena ljudska prava ako amandman ne prođe. Pa valjda su ugroženija ljudska prava kada nemamo ombuds persona 4. godine, valjda je to više ugrožena prava neko ovo. Prema tome, po poslovniku vi ne možete da vratite glasanje u nazad. Dali ste vi interpretirali to dobro, ili niste, Ustav kaže jedno, ali ne možete da vraćate nazat, vi možete u stavi, ali neće biti regularno.

KRYESUESI: Faleminderit!

Shumica është për ta rivotuar amendamentin dhe unë do ta respektoj mendimin e shumicës që ta bëjmë rivotimin e amendamentit 1 dhe të kalojmë në rivotimin e amendamentit 2. Në qoftë se interpretim ligjor dhe kushtetues mund t’i jepet ndryshe, ne e kemi edhe rezultatin e parë, dhe në qoftë se gabimi i vendimit është në kundërshtim me ligjin, atëherë kemi mekanizma tjerë të cilët, qoftë në komision këtu, qoftë më tutje, mund ta kontestojnë votimin. Me qenë se është vendim i shumicës, mua s’ më mbetet tjetër gjë përveç se ta hedh në rivotim edhe një herë. Prandaj, ju lus që ta votojmë edhe një herë amendamentin e parë të Ligjit për Avokatinë.

Regjia dhe deputetët, të bëhemi gati për votim. Regjia, ju lutem, të bëhemi gati për ta votuar amendamentin 1 për së dyti herë, duke konstatuar gjendjen edhe të mëparshme, në qoftë se ka dikush për t'u ankuar, pastaj procedurat janë të hapura.

Votojmë tani:

A ka vota pa kartelë? 2 vota.

Konstatohet që 57 vota janë “për”, 55 elektronike, 4 abstenime dhe 9 “kundër”. Kjo është gjendja, interpretimi është bërë. Unë nuk mund ta ndryshoj gjendjen më. Faleminderit!

Vazhdojmë me amendamentin 2.

Regjia, të bëhemi gati për votim. Votojmë tani:

I njëjti numër është. 57 vota “për”, 8 abstenime, 10 “kundër”.

Tani, kjo është gjendja e votimit. Unë nuk mund të konstatohet me qenë se ka mendime të kundërta. Në qoftë se duhet të konstatohet që shumica ka votuar “për” dy amendamentet në fjalë, që plotësisht po arsyetoj edhe mendimin që e tha kryetari i Komisionit, edhe zoti Makolli, edhe qëndrimin dhe mendimin e shumicës, megjithatë votat janë të tilla, unë s' mund ta ndryshoj gjendjen. Interpretimi le të jepet pastaj.

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

#### **- Rishqyrtimi i Ligjit për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare**

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të datës 30 korrik 2008, dhe të mocionit të miratuar më 3 tetor 2008 për procedim... Ju në qoftë se doni, e lëmë.

(Ndërpritet incizimi)

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Urdhëro Lulzim, e ke fjalën!

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Më herët, në pikën paraprake, kur votuam ligjin e rikthyer dhe amendamentet në fjalë prej Presidentit të Republikës, ne votuam dy amendamente, mirëpo nuk e patëm interpretimin final lidhur me atë që a kaluan amendamentet ose nuk kaluan dhe, në fund, pas votimit të dy amendamenteve, në bazë pikës 4 të nenit 80 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi është i obliguar të votojë për ligjin në tërësi, të rikthyer nga ana e Kryetarit të Republikës. Ne deri tash nuk e kemi bërë një hap të tillë, prandaj kërkojmë që të respektohet ky parim dhe neni 4, në fakt, pika 4 e nenit 80 të Kushtetutës. Ne konsiderojmë që derisa nuk është bërë një interpretim i drejtë lidhur me rezultatin i cili ka qenë për dy amendamentet në fjalë që u votuan nga seanca plenare, duhet patjetër që të votohet ligji në tërësi, për të mos lënë dualizëm nesër të interpretimit të dyanshëm, që mund të jetë pozitiv ose negativ, pavarësisht se cili trup atë e bën. Prandaj, kërkojmë që të respektohet kjo ose konsulencë, të kërkohet edhe një herë cili është interpretimi i drejtë lidhur me krejt atë që e bëri Kuvendi i Kosovës deri tash? Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit! Pasi e ka kërkuar fjalën shefi i Grupit Parlamentar të Aleancës, fjalën po ia jap Ardian Gjinit, pastaj Ibrahim Makollit dhe kështu me radhë, në fund, Bahri Hysenit.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar, edhe një herë me keqardhje që po e marr fjalën prapë.

Pa marrë parasysh cili mund të jetë interpretimi i këtij provizioni kushtetues prej cilitdo prej nesh, mendoj se konsiderohet i votuar dhe i kaluar një amendament në seancë plenare kur kryesuesi ose, në këtë rast, Kryetari i Kuvendit e konsideron se ai amendament është miratuar ose jo. Ne nuk kemi dëgjuar që një amendament ka kaluar ose jo. Nuk e kemi dëgjuar interpretimin e kryesuesit, ose tani të Kryetarit të Kuvendit, e përderisa nuk shpallet i kaluar ose i pa kaluar, ne nuk mund të procedojmë me këtë ligj më tutje. Nëse ka dilema, dilemat duhet të zgjidhen më vonë, mirëpo mendoj se dikush duhet ta marrë barrën e përgjegjësisë ligjore në Kuvend dhe të thotë se a ka kaluar amendamenti apo jo? Nëse kjo nuk ndodh, nuk ka kurrfarë logjike për të proceduar me të njëjtin ligj më tutje.

Mendoj se nëse ka, eventualisht, gabim deri më tani, procedimi i mëtutjeshëm do të jetë shkelje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit edhe prej teje! Fjalën e ka shefi i Grupit të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

E kuptoj nevojën që të hidhet ose të mos pranohet diçka që mund të vijë nga Presidenti ose të tjerët, por këtë radhë kam parasysh dhe besoj që shumë më i rëndësishëm është interesi i qytetarëve, sesa kush e ka kthyer këtë ligj në Kuvend. Po që se mbetet ligji i tillë çfarë është, cenon rënd të drejtat e njeriut në Kosovë, cenon rënd interesin e qytetarit dhe unë konsideroj se ky Kuvend, para se gjithash, është dhe duhet të jetë në funksion të interesit të qytetarit. Prandaj, po apeloj edhe një herë që të kihet kujdes sa i përket kësaj çështjeje, sepse jam shumë i bindur se po që se do të mbetet kështu, do të atakojë një pjesë mjaft të madhe të një kategorie të cilës i dedikohet ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ka të lajmëruar shumë, por unë po ju tregoj, fjalën ia jep vetëm Bahri Hysenit dhe do t'jua lexoj një pikë të Rregullores – 80 dhe e kryejmë këtë çështje.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë mendoj që pa nevojë hymë në çështjet të cilat na sollën deri në këtë situatë, sepse Kushtetuta e përcakton shumë qartë se ligji në fund duhet t'i ketë 61 vota. Ju e dini që edhe shumë ligje të tjera kërkohen të miratohen me shumicë votash, kurse amendamentet e kanë të njëjtën procedurë. Nuk po hy t'i përmend, por tani jemi në një situatë që kemi ardhur, pa nevojë ndoshta, për shkak të interpretimeve dhe nga vetë fakti se ky Kuvend u përcaktua të mos i miratojë dy amendamente, procedura përfundon këtu, sepse vërejtja ka qenë e Presidentit të Republikës së Kosovës pikërisht me një amendament dhe ne, për ta qartësuar ligjin, e kemi propozuar një amendament, i cili, edhe këtu po e them haptas, nuk e shkel shumë interesin e përgjithshëm të Kosovës...

(Ndërhyrje...)

Jo, ju lutem, Ibrahim, të dëgjohemi! Është me rëndësi se ne kemi bërë amendament, sepse e qartëson dhe dëshira jonë ishte që të kalojë amendamenti. Mirëpo, nga momenti kur u vendos që këto dy amendamente të mos kalojnë, faktikisht ligji më nuk ka çka të votohet, sepse nuk janë miratuar amendamentet dhe ligji do të hyjë në fuqi në bazë të dispozitave që hyjnë në fuqi 15 ditë pas kësaj seance plenare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Neni 80 në fakt i Kushtetutës, pika 4, thotë: “Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve (dhe shumica e votave janë 61), vendos për miratimin e ligjit të rikthyer nga Presidenti i Republikës dhe ligji përkatës konsiderohet i shpallur”. Ju i dini procedurat, ju s’e keni votuar, s’ka qenë nevoja as dy herë të votohet, por megjithatë është votuar. Përsëri s’e ka marrë numrin e nevojshëm. Pas 15 dite ligji hyn në fuqi dhe nuk votohet më në tërësi ligji, është dashur të votohen vetëm 2 amendamente. Mendoj se kjo procedurë është e qartë dhe procedurat janë të rregullta dhe s’kemi çka ta zgjasim.

(Ndërhyrje)

Jo, nuk ka mendim. Faleminderit! Ju lutem, vazhdojmë me rendin e ditës:

**- Rishqyrtimi i Ligjit për lirinë e asocimit në organizatat joqeveritare**

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, datë 30 korrik 2008 dhe të mocionit të miratuar më 3 tetor 2008 për procedimin me ligjet e pashpallura, Komisioni përgjegjës raportues ka rishqyrtuar tekstin e Ligjit për lirinë e asocimit në organizatat joqeveritare dhe Kuvendit i ka parashtruar rekomandime me amendamentet e propozuara për shqyrtim dhe miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, zotin Esat Brajshori apo raportuesen e Komisionit që para deputetëve të prezantojë raportin. Fjalën e ka deputetja Melihate Tërmkolli.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Siç e dini, ligji është miratuar në Kuvendin e Kosovës shumë vjet më parë. Ky ligj i është kthyer për rishqyrtim Kuvendit të Kosovës pasi që nuk është nënshkruar nga Përfaqësuesi Special.

Vërejtjet të cilat e kanë tanguar këtë ligj, janë vërejtje që janë sjellë nga UNMIK-u, por edhe nga një pjesë e organizatave joqeveritare, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me çështje të regjistrimit dhe të ri regjistrimit të organizatave joqeveritare.

Natyrisht që Komisioni i ka shqyrtuar të gjitha këto vërejtje dhe janë bërë zgjidhje nëpërmjet amendamentimit në harmoni të plotë me standardet ndërkombëtare dhe me praktikën më të mira të vendeve demokratike. Pra, Komisioni ka shqyrtuar dhe ka amendamentuar çështjen e regjistrimit, ri regjistrimit, por edhe ka sqaruar çështje tjera që lidhen me shuarjen apo çregjistrimin e organizatave joqeveritare.

Unë dua ta njoftoj Parlamentin që kemi një vërejtje për nenin 20, amendamenti 45. Kjo vërejtje u ka ardhur me vonesë Parlamentit të Kosovës dhe Komisionit dhe mund të them që ne paraprakisht i kemi konsultuar të gjitha organizatat joqeveritare dhe mekanizmat e tjerë, përfshirë këtu edhe organizatat ndërkombëtare, pra edhe USAID-in, e të tjerë dhe, megjithatë, Komisioni, edhe pse me vonesë i ka vlerësuar këto vërejtje mendon që duhet të tërhiqet neni 20, amendamenti 45.

Unë mund të them, po ashtu, se ka pasur një pajtueshmëri të plotë të Komisionit për Shërbime Publike, një pajtueshmëri të plotë të organizatave joqeveritare dhe, po ashtu, një pajtueshmëri të plotë edhe të përfaqësuesve të partive politike që janë në Parlament.

Mendoj që me këto amendamente mundësohet funksionimi më i mirë i OJQ-ve dhe, natyrisht, edhe zhvillimi i tyre. Kjo do të ndikojë edhe në evitimin e shumë keqkuptimeve që janë krijuar ndërmjet institucioneve shtetërore dhe organizatave joqeveritare dhe mund të themi se ky ligj është një hap i rëndësishëm i institucioneve në drejtim të evitimit të këtyre keqkuptimeve.

Nëse më lejoni, unë do të flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së dhe shpreh qëndrimin se Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah ligjin bashkë me amendamentet dhe vërejtjen të cilën e paraqita pak më herët. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Hajdin Abazi e ka kërkuar fjalën.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, zoti Kryetar! Ligjin për lirinë e asocimit në OJQ, Grupi Parlamentar i PDK-së e ka lexuar me vëmendje, i ka parë edhe të gjitha amendamentet e propozuara dhe meqenëse unë kam qenë edhe në grupin punues, dua të theksoj faktin se vërtet është punuar që ky ligj të bëhet funksional, ka zgjidh një varg konfuzionesh që janë manifestuar, siç kanë ekzistuar më parë, i rregullon shumë gjëra që më parë nuk kanë qenë të definuara dhe kanë ekzistuar mendime të paqarta.

Sa i përket amendamentit 45, ku është fjala për monitorimin e OJQ-ve, çështja ka qenë që ne kemi bërë përpjekje për të rregulluar një mënyrë se si të mund të monitorohen OJQ-të, kur e dimë faktin se në realitetin tonë ka pasur edhe OJQ që janë zënë me veprimtari jashtë programit dhe statutit të tyre dhe çështja për monitorimin është që të monitorohen sipas statutit dhe programit të OJQ-ve. Megjithatë, meqenëse ne nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë zgjidhje adekuate për këtë se cila do të jetë instanca që do të mund ta bëjë monitorimin, konsideroj se edhe pa këtë nen, do të thotë, pa nenin 20, ligji mund të jetë plotësisht funksional dhe në një të ardhme tjetër me subvencionimin nga Unioni Evropian, do të mund ta rregullojmë edhe këtë çështje. Përndryshe, të gjitha propozimet janë të bëra ashtu që kanë hequr konfliktet e mëhershme që kanë ekzistuar dhe rregullon çështjen e regjistrimit, më parë ka qenë reregjistrimi, që është hequr, si dhe çështjen e raportimit vjetor se në çfarë kushtesh mund ose duhet të çregjistrohen organizatat të cilat nuk paraqesin raportet vjetore për veprimtaritë e tyre dhe kështu mendoj se vërtet është bërë një punë e mirë dhe meriton që të votohen të gjitha amendamentet, me përjashtim të amendamentit 45 dhe Grupi i PDK-së do ta votojë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ardian Gjini, e ka kërkuar fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Duhet të pajtohem me dy kolegët parafolës. Edhe Grupi Parlamentar i AAK-së beson se ky ligj duhet të votohet si ka ardhur, e mbulon një pjesë esenciale të demokracisë në Kosovë. Po ashtu, pajtohem që neni 20, në fakt që është amendamenti 45, nuk duhet të votohet për shkak se ky amendament i jep kompetenca Qeverisë që t'i kontrollojë OJQ-të dhe në fakt esenca e ligjit është që të limitohet pushteti i shtetit ndaj OJQ-ve dhe mendoj se shteti i kryen punët e veta në mënyra të tjera dhe nuk ka nevojë që të ketë departament i cili i monitoron. Domethënë, edhe një herë të them, jemi në pajtueshmëri, përpos amendamentit 45, mendojmë se duhet të kalojnë të gjitha amendamentet dhe të kalojë ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Ibrahim Makolli e ka fjalën!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe unë po shfrytëzoj rastin që të përgëzoj Komisionin për punën që ka bërë në këtë projektligj. Po ashtu, i bashkëngjitëm mendimit se projektligji është në pajtim me standardet ndërkombëtare. Ne jemi për ta votuar, natyrisht pa amendamentin 45. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti, Lulzim Zeneli, e ka fjalën!

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i LDD-së e përkrah, do të thotë, ligjin në tërësi dhe konsideron se ky ligj i ofron të gjitha ato dispozita të cilat sot kanë munguar në rregullimin e kësaj materie. Mirëpo, kur bëhet fjalë për monitorimin e organizatave joqeveritare, këtu duhet ta kemi vetëm një çështje të sqaruar. Ka qenë kërkesë dhe gjithmonë kërkesë e vazhdueshme se në Kosovë është krijuar një segment “ojeqemania” ku nuk ka pasur monitorim të plotë rreth organizatave joqeveritare. Ne pajtohemi me konstatimin që u dha që jemi kundër asaj që të vendoset strikt rregulla rreth monitorimit që Qeveria të ketë tendencë që të vendosë kontroll apo dikush tjetër, mirëpo tendencë e vazhdueshme ka qenë dhe kërkesë që ka nevojë për atë se çka është duke ngjarë, që nën firmën e organizatave joqeveritare kemi pasur aktivitete të cilat kryekëput kanë qenë të kundërligjshme. Mirëpo, këtu unë po shoh që në grupet punuese, ku kam qenë edhe unë në grupin punues, ka pasur debat dhe komente nga më të ndryshmet. Është mirë që kjo çështje të sqarohet për arsye se në qoftë se vazhdohet që t’iu ikin përgjegjësi dhe edhe institucionet e vendit t’iu ikin përgjegjësi për atë se çka është duke ngjarë, atëherë kemi të bëjmë me diçka tjetër që tërësisht deri sot kemi pasur veprimtari jashtë çdo kontrolli dhe institucionet e vendit nuk kanë pasur qasje se çka është duke ngjarë në segmente të caktuara, ku nën firmën e OJQ-ve ka pasur veprimtari kryekëput ilegale. Prandaj, konsideroj që me këtë ligj është vendosur një bazë e mirë, mirëpo rreth çështjes së nenit 45, amendamentit 45, Grupi Parlamentar i LDD-së do të abstenojë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti i fundit që e ka kërkuar fjalën, është deputeti Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryetar! Ndoshta pak edhe në cilësinë e kryetarit të Komisionit dhe si deputet falënderoj grupin punues të Komisionit, shoqërinë civile për kontributin që e kanë dhënë. Fjala është për amendamentin 45 që ka ardhur me vonesë një vërejtje. Realisht, mbështes parafolësin në lidhje me atë funksionimin e disa OJQ-ve. Unë mendoj se edhe nëse e tërheqim këtë amendament dhe do ta tërheqim, ky është edhe qëllimi i referueses, se herët a vonë përsëri do të shtrohet çështja se si funksionojnë disa OJQ? Ne kemi pa një terren të ngatërruar të punëve të tyre dhe për këtë arsye kemi dashur që të vëmë një rregull më tepër, jo të kontrollojmë diçka ose... Sido që të jetë, falënderoj grupin punues dhe ne si grup parlamentar jemi që të tërhiqet ky amendament, ndërsa tjerët të votohen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bojan Stojanović e ka kërkuar fjalën.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke će podržati ovaj zakon sa amandmanima. Naime, ja sam hteo da pričam o tom članu 45. zato što, da se ne vraćamo, svi to dobro znamo da je ovde bila, što je i prethodni govornik rekao „enveomanija“, znači bavili su se svim i svačim. Jednostavno, mora da se uredi da neko ipak ima kontrolu nad tim, jer ako se vratimo nazad, NVO imaju kontrolu nad apsolutno svakim segmentom

društva, pa čak i nad Vladom i nad Skupštinom. Vidite da sve nas monitorišu neke NVO, a pogotovo vezano u oblasti finansijskih tokova tih NVO. Na primer, nedopustivo je da onaj ko finansira, nema nikakvu kontrolu nad tim, da NVO mogu da rade šta god hoće, samim tim, što kažu, mi smo gradjansko društvo i mi radimo za demokratiju. Pa, svi mi radimo zbog toga. Tako da ja sam za to da taj amandman ipak treba da se usvoji imi ćemo podržati amandman 45. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar, dy minuta, deputetja Melihate Tërmkolli.

MELIHATE TËRMKOLLI: Jo, vetëm një minutë! Absolutisht, unë e kam shumë të qartë dhe besoj të gjithë ne e kemi shumë të qartë nevojën për një rregull edhe në organizatat joqeveritare dhe në institucionet shtetërore dhe të tjera në përgjithësi, por ajo që u përmend këtu nga disa deputetë, nuk e përjashton mundësinë e kontrollit që kanë organizatat joqeveritare me ligjet përkatëse. Nëse një organizatë joqeveritare ka bërë një shkelje të rëndë penale, është ligji i cili u krijon mundësinë institucioneve për ta ndjekur. Sa kjo po zbatohet në Kosovë, është një çështje tjetër. Aty pajtohem plotësisht se kjo nuk është duke u zhvilluar sa duhet në Kosovë, prandaj të mos kemi keqkuptime rreth kësaj. Faleminderit!

KRYETARI: E mbyllim debatin dhe vazhdojmë votimin e amendamenteve.  
Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votimin e amendamentit 1.

Votojmë tash:

Kush është “për” pa kartelë? 3 vota. Kundër? Nuk ka.

Konstatohet se me 75 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 1.

Në radhë kemi amendamentin 2.

Votojmë tash.

74 vota, plus 3 që janë pa kartelë - gjithsej 77. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet amendamenti 2.

Në radhë është amendamenti 3.

Votojmë tash.

Pa kartela “për” 2 vota. Kundër- pa kartela? Nuk ka.

Me 74 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 3.

Vazhdojmë, në radhë është amendamenti 4.

Votojmë tash.

Pa kartela “për” 2 vota. Kundër, pa kartela? Abstenim? Nuk ka.

Me 73 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Në radhë është amendamenti 5.

Votojmë tash.

Me elektronikë janë 74 vota, plus 2 pa kartela bëjnë 76. Kundër? Nuk ka, as me elektronikë as me ngritje dore. Abstenim? Nuk ka.

Me 74 vota “për” miratohet amendamenti numër 5.

Në radhë është amendamenti 6.

Votojmë tash.

A ka pa kartelë? Faleminderit! Kundër? Nuk ka.

Me 74 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 6.

Në radhë është amendamenti 7.

Votojmë tash.

A ka pa kartela? 3 vota “për”. Kundër? Nuk ka.

Me 73 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 7.

Në radhë është amendamenti 8.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela janë 3 vota. Faleminderit!

Me 80 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 8.

Në radhë është amendamenti 9.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela janë 3 vota. Faleminderit! Kundër? Nuk ka.

Me 74 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 9.

Në radhë është amendamenti 10.

Votojmë tash:

Pa kartela “për” 3 vota. Kundër? Nuk ka.

Me 72 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 10.

Në radhë është amendamenti 11.

Votojmë tash.

Pa kartelë janë “për” 3 vota. Kundër? Nuk ka.

Me 73 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 11.

Në radhë është amendamenti 12.

Votojmë tash.

Pa kartelë “për” 4 vota. Faleminderit! Kundër? Nuk ka. Faleminderit!

Me 76 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 12.

Në radhë është amendamenti 13.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela 4 vota. Faleminderit! Kundër? Nuk ka.

Me 72 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 13.

Në radhë është amendamenti 14.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela, 4 vota. Kundër a ka pa kartelë? S’ka! Abstenim? Nuk ka. Faleminderit!

Me 71 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 14.

Në radhë është amendamenti 15.

Votojmë tash.

Pa kartelë 4 vota. Kundër? Nuk ka.

Me 74 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë “abstenim”, miratohet amendamenti 15.

Në radhë është amendamenti 16.

Votojmë tash.

Pa kartela “për” 4 vota. “Kundër” pa kartela? Nuk ka. Faleminderit!

Me 70 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 16.

Në radhë është amendamenti 17.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela? 4 vota. Faleminderit! “Kundër”, pa kartela? Nuk ka.

Me 74 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 17.

Në radhë është amendamenti 18.

Votojmë tash:

Pa kartela “për” 4 vota. Faleminderit! “Kundër”? Nuk ka.

Më 76 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 18.

Në radhë është amendamenti 19.

Votojmë tash.

Pa kartela “për” 4 vota. Faleminderit! “Kundër”? Nuk ka. Faleminderit!

Më 72 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 19.

Në radhë është amendamenti 20.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela, 4 vota. “Kundër”, a ka pa kartela? S’ka. Faleminderit!

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 20.

Në radhë është amendamenti 21.

Votojmë tash:

“Për” pa kartela, 4 vota. Faleminderit! “Kundër” pa kartela? Nuk ka! Faleminderit!

Më 72 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 21.

Në radhë është amendamenti 22.

Votojmë tash:

Pa kartela “për” 4 vota. Faleminderit! “Kundër”? Nuk ka.

Më 74 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 22.

Në radhë është amendamenti 23.

Votojmë tash:

“Për” pa kartela, 4 vota. “Kundër” pa kartela? Nuk ka.

Më 72 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 23.

Në radhë është amendamenti 24.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela, 4 vota.

Më 78 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 24.

Në radhë është amendamenti 25.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela, 4 vota. “Kundër”? Nuk ka.

Më 75 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 25.

Në radhë është amendamenti 26.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela, 4 vota. Faleminderit!

Më 72 “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 26.

Në radhë është amendamenti 27.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela, 4 vota. Faleminderit!

Më 62 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 27.

Në radhë është amendamenti 28.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela, 4 vota. Faleminderit!

Me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 28.

Në radhë është amendamenti 29.

Votojmë tash:

“Për” pa kartela, 4 vota. Faleminderit! “Kundër”, pa kartela? Nuk ka.

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 29.

Në radhë është amendamenti 30.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela, 4 vota. “Kundër” pa kartela? Nuk ka.

Më 71 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 30.

Në radhë është amendamenti 31.

Votojmë tash:

Pa kartela “për”, 4 vota. “Kundër” pa kartela? Nuk ka.

Me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 32.

Në radhë është amendamenti 33.

Votojmë tash.

Pa kartela “për” janë 4 vota. Faleminderit! “Kundër”? Nuk ka.

Me 72 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 33.

Në radhë është amendamenti 34.

Votojmë tash.

Pa kartela “për” janë 4 vota. Faleminderit!

Me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 34.

Në radhë është amendamenti 35.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela, 4 vota. “Kundër”? Nuk ka.

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 35.

Në radhë është amendamenti 36.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela, 4 vota.

Me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 36.

E di që jeni lodhur, por qetësi, deputetë!

Amendamenti 37.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela, 4 vota.

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 37.

Në radhë është amendamenti 38.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela, 3 vota.

Me 70 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 38.

Në radhë është amendamenti 39.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela, 4 vota.

Me 67 “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 39.

Në radhë është amendamenti 40.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela, 4 vota.

Me 57 “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 40.

Në radhë është amendamenti 41.

Votojmë tash.

Pa kartela “për”, 3 vota.

Me 75 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 41.

Në radhë është amendamenti 42.

Votojmë tash.

Pa kartela, 4 vota.

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 42.

Në radhë është amendamenti 43.

Votojmë tash.

Pa kartela “për”, 4 vota. “Kundër”? Nuk ka.

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 43.

Në radhë është amendamenti 44.

Votojmë tash.

Pa kartela “për”, 4 vota. Faleminderit!

Me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 44.

Kryetar i Komisionit- kemi amendamentin 45.

(Ndërhyrje)

Tërhiqet! Atëherë votojmë.

Kush është për ta tërhequr amendamentin 45.

Votojmë tash.

(Ndërhyrje)

Për tërheqje? Kush është për tërheqje, pa kartela? 3 vota. Faleminderit!

Me 50 vota “për”, 9 “kundër”, 3 abstenime, tërhiqet amendamenti 45.

Në radhë është amendamenti 46.

Votojmë tash.

Ne tash duhet të themi, pasi e tërheqim amendamentin 45, në radhë është amendamenti 45, që këtu e kemi nën numrin rendor 46. A duhet të themi ne tash amendamenti 45?

(Ndërhyrje)

Mirë, atëherë le ta rregullojnë ata të tjerët. Atëherë, kush është “për”, pa kartela? 3 vota. Me 73 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 46.

Në radhë është amendamenti 47.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela, 3 vota.

Me 69 “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 47.

Në radhë është amendamenti 48.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela janë 2 vota. Faleminderit!

Me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 48.

Në radhë është amendamenti 49.

Votojmë tash.

Pa kartela “për” 2 vota. Faleminderit!

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 49.

Në radhë është amendamenti 50.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela, 3 vota.

Me 57 “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 50.

Në radhë është amendamenti i parafundit, 51.

Votojmë tash.

“Për” pa kartela, 4 vota. Faleminderit!

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 51.

Dhe, amendamenti i fundit është amendamenti 52.

Votojmë tash.

Pa kartela “për”, 4 vota. Faleminderit! “Kundër”? Nuk ka.

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 52. Pra, i kemi kryer amendamentet. Tani përgatitemi ta votojmë ligjin në tërësi. Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota. Ju faleminderit! “Kundër”? Nuk ka.

Me 73 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet ligji në tërësi.

Pra, Kuvendi miratoi ligjin për lirinë e asocimit në organizatat joqeveritare.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës. E kemi vetëm një amendament.

**. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kërkesa teknike, për produkte dhe vlerësim të konformitetit**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kërkesat teknike për produktet dhe vlerësimin e konformitetit dhe Kuvendit i

kanë rekomanduar miratimin e Projektligjit me amendamentin e propozuar nga komisioni funksional.

Meqë s' është lajmëruar askush, atëherë vazhdojmë me votim.

Votojmë për amendamentin 1.

Votojmë tash.

Ju faleminderit!

“Për” pa kartela janë 3 vota, sepse një ka harruar ta ngritë dorën.

Me 72 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.

Ju faleminderit!

(Konsultime)

Pika e radhës është pika e shtatë e rendit të ditës.

(Konsultime)

E votuam. Unë konstatova. Unë, mendova se e kryem. Mirë, më falni. Pra, e votojmë ligjin në tërësi me amendamente.

Votojmë, tash.

“Për” pa kartela? Ju faleminderit! Me 73 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet në tërësi Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit. Ndoshta që e kishte ligji vetëm një nen, unë e ngatërrova. Më falni!

Pika e shtatë e rendit të ditës:

### **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ushqimin**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ushqimin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e Projektligjit me amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Për debat nuk është lajmëruar askush, andaj hyjmë në procedurën e votimit. Votojmë amendamentin 1.

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota. “Kundër”? Nuk ka.

Më 65 vota “për”, asnjë kundër, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 1.

Amendamenti 2

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota. “Kundër”? Nuk ka.

Me 60 vota “për”, asnjë kundër, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 2.

Amendamenti 3

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota.

Me 61 votë “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 3.

#### Amendamenti 4

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota.

Me 64 vota “për”, asnjë kundër, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 4.

#### Amendamenti 5

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota.” Kundër”? Nuk ka.

Me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 5.

#### Amendamenti 6

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota.

Me 60 vota “për”, 1 kundër, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 6.

#### Amendamenti 7

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota. “Kundër”? Nuk ka.

Me 60 vota “për”, asnjë kundër, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 7.

#### Amendamenti 8

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota.

Me 62 vota “për”, asnjë kundër, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 8.

#### Amendamenti 9

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota. “Kundër”? Nuk ka.

Më 61 vota “për”, asnjë kundër, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 9.

#### Amendamenti 10

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota. “Kundër”? Nuk ka.

Më 63 vota “për”, 1 kundër, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 10.

#### Amendamenti 11

Votojmë tash.

Pa kartela “për”? Faleminderit! “Kundër”? Nuk ka.

Me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 11.

#### Amendamenti 12

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota. “Kundër”? Nuk ka.

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 12.

#### Amendamenti 13

Votojmë tash.

Pa kartela “për” janë 4 vota. “Kundër”? Nuk ka. Faleminderit!

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 13.

#### Amendamenti 14

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota. “Kundër”? Nuk ka.

Me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 14.

Amendamenti 15

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota. Faleminderit!

Me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 15.

Amendamenti 16

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota. Faleminderit! “Kundër”? Nuk ka.

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 16.

Amendamenti 17

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota. “Kundër”? Nuk ka.

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 17.

Amendamenti 18

Votojmë tash.

Pa kartela “për”, 4 vota. “Kundër”? Nuk ka.

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 18.

Amendamenti 19

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota. Faleminderit!

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 19.

Amendamenti 20

Votojmë tash.

Pa kartela “për”, 4 vota. “Kundër”? Nuk ka.

Me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 20.

Amendamenti 21

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota. “Kundër”? Nuk ka.

Me 59 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 21.

Amendamenti 22.

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota. “Kundër”? Nuk ka.

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 22.

Tani përgatitemi për ta votuar ligjin në tërësi.

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota. “Kundër”? Nuk ka. Ju faleminderit!

Më 71 vota “për”, asnjë “kundër” 4 abstenime, Kuvendi miratoi në tërësi Ligjin për ushqimin.

Ju faleminderit!

Ne i kemi edhe dy pika të rendit të ditës, por njëherë po e lëmë për nesër dhe pikën e tetë po e kryejmë sonte. A të vazhdojmë? Ju faleminderit shumë!

Mirë, e vazhdojmë debatin, edhe unë jam për ta vazhduar.  
Në radhë është pika e tetë e rendit të ditës:

**- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vlerësimin strategjik mjedisor**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për vlerësimin strategjik mjedisor dhe Kuvendit i kanë propozuar miratimin e Projektligjit me amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Nuk kemi të lajmëruar për ta marrë fjalën. Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

**Amendamenti 1**

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 4 vota.

Me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 1.

**Amendamenti 2**

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 2 vota.

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 2.

**Amendamenti 3**

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 3 vota.

Me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 3.

**Amendamenti 4**

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 3 vota.

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 4.

**Amendamenti 5**

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 3 vota.

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 5.

**Amendamenti 6**

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 3 vota.

Me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 6.

**Amendamenti 7**

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 3 vota. “Kundër”? Nuk ka.

Konstatohet se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 7.

#### Amendamenti 8

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 3 vota.

Me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 8.

#### Amendamenti 9

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 3 vota.

Me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 9.

#### Amendamenti 10

Votojmë tash.

Pa kartela “për”, 3 vota.

Me 65 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 10.

#### Amendamenti 11

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 2 vota.

Me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 11.

#### Amendamenti 12

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 3 vota. Faleminderit!

Me 62 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 12.

#### Amendamenti 13

Urdhëro Bahri Hyseni, deputet.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

T’ju them të vërtetën, ndoshta më mirë këtë do ta sqarojë kryetarja e Komisionit, sepse amendamenti 13 nuk i përngjan amendamentit. Çështja e parë është vendosur edhe për nga teknika juridike edhe për nga përshkrimi, dhe nga përmbajtja që është, duhet të shikojmë se çka duhet bërë, pra, do ta kenë problem ata të cilët në fund, sepse është jashtë përmbajtjes së ligjit, nuk është normë. Është memorandum, shtojcë, prandaj nuk shkon si amendament. Duhet ose të hiqet, ose të shikohet se si e kanë menduar. Është shtojcë, nuk është normë, është marrëveshje, prandaj duhet të kemi parasysh, sepse kjo duhet të kalojë në Zyrën për Standardizim dhe mos na sillni në dilema pastaj të kemi probleme që i patëm pak para disa minutash. Ju faleminderit!

KRYETARI: Komisioni, çka ka menduar?

Fjalën e ka Myzeje Selmani, deputete. Kush është? Aha, me fal! Deputeti Lulzim Zeneli e ka fjalën!

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, Kryetar!

Kjo shtojcë e cila është në përputhje të plotë me standardet e Bashkimit Evropian dhe nënkupton që kjo shtojcë është plotësim dhe sqarim i konventave, i elementeve shtesë të cilat mund të sqarojnë dhe mund të kompletojnë atë pjesën për ndonjë sqarim shtesë.

Prandaj, ju e shihni, janë direktiva të Bashkimit Evropian sa u përket karakteristikave mjedisore.

Dëgjoni! Nëse kjo ka qenë sugjerim edhe i Ministrisë përkatëse dhe ka qenë pjesë që edhe vendet të cilat sot janë pjesë të Bashkimit Evropian, i kanë këto karakteristika dhe këto shtojca në projektligjet e veta. Prandaj, ne e kemi konsideruar se kjo është e nevojshme dhe në qoftë se Kuvendi vendos ndryshe, nuk është dispozitë e cila e rregullon ndonjë materie të caktuar, mirëpo konsiderojmë që kjo është e nevojshme si shtojcë e cila duhet të jetë pjesë e ligjit.

KRYETARI: Ju lutem!

Në amendamentin që e kemi votuar, por nganjëherë po harrojmë, numrin 2, Raporti për vlerësimin strategjik mjedisor, do të thotë pjesa e dokumentacionit të planit ose programit që përmban informacionet e kërkuara në nenin 4 dhe shtojcën 1. Mendojmë se duhet ta votojmë se kjo është paraparë edhe në amendamentin nr. 2, që e kemi votuar.

Lus regjinë që të përgatitet për votim.

Amendamenti 13.

Votojmë tash.

Pa kartela “për”, 2 vota.

Me 56 vota “për”, 4 vota “kundër”, 8 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 13.

Tani është radha për ta votuar ligjin në tërësi. Përgatitemi për votim.

Votojmë, tash.

Pa kartela “për”, 3 vota. “Kundër”? Nuk ka. Vazhdojmë.

Me 70 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligin për vlerësimin strategjik mjedisor.

Ju faleminderit!

Fillojmë pikën e nëntë të rendit të ditës.

A ta bëjmë një votim formal? Mirë, nesër në orën 10:00.

### **Vazhdimi i seancës, më 13 shkurt 2009, në orën 10:00**

### **Drejtoi seancën Kryetari i Parlamentit, zoti Jakup Krasniqi**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,  
I nderuari zëvendëskryeministër, ministra,  
Vazhdojmë seancën e djeshme.

Kemi pikën nëntë të rendit të ditës:

- **Debati sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të AAK-së lidhur me vendimin e Presidentit të Kosovës për shtyrjen e zgjedhjeve parlamentare**

Edhe pse vendim këtu nuk ka, Grupi Parlamentar i AAK-së i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit me kërkesë për të debatuar lidhur me vendimin e Presidentit të Kosovës për shtyrjen e zgjedhjeve parlamentare. Kështu është kërkesa e Grupit Parlamentar.

Radha për diskutim është e përfaqësuesit të Grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. E ka fjalën shefi i Grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka kërkuar debatin e sotëm, me qëllim që të sqarohen të gjitha arsyet dhe procedurat që kanë sjellë deri te vendimi i Presidentit të Kosovës për shtyrjen e zgjedhjeve deri në vitin 2011. Ne kemi vendosur që ta sjellim këtë temë sot në Kuvend të Kosovës, për shkak se mendojmë dhe do t'i sjellim argumentet që ky vendim është i gabueshëm, është jashtëligjor dhe ka konsekuenca të gabueshme politike. Unë do të ndalem në katër pika të ndryshme dhe do t'i sqaroj.

E para është, dilema se a ka pasur marrëveshje? Çështja e dytë është, cilat janë provizionet kushtetuese dhe ligjore të cilat janë thyer me këtë vendim?

Çështja e tretë është aspekti politik dhe pozicioni politik i Presidentit? Dhe, e fundit do të jetë, arsyet pse kërkohen zgjedhjet për shkak se këto tri të parat në vetvete japin të drejtën e mbajtjes së zgjedhjeve. A ka pasur marrëveshje? Fillimisht është përmendur Grupi Politik Strategjik dhe puna e tij në vitin 2006 dhe 2007 është biseduar. Me siguri se shumë kujt këtu që ka qenë në Grupin politik strategjik, do t'i kujtohet se kemi biseduar për zgjedhjet, por nuk kemi biseduar për mandatin e parë të zgjedhjeve, kemi biseduar se sa duhet të zgjatë mandati në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Për ta vërtetuar këtë, mund ta gjeni një material i cili quhet "Raporti përfundimtar i grupit punues tranzitor mbi zgjedhjet". Në atë grup punues kanë marrë pjesë përfaqësuesit e shumë partive politike, disa janë këtu, si për shembull zoti Haziri, zoti Limaj. Në atë raport, ai grup punues ka dalë me rekomandime. Cilat janë rekomandimet? Rekomandimi për sistemin zgjedhor, rekomandimi për listat e hapura ose të mbyllura, rekomandimi për dalje në zona zgjedhore, thotë vetëm një zonë duhet të jetë, rekomandimi për përfaqësimin gjinor 30%, çdo e treta, zgjedhja e drejtpërdrejtë e kryetarëve të komunave. Si duhet të regjistrohen partitë politike, cilët janë mekanizmat e ankesave, cili është tranzicioni i Komisionit Qendror Zgjedhor dhe cila është koha e zgjedhjeve të ardhshme, një nga pikat e fundit, dhe çka thotë ky grup punues në atë pikë? Thotë kështu, përpos të tjerave thotë: "Grupi ka shënuar rekomandimin e Ekipit të Unitetit për të organizuar zgjedhjet, 6 muaj pas miratimit të rezolutës së re". Kjo është çka shënon grupi punues. Kjo është një marrëveshje që ka ekzistuar.

Marrëveshje tjetër për zgjedhjet është një marrëveshje interesante që ka peshë shumë të madhe, ka pasur peshë shumë të madhe atëherë. Është Marrëveshja e Pokantikos. Në Marrëveshjen e Pokantikos, pika 9 e kësaj marrëveshje, e përkthyer nga unë, është në anglisht, thotë: "Nënshkruesit dakordohen që do ta mbështesin aprovimin e ligjit të ri për zgjedhjet dhe do të shpallin zgjedhjet lokale dhe të përgjithshme jo më larg se 6 muaj pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës". Këtë marrëveshje të Pokantikos, përpos të tjerëve, e ka nënshkruar edhe Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, dhe Kryeministri i Kosovës tash, atëherë lider i opozitës, Hashim Thaçi. Të tjerët janë: Agim Çeku, Kolë Berisha dhe Veton Surroi. Këto janë dy marrëveshje që kanë ekzistuar për zgjedhjet paraprakisht dhe, nëse dikush flet për marrëveshje tjera, kishim dashur të na tregojë.

Tani, do të kaloj te pjesa e dytë e kësaj çështjeje, cilat janë provizionet kushtetuese për mbajtjen e zgjedhjeve?

Fillimisht, neni 22, 23 i Kushtetutës, i cili është përmendur disa herë, i ka disa dispozita të cilat thonë kështu: “Të gjitha autoritet e Republikës së Kosovës veprojnë në pajtim me të gjitha detyrimet e Republikës së Kosovës sipas Propozimit gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit të Kosovës”- Plan i Ahtisarit. E keni para vetes me siguri secili prej jush Kushtetutën.

Pika e dytë thotë kështu: “Dispozitat e Propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, kanë epërsinë ndaj të gjitha dispozitave tjera ligjore në Kosovë”, Kushtetutën jam duke e cituar.

Pika e tretë thotë: “Kushtetuta, ligjet, aktet e tjera të Republikës së Kosovës interpretohen në pajtueshmëri me Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007. Në rast se ka mos pajtueshmëri midis dispozitave të kësaj Kushtetute dhe ligjeve e akteve të tjera të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të marrëveshjes, kjo e fundit do të mbizotërojë.”

Më tutje e keni nenin 10 të Propozimit gjithëpërfshirës të Planit të Ahtisarit, të cilit i referohen këto dispozita për të cilat fola unë dhe i cili thotë, pika 4: “Jo më vonë se 9 muaj nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshje, Kosova do të organizojë zgjedhje të përgjithshme dhe komunale në pajtim me kushtet e kësaj marrëveshje.”

Neni 4.1 i këtij propozimi, po ashtu thotë: “Kryetari i Kosovës do të përfaqësojë unitetin e popullit të Kosovës.” Po kësaj do t’i referohem edhe pak.

Ndërsa, neni 161 i Kushtetutës, të cilën e ka cituar Presidenti i Kosovës kur ka thënë se ka marrë vendim, tani plot njerëz po thonë, jo s’ka marrë vendim, por ai ka thënë me gojë të veten se ka marrë vendim, ne nuk e dimë a është vendim a s’është vendim, po kur thotë Presidenti, atëherë duhet të thotë jo s’kam marrë, pra të na shpjegojë.

Neni 161 i Kushtetutës thotë kështu, mbani në mend fjalinë e parë që e ka harruar Presidenti për ta përmendur, thotë: “Me përjashtim në rastet kur Kushtetuta përcakton tranzicion tjetër”. Kjo është fjalia e parë e nenit 161 që Presidenti ka harruar për ta përmendur kur e ka cituar Kushtetutën, e ka interpretuar vetë gabimisht, thotë, do të thotë “ me përjashtim në rastet kur ka provizione të tjera, provizionet tjera unë veç sa i lexova- thotë të gjitha kompetencat, përgjegjësitë, blla- blla- blla, vazhdon më tutje.

Tani ligjet, u thye edhe ligji. Neni 4.1 i Ligjit për zgjedhjet në Kosovë thotë kështu: “Presidenti i Republikës e cakton datën e zgjedhjeve pas konsultimeve me partitë politike”. Do të thotë, është thyer Kushtetuta, është thyer ligji, është shkelur Plan i Ahtisarit, edhe tani ne nuk po e dimë a ka marrë vendim Presidenti a s’ka marrë vendim?

Tani aspekti i tretë, aspekti ligjor po më duket që u shter e s’ka nevojë as më tepër ligje, e nene, e kushtetutë për të përmendur, aspekti i tretë është aspekti politik dhe politika e Presidentit të Kosovës. E përmenda pak më përpara një nen të planit, mirëpo mund ta përmendim edhe Kushtetutën e Kosovës, hyrjen, mund ta përmendim, Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës se çka është Presidenti. A është Presidenti i gjithë popullit të Kosovës a nuk është, apo është Presidenti i pushtetit? Nëse është Presidenti i pushtetit, atëherë ne e kuptojmë, mirëpo nëse Presidenti duhet ta përfaqësojë unitetin e popullit, Presidenti e ka obligim të paktën, minimum, që të konsultohet me të gjitha partitë politike në Kosovë.

Tani shumë arsye janë dhënë për mos mbajtjen e zgjedhjeve. Thonë, mund të destabilizohet, mund të mos marrin pjesë serbët, mund të mos ketë njohje të tjera, mund të ketë largim të donatorëve. Po, krejt këto arsye janë arsye edhe për t' i mbajtur zgjedhjet, se kështu qysh kemi nisur, do të thotë, kemi problem ne, asgjë nuk po ndodh. Krejt këto çka i përmenda, realisht nuk po ndodhin, kështu që ne mendojmë se janë arsye të mjaftueshme edhe për mbajtjen e zgjedhjeve në të njëjtën kohë. Do të thotë, për një rekapitullim, Kushtetuta është shkelur, ligjet janë shkelur, procedurat demokratike të një shteti demokratik janë shkelur. Mos harroni se në të kaluarën Kosova ka pasur President edhe pa u shpallur shtet, mirëpo, për çfarëdo arsye, të paktën ka dalë edhe ka deklaruar se i kam konsultuar partitë politike. Ky presidenti ynë nuk e ka parë të arsyeshme as t' i konsultojë partitë politike.

Tani, çështje tjetër është para rekapitullimit total, pse kërkojmë zgjedhje ne? Ne kërkojmë zgjedhje ekzakt fillimisht edhe një herë pse u shkelën këto që i thashë, se ka të drejtë ligjore dhe kushtetuese për t' i shpallur zgjedhjet. Arsye tjetër për mbajtjen e zgjedhjeve është se pushteti në Kosovë ka degraduar, se sistemi është në degradim e sipër dhe që Kosova duhet të largohet prej këtij shtegu në të cilin ka hyrë. Kosova e ka ndërruar kursin, Kosova është si një anije e cila është tërhequr prej të tjerëve deri më tani dhe një moment kur është lëshuar vetëm dhe e ka shpallur pavarësinë, ka devijuar prej kursit, është duke devijuar prej kursit, edhe sado që mund të na ndihmojnë të tjerët, sado që mund të na japin këshilla, nuk do ta marrin timonin tonë më, e timoni e timonieri janë të gabueshëm. Kemi sistem të paaftë qeverisës, kemi sistem korruptiv qeverisës, kemi sistem të pasinqertë qeverisës, kemi sistem fyes ndaj vlerave, kemi sistem që po i shkakton dëm Kosovës dhe kemi sistem që synon t' i dënojë njerëzit që mendojnë ndryshe. A ka arsye më të mëdha për mbajtjen e zgjedhjeve se këto? Konkludimi është ky, përpos që në bazë të Kushtetutës dhe në bazë të ligjeve është dashur të konsultohen partitë politike dhe të shpallin zgjedhjet, përveç kësaj edhe sikur të mos kishte pasur provizione kushtetuese, kur opozita kërkon zgjedhjet, Presidenti ka qenë dashur të ulet bashkë me ta të konsultohet dhe të marrë vendim se çka do të bëhet më tutje. Presidenti i Kosovës ka qenë dashur ta konsiderojë veten president të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe të të gjitha partive politike për atë çështje e jo president të pushtetit, e jo president i cili një ditë thotë se ka marrë vendim, ditën tjetër thotë se nuk ka marrë vendim, dhe jo president i njerëzve të cilët sot edhe këtu, dikush thotë ka marrë vendim, dikush nuk ka marrë vendim.

Rekapitullimi i fundit para se ta përmbyll është, ka pasur marrëveshje, është e Pokantikos, ka pasur marrëveshje, është grupi punues që zgjedhjet të shpallen 6 muaj pas shpalljes së pavarësisë. Kushtetuta është thyer se edhe Kushtetuta i njeh këto provizione. Ligji është thyer, se edhe ligji i njeh këto provizione, dhe zgjedhjet në Kosovë ka qenë dashur të mendojë Presidenti i Kosovës, nëse e do vendin, të mendojë për shpallje, se mënyra se si po qeveriset ky vend, mënyra se si po punohet në këtë shtetin e ri të Kosovës, nuk premtonte kurrfarë të ardhme për qytetarët e Kosovës dhe vetëm zgjedhjet demokratike mund ta ndërrojnë kursin të cilin e ka marrë ky vend. Vetëm zgjedhjet mund ta nxjerrin Kosovën prej këtij sistemi të gabueshëm, korruptiv dhe sakatues për të ardhmen e vendit dhe të popullit. Faleminderit!

KRYETARI: Radha është e shefave të grupeve parlamentare. Po, para se vërtet t'ua jap fjalën shefave të grupeve parlamentare, kam një kërkesë lidhur me disa deputetë që po i keqpërdorin butonat e votimit. Unë kësaj radhe do të flas në përgjithësi, edhe pse e di konkretisht kush e ka shtypur butonin e huaj, që të mos i keqpërdorin kartelat e deputetëve që nuk janë prezentë në sallë. Herën tjetër do të flas me emra dhe për të gjitha

rastet, kështu që po them, për herë të fundit po i paralajmëroj deputetët të mos i keqpërdorin butonat për të votuar për deputetët që nuk janë prezentë në sallë.

Një kërkesë tjetër që e kam është që, pasi ne e dëgjuam fjalën e shefit të Grupit të Aleancës, të bëhet një debat vërtet me argumente dhe pa ngritje tensionesh. Ne jemi këtu dhe çështjet në demokraci maten me fuqinë e votave të deputetëve në Parlament. Prandaj, kursehuni nga fjalët fyese që nganjëherë po ndodhin.

Fjalën ia jep shefit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zotit Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuari zoti Kryetar,  
Zoti Kryeministër dhe zëvendëskryeministra,  
Kabinetin qeveritar,  
Të nderuar kolegë deputetë,

Besoj e dini që ne pozita po të ishim në opozitë, bën vaki që kishim për të bërë edhe më shumë zhurmë seç po bën opozita aktuale. Kjo është e kuptueshme, krejtësisht normale, e zakonshme që të kontribuojmë për të mos qenë i tensionuar debati, sepse në fakt njeriu mund të nisë me fjalën e parë që të kontestojë të shkruarën si pikë të rendit të ditës, për shtyrje të zgjedhjeve. Krejt e pakuptueshme, krejt jo logjike, krejt e paqëndrueshme, sepse s'ka shtyrje zgjedhjesh, sepse ajo është e përcaktuar me kushtetutë dhe në të gjitha vendet demokratike të botës ato që janë në konsolidim, ato të konsoliduarat, respektohet kryeligji i quajtur Kushtetutë. Nuk di çka ka këtu? Unë dua ta përmbledh këtë fjalën time në tri pika, mbase. Në marrëveshje, që s' guxoj, s'dua, as s'kam kompetencë të flas për një marrëveshje ekzistuese a inekzistuese. Është folur e përfolur shumë nëpër media se paska qenë edhe duhet të flasin aktorët e kësaj marrëveshje, nëse është, dhe përsëri po edhe po pati marrëveshje tillë, Kushtetuta e shmang atë, sepse është bërë kushtetuta dhe unë, më sa e di, kur kemi aprovuar kushtetutën, e kemi aprovuar gati me qind për qind dhe nuk ka reaguar askush, ama askush se një nen, një pikë, një kod diku qenka kontestues dhe u dashka përmirësuar dhe riparuar. Nuk është thënë. Është pak e vonuar kjo, por megjithatë po rrahin ujë në havan sa të doni, s'prish punë.

Çështja e zgjedhjeve, t'ju them të drejtën, unë jam shumë i disponuar për të mbajtur zgjedhjet, po u pyeta unë. Po, s'mund të më pyes kush për këtë punë, sepse në fakt është Kushtetuta është ajo që përcakton këto gjëra, sepse unë besoj, edhe opozita s'është e gatshme shumë për zgjedhje, por megjithatë duhet të flasë kështu se edhe e pranoj si të tillë, sepse në fakt, po të kishim dalë në zgjedhje, besoj që rezultati do të kishte qenë hala më favorizuese për pozitën. Por, ku është telashja? Telashja është se në çdo realizim ose organizim të zgjedhjeve, 6 muaj janë të humbura, 3 muaj para, 3 muaj pas janë të humbura, andaj unë hiq s'jam i interesuar, as grupi im parlamentar, që 6 muaj për Kosovën t'i humbim. Sa për zgjedhjet, po të kishim pasur mundësi t'i realizojmë më shkurt dhe më me pak humbje, sot do t'i kishim bërë, pa asnjë telashe fare.

Vendimi i Presidentit për shtyrje, çfarë shtyrje ka bërë Presidenti, ju lutem? Unë nuk e kam idenë dhe le të më sqarojë kush çfarë shtyrje ka bërë? S'ka shtyrje këtu, bile s'ka as interpretim, po ka sqarim të Kushtetutës, jo interpretim, sqarim të kushtetutës, ju lutem!

Prandaj, po ju them shumë miqësisht e sinqerisht, ne sot pak kohë të humbur e konsideroj këtë gjë që flasim, por megjithatë pse jo, jam gjithmonë për debatin dhe uroj që debati i sotëm të nxjerrë diçka në shesh, por jam tepër skeptik. Ju përshëndes!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Buja!

Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Falënderoj Ardianin që paraqiti para nesh arsyen apo motivet që si grup parlamentar ka kërkuar këtë debat. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së jam i thirrur që t'i sqaroj disa nga çështjet që u përmendën këtu, qoftë ajo që ka të bëjë me marrëveshje apo me punën e grupit, në atë kohë të grupit punues për zgjedhjet që ka qenë i mandatuar nga Delegacioni i Unitetit.

Presidenti i Republikës është ftuar publikisht dhe ka pasur presion politik me javë të tëra, me muaj të tërë, që të sqarojë çështjen e zgjedhjeve. Është autoriteti më i lartë kushtetues, i cili ka qenë i ftuar drejtpërdrejt dhe në ditët e para të janarit e ka realizuar këtë kërkesë, duke sqaruar një nen të Kushtetutës për mandatin e institucioneve. Ka qenë shumë eksplicit në sqarim dhe ai sqarim u është bërë i qartë edhe kërkuësve edhe atyre që kanë pasur interes për zgjedhje. Neni 161, në të cilën është thirrur Presidenti, ka qenë obligim për shkak të presionit të publikut, të presionit të forcave politike dhe të gjithë atyre që temën e zgjedhjeve e kanë bërë numër një në Kosovë. Unë mendoj që ne duhet të jemi falënderues për reagimin e Presidentit, në mënyrë që çështjen e mandateve ta sqarojë dhe ne të vazhdojmë të punojmë në këtë drejtim. Mund të interpretohet ndryshe, por vërtet ka qenë sqarim i një neni të Kushtetutës. Interpretimin e Kushtetutës e bëjnë organet tjera dhe, sigurisht, ato kur të bëhen funksionale, do të arrijnë ta kryejmë këtë pjesë.

Grupi punues, të cilën unë e kam bashkëkryesuar, me kërkesë edhe atëherë të Presidentit, në bashkëkryesim me shefin e misionit të OSBE-së dhe në përbërje nga partitë politike, ka qenë: LDK, me 3 anëtarë, PDK, me 2 anëtarë, forcat tjera politike me nga një anëtar, shoqëria civile ka qenë e përfaqësuar në tri kategori. Shoqëria civile që ka përfaqësuar interesat e grupeve të caktuara, gjinia, të drejtat e njeriut, ka qenë zoti Makolli, në fillim, si organizatë e ftuar për të marrë pjesë, edhe të hendikepuarit dhe me aftësi të kufizuara. Këto tri kategori kanë marrë pjesë që me forcat politike të diskutojnë, të jenë pjesë e vazhdueshme dhe, po ashtu, përfaqësuesit e grupeve etnike. Kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit politikë të grupeve të ndryshme etnike, të mbështetur edhe ata me këshilla dhe me ekspertë të tyre.

Detyra jonë ka qenë që të përgatitet legjislacioni për zgjedhje, legjislacioni për zgjedhje që nënkupton legjislacionin për zgjedhjes pas përfundimit të procesit të statusit, sepse autoriteti në atë kohë ka qenë në UNMIK-un, Përfaqësuesin Special dhe sigurisht që, vetë fakti që e ka deleguar ambasadorin Vned në atë kohë si shef të misionit, për ta ndihmuar Grupin punues, ka qenë e involvuar edhe administrata ndërkombëtare. Krejt ne që kemi arritur me konsensus të plotë dhe këtu janë dëshmitarët që kanë marrë pjesë, çdo rekomandim ka qenë konsensual. Vetëm te pragu zgjedhor kemi pasur dilema dhe duke dashur që ta ruajmë konsensusin, ne ia kemi deleguar këtë të drejtë Delegacionit të Unitetit që të vendosë dhe atje është arritur marrëveshja, mandej që pragu zgjedhor të jetë 5% e jo 2.5%, çfarë "ORA" në atë kohë ka kërkuar.

Pjesa tjetër e rekomandimeve ka qenë konsesuale dhe ne kemi dashur që në Kosovë, përveç sistemit zgjedhor që s'ke mund ta diskutojmë dhe ndarjes së Kosovës në zona, pjesën tjetër e kemi reformuar pak a shumë apo kemi ndikuar që sistemi zgjedhor të bëhet

sa më demokratik, sa më i pranueshëm dhe sa më i mirë për votuesin, për qytetarin e Kosovës, me mundësi që të zgjedhë. Kjo ka qenë pjesa e angazhimit.

Marrëveshja konsesuale për çdo rekomandim ka ekzistuar me vetë faktin që është punuar në këtë parim. Marrëveshja për mandatet tash ka të bëjë me sqarimin që ne do ta japim, ka pasur diskutim sa do të jetë, kohëzgjatja e mandateve të institucioneve. Kjo dallon shumë nga ajo që nxjerrët këtu, dhe kemi ardhur në përfundim se duhet të rregullohen mandatet në Kosovë në parimin e parë që pushteti lokal në mandatin e parë të ketë dy vjet për shkak të decentralizimit, jo për motive tjera.

Mandati i Parlamentit të jetë 4 vjet, nga 3 sa ka qenë, dhe mandati i Presidentit, si autoriteti më i lartë i cili mund të rregullojë dhe garantojë unitetin e vendit, të jetë 5 - vjeçar dhe këto rekomandime më vonë janë pranuar edhe janë konvertuar në obligime edhe kushtetuese. Ky është angazhimi ynë konkret.

Po ashtu, në kohën kur ne kemi biseduar, nuk kemi planifikuar zgjedhje. Zgjedhjet në nëntor kanë ardhur si pasojë e vendimit që në atë kohë, Përfaqësuesi Special në konsultime me faktorët politikë, ka vendosur t'i realizojë në një marrëveshje që nëse zgjedhjet e prekin statusin e Kosovës, jepet e drejta për t' i shtyrë zgjedhjet. Kemi qenë në kohën kur pushteti lokal e ka pasur vitin e pestë të mandatit, një vit jashtë atij të rregullt dhe në kohën kur Kosova pritej të hynte në përfundimin e procesit të statusit final, kjo e drejtë i është dhënë.

Ju e dini, apo liderët tanë e dinë e dinë që ka ekzistuar edhe një marrëveshje për datën e zgjedhjeve, e cila është ndërruar 5 minuta para se të nënshkruhet urdhëresa ekzekutive në atë kohë. Kjo është temë tjetër.

Por, zgjedhjet kanë ardhur para përmbylljes së procesit të statusit dhe mandati ynë ka qenë në kohën e vetë ai që ka qenë, ne e kemi atë mandat. Kryetari e ka sqaruar që në periudhën e transicionit në kalim e sipër ky mandat është si i tillë.

Së paku, e kemi një hartë zgjedhore në Kosovë. E dimë që deri më 8 janar të vitit 2012 ekzistojnë institucione legjitime të cilat do të jenë funksionale. Kjo hartë zgjedhore besoj që na ndihmon të gjithë neve që të punojmë në realizimin e objektivave tonë dhe detyrat shtetërore kushtetuese janë në radhë të parë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, shefi i Grupit, deputeti Ibrahim Makolli, e ka fjalën.

**IBRAHIM MAKOLLI:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Zotërinj ministra,

Po më duket, zoti Haziri e vendosi që zgjedhjet të mbahen në vitin 2012.

Lutfi, faleminderit! Unë besoj që jo rrallë herë jam i akuzuar se gjërat ose po i bëj me vonesë, ose atëherë kur më shumë shkaktojmë probleme se sa përfitime dhe kështu kujtoj se po ndodh edhe sot. Përkundër faktit që debati është me interes për opinionin, jo për të kuptuar se çka do të ndodhë sot, por për të kuptuar për ato që ka ndodhur në të kaluarën, të cilat po shihet se janë edhe mollë sherri në gjithë këtë çështje.

Besoj se shumica nga ju jeni në dijeni kur ne si subjekt politik patëm kritikuar marrëveshjen për zgjedhjet, të cilën e pati bërë i ashtuquajti Grup i Unitetit, madje patëm kërkuar që Kuvendi i atëhershëm i Kosovës t'ia merrte mandatin këtij ekipi dhe të zhvlerësonte të gjitha vendimet e tij, sepse ishim të bindur se po bënte marrëveshje në interes vetëm të tyre dhe jo të vendit.

Patëm reaguar jo pse nuk na interesonin zgjedhjet, por për ne ishte e papranueshme forma dhe vendi ku arrihej kjo marrëveshje ku qëllim, pa dyshim, ishin interesat personale dhe partiake. Edhe atëherë vendimet merreshin diku larg dhe pa debate, duke i futur në lojë edhe disa nga institucionet ndërkombëtare. Besoj, që keni parasysh ndërhyrjet që iu bënë Kornizës Kushtetuese, e cila u pat bërë copë- copë vetëm e vetëm për t'i kënaqur apetitet e dikujt që pushtetin e shihte si formë mbijetese.

Si subjekt politik, para 3 javësh kemi kërkuar që ky Kuvend që sot po diskuton për zgjedhjet, të diskutonte, por nuk gjeti përkrahje dhe gatishmëri po thuaj se nga askush. Kemi kritikuar dhe po kritikojmë edhe sot formën se si po merren vendimet për Kosovën.

Presidenti i Kosovës reflekton në unitetin e popullit dhe mbi këtë bazë pa mohuar të drejtën e tij kushtetuese, konsiderojmë se për vendimet madhore do të duhej paraprakisht të kishte konsulta me subjektet politike parlamentare dhe jo parlamentare, si dhe me shoqërinë civile për të arritur pajtueshmëri për një proces kaq të rëndësishëm për të ardhmen e vendit dhe avancimin e demokracisë.

AKR-ja është e përkushtuar që të respektohet pikë për pikë Kushtetuta e Republikës dhe mbi këtë bazë do të mundohemi të japim edhe kontributin tonë, duke propozuar që ky Kuvend sot, pas këtij debati t'i harmonizojë qëndrimet e veta në formë të një deklaratë politike, me të cilën do të kërkojë që Presidenti t'i fillojë konsultimet e gjëra dhe mbi këtë bazë të marrë vendime të pranueshme nga të gjithë.

Sikur e dini, AKR-ja i ka bërë të qarta disa herë qëndrimet e veta lidhur me zgjedhjet dhe ka propozuar mesin e vitit 2010, si kohën më të përshtatshme dhe këtë duke u bazuar në disa fakte.

E para, është shumë me rëndësi që të kemi zgjedhje të ndara lokale nga ato parlamentare, për këtë iu referohem problemeve që u shënuan në zgjedhjet e vitit 2007.

Së dyti, AKR-ja mendon se ky mandat për shumë arsye duhet të llogaritet i plotë dhe, sikurse e dini, kjo mund të arrihet vetëm nëse kaluan 2 vjet nga hyrja në fuqi e Kushtetutës. Dhe, Kosova ka shumë nevojë që t'i orientojë energjitë e veta në drejtim të konsolidimit të shtetit si në aspektin politik, juridik dhe atë ndërkombëtar.

Kolegë, në fund jam shumë i interesuar, por besoj edhe opinioni i gjerë, që të mësoj për të vërtetën e asaj që tash e disa javë është shndërruar në përplase midis subjekteve politike, natyrisht, përpos AKR-së, për ekzistencën e një marrëveshjeje të arritur në atë kohë nga po këto subjekte politike, sigurisht gjatë udhëtimeve të përfaqësuesve të tyre me aeroplan në relacionin Prishtinë – Vjenë.

Para vetes, zoti Kryetar, kam një intervistë tuajën dhënë të përditshmes “Epoka e Re”, në të cilën deklaroni se ka pasur një marrëveshje të tillë. Besoj se opinioni e meriton ta dijë të vërtetën, sepse në të kundërtën do të shfaqet dyshimi se kushedi edhe sa marrëveshje të tjera keni mundur t'i arrini për të cilat nuk dihet asgjë, e që pasojat e tyre mund të jenë

shumë të dëmshme për të ardhmen e vendit tonë. Këtë ia keni borxh ju që keni qenë në atë kohë në skenën politike dhe që keni arritur marrëveshje të tilla në dëm të qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Ibrahim, lexoje “Epokën” e sotshme.

Vazhdojmë, AKR-ja e ka kryer.

Tash e ka fjalën shefi i Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Patëm rastin ta dëgjojmë edhe ekspozenë e kërkuesit të interpelancës, por edhe të parafolësve dhe ajo çka sot jemi të interesuar është që ky Kuvend të reflektojë nevojën që në Kosovë të respektohet legaliteti dhe ligjshmëria e dokumenteve mbi bazën në të cilën do të adresohet edhe çështja e zgjedhjeve. Zgjedhjet, jo vetëm që kanë rëndësi të madhe, ne e dimë të gjithë së bashku rëndësinë, mirëpo kjo vlerë kapitale e zgjedhjeve konsiderohet edhe parametri kryesor për kafen e zhvillimeve politike, demokratizimin, ndërsa në rastin e Kosovës shpreh edhe nevojën për një kulturë politike dhe vetëdije që identifikohet kryekëput me rastin e zgjedhjeve, ato të cilat, në zgjedhjet e gjertanishme Kosova ka dhënë sinjale pozitive, mirëpo qasjen dhe vendimin e gjertanishëm dhe sidomos i Presidentit të Kosovës sa i përket zgjedhjeve, Lidhja Demokratike e Dardanisë e vlerëson degraduese në raport me investimet e gjertanishme të faktorit ndërkombëtar dhe vendor që, kur bëhet fjalë për zgjedhjet, të kemi një qasje dhe një praktikë koncesuale. Deri tash kjo ka munguar dhe ne këtë qasje e konsiderojmë politikisht dhe legalisht të dëmshme dhe qasje plotësisht të gabuar.

Interpretimi për zgjedhje që është bërë deri tash dhe në lidhje me kohën e mbajtjes së zgjedhjeve, përveç që është një shmangie e qëllimshme e obligimeve që dalin nga marrëveshja koncesuale, e ashtuquajtura Pako e Presidentit Ahtisari, e konsiderojmë edhe një shkelje të rëndë Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Është folur edhe për historinë e zhvillimeve të cilat kanë ndodhur, që një pjesë e spektrit opozitar nuk ka qenë pjesë e atij tregimi, por konsiderojmë që të gjitha ato marrëveshje, qoftë gojore, qoftë me shkrim të cilat nuk e kanë marrë formatin legal, qoftë përmes ligjeve, qoftë përmes Kushtetutës, nuk obligojnë dhe nuk janë obligative për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe nuk janë obliguese për asnjë institucion në vend. Prandaj, ajo mund të mbetet si një histori, një tregim që për dikë mund të ketë vlerë, mirëpo në rastin tonë konkret, ne kërkojmë që të respektohen normat kushtetuese dhe obligimet të cilat i kanë marrë Qeveria e Republikës së Kosovës dhe të gjitha institucionet në veçanti.

Konsiderojmë se interpretimi që u është bërë, interpretimi selektiv i Pakos dhe mosrespektimi i Kushtetutës, duke iu shmangur kësaj çfarë po debatojmë deri më tash, tregon frikën më të madhe dhe për një krizë që mbizotëron në përbërjen e koalicionit qeverisës

Kur flasim për krizë, kemi të bëjmë me argumente dhe fakte konkrete. Seanca e djeshme vërtetoi se sa jemi në nivel të vetëdijes shtet formuese dhe në nivel të vetëdijes që ndërtojmë institucione demokratike dhe është parë çfarë porosie mund të ndërtojnë dhe çfarë porosie mund të plasojnë institucionet e vendit kur kanë të bëjnë me vetëdijen shtet formuese dhe kulturën politike.

Qeveria mund dhe ka të drejtë t'i ofrojë argumentet e veta, mirëpo ajo çfarë është dëshmuar deri më tash, dëshmon pikë së pari se zgjedhjet janë shumë të rëndësishme. Pse janë shumë të rëndësishme zgjedhjet? Janë të rëndësishme për ta ndalur këtë erozion i cili e ka kapluar sistemin institucional të vendit. Kur flas për këtë erozion, kemi porosi shumë të qarta edhe të mekanizmave ndërkombëtarë. Porosia e qartë që është dhënë prej përfaqësuesit të ICO-s në Asamblenë Evropiane, tregon më së mirë se në çfarë gjendje sot janë institucionet e Kosovës. Nëse doni që binarët apo kohen e këtij debati ta orientojmë në zhvillimet të cilat po ndodhin në institucionet e vendit, është diçka që nuk i shkon përshtati, më së paku u shkon përshtati Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës. Mirëpo, me zgjedhjet ne tregojmë kulturën tonë shtetformuese që duhet të plasojmë atëherë kur është më se e nevojshme. Ne konsiderojmë se nuk jemi ata fajterat për ta mbrojtur, qoftë Pakon e Presidentit Ahtisari, apo ndonjë dokument për të cilin është shumë i dhimbshëm dhe jemi deklaruar të gjithë së bashku që pasojat e atyre dokumenteve do t'i vuajmë në praktikë. Mirëpo, kur bëhet fjalë për interpretime selektive dhe kur bëhet fjalë të selektojmë atë çka dëshirojmë ta implementojmë dhe, në anën tjetër, të mos e implementojmë atë çka është, vetë iu kontribuon proceseve zhvillimore dhe demokracisë në vend dhe ta implementojmë atë çka është shumë e dëmshme dhe shumë e dhimbshme, është diçka një çështje jo degraduese, është një qasje që do t'i kushtojë perspektivës së vendit tonë. Ne konsiderojmë se Gjykata Kushtetuese, e cila është në themelim e sipër, do të ketë shumë punë t'i konsiderojë të gjitha këto shkelje kushtetuese që po i bëjnë institucionet e Republikës së Kosovës.

Presidenti, se e shkel Kushtetutën, kjo nuk është diçka e re. Ai e ka shkelur vazhdimisht. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, me keqardhje sot konsiderojmë dhe konstatojmë, se nuk respektohet dhe nuk mund të presim për diçka që do të jetë e kushtueshme dhe e dhimbshme për koalicionin qeverisës ta respektojë dhe ta implementojë.

Prapë jemi të qëndrimit që duhet të respektohen dokumentet legale. Mirëpo, interpretimi selektiv dhe interpretimi i dyanshëm është një porosi shumë e keqe për institucionet e vendit. Është një porosi e keqe për të gjithë miqtë ndërkombëtarë, të cilët kanë investuar dhe po investojnë në zhvillimet e demokracisë në vend dhe defenitivisht është një porosi që nuk jemi të interesuar të krijojmë kredibilitet institucional.

Nëse mendoni se, sikur të shtyhen dhe të prolongohen proceset, ashtu qysh po prolongohen gjer tani, në të gjitha sferat, është një porosi e mirë- vazhdoni ta adresoni edhe më tutje. Ne jemi shumë skeptik që seanca plenare mund ta adresojë këtë çështje në kuptimin e respektimit të ligjshmërisë, mirëpo së paku të tregojmë vullnetin e mirë se në Kuvendin e Kosovës mbizotëron argumenti i arsyes, që deri tani në shumicën e rasteve nuk ka ekzistuar dhe kjo është për keqardhje. Si grup parlamentar, konsiderojmë që vendimi për zgjedhje do të jetë në përputhje të plotë me vendimin i cili respekton konsensusin partiak, parlamentar dhe jo parlamentar, në mënyrë që ta dëshmojmë një praktikë që është dëshmuar më herët, që kur bëhet fjalë për zgjedhje, të tregojmë një kulturë shtet formuese. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit "7+", deputeti Xhezair Murati e ka fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Poštovani predsjedniče, gospodo zamenici premijera, ministri, kolege poslanici, gosti,

Na pitanje, izbori, da ili ne, odgovaramo da lokalni izbori krajem ove godine, i takodje da parlamentarnim izborima, ali 2011. jer je sve bazirano na činjenici da smo bili svesni i prilikom održavanja poslednjih izbora ovih rokova. Ne verujem da u ovom parlamentu ima i jedan poslanik koji ne zna ovo, ili da to osporava.

Centralni izbori su sporni za jedan dio opozicije. Opozicija, kao što smo čuli, zamjera zašto predsednik nije vršio konsultacije sa političkim subjektima. Predsednik je samo potvrdio odluke koje su postojale i za koje znamo. Kada se ogovori o izborima, onda se svakako moramo pozvati na pravnu regulativu, dakle na Ahtisarijev dokumenat i na Ustav. Kada je usvojen Ahtisarijev paket? Ovaj je Parlament ga je usvojio 5. aprila 2007. godine, izbori koji su održani noverembra 2007. godine takodje su u skladu sa odredbom istog dokumenta da budu održani u vremenu do 9 mjeseci.

S druge strane, ako se za početak primjene Ahtisarijevog paketa uzme dan proglašenja nezavisnosti Kosova, dakle 17. februar, i po njemu je taj rok istekao već je godina dana, kao što znamo, dakle rok je probijen. Ako se pak uzme jesen 2009.godine, kao što dio opozicije predlaže za izbore, onda je taj rok mnogo, mnogo duži, a da ne govorimo o nekim takozvanim balansiranim predlozima da izbori centralni budu 2010. godine. Nama manjinskim zajednicama, gospodo, ne odgovaraju skraćeni mandati, jer u Ustavu se pominju da naši rezervisani mandati traju dva mandata, rezervisana mjesta. Ta dva mandata su garantovana, a razlike izmedju rezervisanih i grantovanih su velike za one koji malo dublje poznaju ovu problematiku.

Dakle, postavlja se pitanje: Zašto niko nije reagovao pri usvajanju Ustava, jer je i opozicija bila dio njegove izrade. Svi to znamo, tada niko nije reagovao. Ako Ustav nije u skladu sa Ahtisarijevim paketom, zašto se dakle nije reagovalo, a u njemu se jasno predviđa trajanje mandata centralnih izbora. Jasno, vrlo jasno. E, sada, normalno neki se suprostavljaju takvom mišljenju. I pri kraju, opoziciji nimalo ne zamjeram zašto se bavi održavanjem izbora. To je praksa u mnogim parlamentarnim zemljama i to je de fakto tako. Ali, sada se postavlja jedno pitanje, ali, novi izbori se održavaju kada je Vlada ili Skupština puna promašaja, afera, korupcije, ne znam nesposobnosti, i tako dalje, i tako dalje. Mi smo do sada pričali o tome, a nikada ništa nije dokazano. Nikada ništa u pravu, pravnici kažu, nevin si dokle se god ne osudiš. I Vlada je sposobna dokle god joj neko suprotno ne dokaže. E, sad, drugo je pitanje kada smo u koluarima, izmedju ovako u hodnicima i razgovaramo o svemu. Nekako se svi slažemo da prodje ovaj mandat onako kako je predviđen. Eh, sada, kada dodjemo u skupštinsku govornicu, da li zbog naših nekih lidera, dali zbog nekih ličnih sujeta nekih pojedinaca, onda smo svi drugačiji raspoređeni i drugačije razgovaramo, i tako dalje.

E, sad, još nešto gospodo. Mi kao političari moramo da budemo svijesni da li smo se nekada bavili argumentovanim analizama koliko nas koštaju izbori, kolika je izlaznost svake godine, svaki put sve manja, dali naši građani imaju više snage da slušaju naša prepucavanja međupartijska, ili treba naše aktivnosti da usmjerimo da pred međunarodnom zajednicom podigmeno imidž, da uspješnije lobiramo i dokažemo da smo sposobne institucije, preko potrebne za lobiranje, kako bi smo ušli u međunarodne organizacije, asocijacije i tako dalje, i tim stvarima treba malo da se pozabavimo. Hvala Vam!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të SLS-së, nuk ka. Në emër të Grupit “Zajedno”, a e do fjalën Petković?

SLAVIŠA PETKOVIĆ: Hvala gospodine predsedniče! Ne znam zašto me pitate jel hoćemo reč, pa normalno da hoćemo...

KRYETARI: Nuk je lajmeruar.

SLAVIŠA PETKOVIĆ: Prvo, što se nas manjinskih zajednica tiče, Džezair je rekao malo pre, mi imamo sa tim rezevisenim mestima, ali ja koliko shvatam iz ove rasprave, ovde nije više pitanje -izbori da ili ne, nego dali će se Ustav poštovati ili neće. Do sada vladajuća koalicija nije baš pokazala želju da poštuje Ustav u mongim pitanjima, pa ne verujem da će i ovde. Tako da se mi nećemo upuštati u raspravu oko toga, ostavljamo vama većinskoj zajednici da pokažete narodu Kosova oćete li poštovati Ustav koji ste doneli ili nećete, a s obzirom na raspravu vladajućih šefova poslaničkih grupa, ja mislim da je najbolje da se ovde preimenujemo u monarhiju pa da izbora nikada ne bude, pa šta ima veze, najbolje je tako. Hvala najlepša!

KRYESUESI XHEZAI R MURATI: Hvala, gospodine Petkoviću! Iscrpli smo dakle izlaganja šefova parlamentarnih grupa. Pred nama je ovde spisak prijavljenih kandidata, i on ide redosledom. Dakle, prva je Gjylaze Syla pa ndadalje, ali upozoravam poslanike, dakle govornike da se drže vremena. Svaka grupa, računajući šefove ima onoliku minutažu, koliki je broj poslanika u skupštinskim redovima. Molim vasa da o tome... Izvinite, dogovor je takav, godpodjo Gaxherri! Dobro, u redu, u redu! Nastavljam da pozivam gospodju Gjylazu Syla. Izvolite, kolegнице!

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit!

I nderuari zoti kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Debati i sotëm për shtyrjen e zgjedhjeve për vitin 2011 është shumë i rëndësishëm si për pozitën, ashtu për opozitën, por edhe për popullin e Kosovës. Pse? Për pozitën për të dëshmuar se është në gjendje për ta respektuar Kushtetutën, ligjet dhe marrëveshjen e Ahtisarit, për opozitën për ta mbajtur të përgjegjshme pozitën, për popullin e Kosovës edhe më shumë është me rëndësi për arsye se, deri në shpalljen e pavarësisë, populli i Kosovës është krijuesi i shtetit të Kosovës. Me shpalljen e pavarësisë, hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Kosovës, populli i Kosovës duhet të jetë pjesëmarrës në ndërtimin shtetit të Kosovës.

Vendimi që ka marrë Kryetari i Kosovës, që zgjedhjet parlamentare të shtyhen për vitin 2011, është i gabueshëm dhe nuk e ndihmon demokratizimin e vendit. Arsyetimet janë gjithashtu të paqëndrueshme. Mënyra se si e ka marrë Kryetari i Kosovës vendimin, është mënyrë e bazuar në argumentin e forcës. E kam fuqinë dhe do ta shfrytëzoj dhe do ta bëj, kurse unë do t'i parashtoj të kundërtën se këto janë të paqëndrueshme dhe do të përdor forcën e argumentit.

E para, sipas Kushtetutës, neni 83, Kryetari i Kosovës përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës dhe është garantues i funksionit demokratik të institucioneve të Kosovës. Duke e marrë vendimin pa asnjë konsultë me opozitën brenda Kuvendit, por edhe me partitë parlamentare jashtë Kuvendit, Presidenti e ka vënë veten si kryetar i koalicionit qeverisës.

E dyta, të mos harrojmë që shteti i Kosovës është shtet parlamentar. Çka do të thotë, nuk kemi sistem presidencial që ai të vendosë dhe nuk është i zgjedhur drejtpërdrejt, është i

zgjedhur nga ky Kuvend, ashtu si është zgjedhur edhe Qeveria, prandaj për të marrë vendimin për zgjedhjet, Kryetari i Kosovës duhet dhe ka përgjegjësi të komunikojë me opozitën, të arrijë konsensusin me opozitën dhe pastaj të marrë vendime.

E treta, pa mbajtjen e zgjedhjeve, Kushtetuta nuk është plotësisht e zbatueshme. Dispozitat e tanishme, që jemi dëshmitarë, e mundësojnë që Kryeministri, zëvendëskryeministrat, ministrat të jenë deputetë dhe të jenë gjithashtu anëtarë të ekzekutivit, çka do të thotë funksioni i Kuvendit është mbikëqyrja dhe llogaridhënia. Në qoftë se Kryeministri dhe anëtarë tjerë të Qeverisë janë gjithashtu në legjislativ, si do ta mbikëqyrin veten, si do ta bëjnë funksionin e llogaridhënies?

Meqenëse është thënë në Kushtetutë se ky ndërrim nuk do të bëhet derisa të mbahen zgjedhjet parlamentare, atëherë kjo flet gjithashtu edhe për mënyrën e qeverisjes. Nuk mund të kemi qeverisje të mirë në qoftë se nuk aplikohet plotësisht Kushtetuta e Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi më 15 qershor.

E katërta, pse kjo nguti? Në qoftë se është ashtu si tha shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së se janë të sigurt në fitore, unë ju ftoj atëherë të pajtoheni me mendimin e opozitës se janë të nevojshme për arsye se vetëm do të konfirmonit fitoren, apo jo. Sipas mendimit tim, shqetësimi vjen më tepër nga frika e ndarjes së koalicionit, frika nga humbja apo mund të vijë edhe se duhet të rregullohen përbrenda disa çështje që i kanë partitë në koalicion, PDK-ja dhe LDK-ja.

E pesta, nuk është zbatuar neni 10.5 i marrëveshjes së Ahtisarit, sipas së cilës zgjedhjet lokale dhe të përgjithshme duhet të mbahen 9 muaj pas hyrjes në fuqi të Propozimit të Ahtisarit. Arsyetimet se zgjedhjet janë mbajtur gjithashtu është i paqëndrueshëm. Ky Kuvend dhe kjo Qeveri janë zgjedhur sipas Kornizës Kushtetuese dhe jo sipas Kushtetutës së Kosovës. Në qoftë se zgjedhja e Kryeministrit është bërë si dhe e këtij Kuvendit, sipas Kornizës Kushtetuese, atëherë natyrisht që ne duhet menjëherë të kemi zgjedhje sipas Kushtetutës së Kosovës, sipas të cilës autor dhe bartës është populli i Kosovës. Ju e dini se cilat janë zgjedhjet sipas Kornizës.

Përndryshe, ne paskemi votuar atëherë në shtetin e Kosovës, i cili t'ju kujtoj se është shpallur më 17 shkurt 2008, domethënë 3 muaj më vonë.

Nga argumentet e mësipërme del se vendimi i Kryetarit më shumë është i bazuar në ruajtjen e pushtetit se sa të shtetit.

Të nderuar deputetë,

Veprimet e Kryetarit të shtetit dhe të koalicionit duhet të jenë të drejta dhe demokratike, të bazuara në ligj dhe në Kushtetutë. Prandaj, ftoj Kryetarin që të korrigjojë veprimin e tij jokushtetues dhejolligjor dhe menjëherë të konsultohet me opozitën për të marrë veprimin e drejtë dhe demokratik.

Në fund, të nderuar pushtetarë, pushteti humbet dhe fitohet përmes votuesit, prandaj votuesit le të vendosin kë do ta votojnë në zgjedhjet e sivjetme.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala, poslanice Sylja!

Riječ ima poslanik Numan Balić, neka se pripremi poslanik Adem Salihaj.

NUMAN BALIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Najprije da selamim sve koji su prisutni u sali i da kažem nekoliko riječi oko pitanja izbora, i da najprije napomenem da pitanje izbora nije samo pitanje stranaka na vlasti ili pozicije, niti onih stranaka koji nisu u vlasti, odnosno opozicije, niti je to pitanje međusobnih inata, nego je pitanje izbora, pitanje svih stranaka, svih nacionalnosti na Kosovu, naroda Kosova i, naravno, onih koji nam pomažu, međunarodne zajednice, civilnog predstavnika i ostalih ljudi koji su ovde. Dakle, u pitanju je vrlo važno pitanje po kojim se ne može tako jednostrano ili posesivno prilaziti, nego ono o kome moramo objektivno i pošteno raspravljati.

Na pitanju izbora se razmatraju sve nelogičnosti i kontradikcije koje postoje između ključnih dokumenata, ako hoćemo i između nas samih, političkih predstavnika, koji prihvatamo ili radimo na tim dokumentima, na njihovom sprovođenju ovdje na Kosovu.

Na jednoj strani imamo Ahtisarijev dokument, odnosno prijedlog o sveobuhvatnom takozvanom riješenju Kosova, na drugoj strani imamo dokumenta, zakone i Ustav, kao najviši dokument ove zemlje, koji proističu iz ovog Zakona. Ali, ovdje smo veoma dužni, dužni smo da obratimo pažnju na velike neusklađenosti i pravne neutemeljivosti i jednu veliku mogućnost proizvoljnog tumačenja svih ovih dokumenata. Mislim da je namjerno postavljeno kukavičje jaje oko svih ovih dokumenata i oko Ahtisarijev predloga i oko svih naknadnih zakona i dokumenata, ako hoćete i oko Ustava, vezano za interpretaciju ovih stvari.

Evo koje su glavne kontradikcije. Najprije, Ahtisarijev predlog za rešenja statusa Kosova kaže da će najmanje 9 mjeseci od stupanja na snagu ovog riješenja, citiram: „Kosovo organizovati opšte izbore i opštinske izbore, u skladu sa ovim riješenjem i novim opštinskim granicama“. Oni koji budno čitaju ovo pitanje i budno razmišljaju o ovome, vide nekoliko riječi koje su vrlo bitne. Na jednoj strani, strupanje na snagu. Ahtisarijev predlog uopšte ne definiše način stupanja na snagu ovog prijedloga. Svaki valjani pravni dokument, bilo kosovski li međunarodni, kaže, jasno definiše kako neki dokument stupa na snagu. Pravници koji ovdje postoje, i podpredsjednik Vlade i ministri znaju i ostali vi, koji ste ovdje poslanici, koji su pravници znaju vrlo dobro da svaki najviši dokumenat mora jasno definisati kako on stupa na snagu. Ustav Kosova kaže jasno. U Ustavu Kosova kaže: „Ustav Kosova stupa na snagu 15. juna 2008. godine“, i time je sve riješeno. Medjutim, Ahtisarijev prijedlog, koji je nastao kao rezultat pregovora između Beograda, Prištine i međunarodnih predstavnika, po pravilu i prema načinu postizanja, trebao je da sadrži i potpise ili dogovor sve tri strane.

Medjutim, nama ostavljeno, ja bih to slobodno nazvao zamkom, da mi sami usvojimo taj zakon, odnosno ovaj Ahtisarijev prijedlog, i onda je naravno ostavljeno mnogim zemljama u svetu da nas prozivaju, ili to nazivaju jednostranim proglašenjem nezavisnost, što je vrlo veliki problem.

Na drugoj strani, ovdje postoji pitanje opštinskih izbora. Dakle, nisu samo u pitanju opšti izbori, nego i opštinski izbori. Jasno se kaže u ovom dokumentu, pominju se nove opštinske granice, dalji, aneks tri kaže da će se nove opštinske granice napraviti tako što će međunarodni civilni predstavnik, u dogovoru sa lokalnim zajednicama, najčešće u ovom slučaju srpskom zajednicom, napraviti opštinske timove za pripremu i organizirati izbore. Molim vas ljepo, mi na Kosovu uopšte nismo uradili taj posao. Dakle, ovaj član

uopšte nije ispunjen i na osnovu ovoga člana mi nemamo uslove za održavanje opštinskih izbora zato što nije došlo do konstituiranja novih opština. Dakle, postoje jako veliki problemi, a da ne govorimo o problemima vezano za datume. Dakle, ako se uzme da je Ahtisarijev paket usvojen 5. aprila i da je, navodno, u roku od 9 mjeseci trebalo biti održani izbori, međutim zamka u svemu tome je, Ahtisarijev paket kaže jasno da postoji prelazni period od 120 dana, molim vas, prelazni period od 120 dana, i za tih 4 mjeseca je UNMIK trebao da izgubi svoj mandat, UNMIK-u je trebao prestati mandat. Čta se dešava? UNMIK i dalje postoji, Rezolucija 1244 i dalje je na snazi, i šta se još dešava? U roku od tog prelaznog perioda je trebao biti usvojen Ustav Kosova. Ustav Kosova, gospodo, je trebao biti usvojen u roku od 4 mjeseca nakon Ahtisarijevog paketa. To se nije desilo i onda mi ne možemo računati tih 9 mjeseci od 15 aprilla 2007. godine. Ove su veoma važne stvari koje otvaraju krupne dileme koje se tiču ovog prijedloga Ahtisarijevog, Ustava Kosova, održavanja izbora i svega ostaloga.

Smatram da ovo pitanje treba da se razmatra na najbolji način. Smatram da takodje trebamo poštivati praksu koja postoji u najvećim broju novih zemalja koje su proglasile države, proglasile ustave, i gde je shodno tome, najčešće primjer da nakon proglašenja država, usvajanje ustava, da se održavaju i novi izbori. To je pošteno, to se radi u svim zemljama na svijetu, u svim državama koji drže do sebe i treba postupiti onako kako nalaže dostojanstvo utvrđeno međunarodnim ponašanjem novih političkih faktora i novih država na svijetu. Mislim da pitanje Ahtisarijevog prijedloga i pitanje Ustava Kosova treba temeljito razmotriti i treba temeljito obratiti pažnju na sve njegove komponente, posebno vezano za državnost, za sprovođenje izbora i sva ostala pitanja koja sam spomenuo. Toliko sam hteo da dam doprinos ovoj diskusiji. Hvala vam ljepo!

KRYESUESI: Hvala, vam! Gospodin Adem Salihaj, neka se pripremai poslanik Rasim Selmanaj.

ADEM SALIHAI: Zoti kryesues!

Kolegë deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Mendoj që është shumë pozitive që Grupi i AAK-së e vuri në rend dite çështjen e zgjedhjeve. Ne e kemi një fushatë të vazhdueshme në media për çdo ditë, kjo është një temë shumë aktuale dhe mendoj që ka qenë momenti i fundit që, së paku të debatohet këtu, ndonëse jemi të vetëdijshëm që nuk do të marrin asnjë vendim e as nuk do të kemi konkluzione. Çështjet janë parimore, por secila anë mendon që ka të drejtë në parimet e saj. Kushtetuta ka disa dispozita që i përcaktojnë këto çështje. Pozita thirret në nenin 161, opozita në nenin 143 dhe mendoj që çështjet mund të jenë të qarta po që se duam të jemi të qartë.

Do të kthehem përsëri te çështjet, te dispozitat kushtetuese, por dëshiroj ta shpreh mendimin tim a do të ishte mirë një shtet, i cili e ka shpallur pavarësinë e tij, të mbajë zgjedhje të lira të një shteti të pavarur apo të mos mbajë? Mendoj se është një praktikë gjithkund në botë që secili shtet pas çlirimit ose pavarësisë, ka mbajtur zgjedhje për ta konfirmuar përfundimisht vullnetin e tij edhe për çështjen e pavarësisë, po edhe për çështjen e pushtetit në të gjitha nivelet. Dhe, do të ishte një anë e mirë shumë pozitive e zhvillimeve demokratike në Kosovë, që këto zgjedhje të mbaheshin në Kosovën e pavarur, që qytetarët e Kosovës tash, në mënyrë plotësisht të lirë ta shprehin vullnetin e tyre dhe ne ta konfirmojmë pjekurinë dhe aftësinë tonë si vend dhe si popull që t'i zhvillojmë proceset demokratike me sukses në Kosovë.

Mendoj se ky do të ishte argumenti më i mirë dhe nuk do të ishte i dëmshëm as për pozitën, as për opozitën. Në anën tjetër, e kemi shumë të qartë se Kushtetuta komentohet ose zbatohet në mënyrë selektive, zbatohet ai nën që i përgjigjet pozitës dhe nuk zbatohet nën tjetër që nuk i përgjigjet asaj. Po ashtu, edhe te Propozimi gjithëpërfshirës i Presidentit Ahtisari zbatohen në mënyrë selektive dispozitat e këtij propozimi.

Konkretisht, po e zëmë, te pika 10 e Propozimit, ku parashihet mbajtja e zgjedhjeve 6 deri 9 muaj pas shpalljes së pavarësisë, tash kjo dispozitë aplikohet vetëm për zgjedhjet lokale dhe aplikohet vetëm për arsye se duhet të formohen komuna të reja të komuniteteve pakicë, jo për interesat e të gjithë qytetarëve të Kosovës. Do të thotë, këto janë anë negative të zbatimit selektiv edhe të Propozimit gjithëpërfshirës, edhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Dhe, këtu u tha që askush s' ka kundërshtuar asnjë nën. Ne, në fakt, as që kemi mundur të diskutojmë, as të votojmë për aprovimin e Kushtetutës së Kosovës, por kjo është një çështje e kryer dhe s' duam ta vëmë në pyetje këtë, por është një realitet.

Në anën tjetër, ka këtu argumente se do të ishte kohë e humbur mbajtja e zgjedhjeve. Sipas kësaj logjike, nuk duhet mbajtur zgjedhje sepse humbim kohë, mendoj se nuk është një argument. Mendoj se zgjedhjet janë një verifikim i pjekurisë demokratike të një vendi dhe të një populli dhe është mirë të mbahen, bile në vendet e ndryshme mbahen, jo vetëm si në rastin tonë, kur e kemi shpallur pavarësinë, por nëse lind një rrethanë e rëndësishme brenda atij shteti, mbahen zgjedhje të reja. Mbahen zgjedhje të reja edhe në Irak, Afganistan dhe në shumë shtete që kanë probleme tepër të mëdha dhe në asnjë aspekt s' mund të krahasohen me ne. Dhe, unë do të isha krenar sikur Kosova të mbante zgjedhje dhe të tregonte pjekuri më të madhe se shumica e vendeve në rajon dhe ne do të ishim krenarë që kemi këtë aftësi dhe pjekuri politike që ta bëjmë këtë.

Çështja ose argumenti se opozita kërkon zgjedhje, por s' është në fakt e interesuar t'i mbajë, mendoj se nuk qëndron, sepse ne mund ta provojmë këtë shumë lehtë, t'i shpallim zgjedhjet, ta shohim a jemi apo nuk jemi të interesuar t'i mbajmë ato?

Një arsye e madhe për mbajtjen e zgjedhjeve është edhe mospajtimi ose dështimi i këtij koalicioni në shumë çështje të mëdha dhe të rëndësishme me interes të madh nacional për Kosovën. Kemi probleme të mëdha në zbatimin Kushtetutës në terren, kemi një pjesë të madhe të territorit të Kosovës ku nuk funksionon Kushtetuta e Kosovës, kemi krijimin e pushtetit i cili nuk është nën kontroll të institucioneve të Kosovës, ku nuk zbatohet Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës. Pastaj, kemi vonesa të mëdha në krijimin e institucioneve vitale për Kosovën, vonesa të mëdha që janë pasojë ose e paaftësisë ose e ndërthurjes së interesave të ndryshme brenda koalicionit, për Forcën e Sigurisë, për Agjencionin e Inteligjencës, për Sekretariatit e KQZ-së, për Avokatin e Popullit, për shumë çështje tjera të mëdha për të cilat pozita është vonuar tepër shumë dhe i ka dëmtuar tepër shumë interesat e Kosovës. Pra, kemi shumë arsye që t'i mbajmë zgjedhjet, që të verifikohet a e ka përsëri përkrahjen ky koalicion qeverisës apo nuk e ka, a e ka sikur e ka tash, a e ka më të vogël apo, siç po thoni ju, edhe më të madhe dhe ne do ta kishim pranuar këtë realitet. Nëse është përkrahja më e madhe, pse të mos e pranojmë, sepse askush s' ka të drejtë ta kundërshtojë vullnetin e qytetarëve të Kosovës.

Kemi edhe shenja shqetësuese, kemi kontradikta në komentime, në sqarime, zbatohet apo jo plani 6 pikësh, i cili e cenon tepër shumë sovranitetin e Kosovës. Ka shenja se ai zbatohet, se Qeveria e Kosovës ose Doganat e Kosovës nuk kanë qasje në pikat doganore në veri të Kosovës dhe në disa çështje tjera. Pra, kemi një grumbull argumentesh të cilat

janë në favor të mbajtjes së zgjedhjeve dhe të verifikimit të mandatit të koalicionit qeverisës. Unë mendoj që do të ishte shumë pozitive nëse Presidenti i Kosovës i pari e respekton dhe e komenton drejt Kushtetutën e Kosovës. Për fat të keq, kemi pasur rastin që vetë Presidenti, i cili është personaliteti më i rëndësishëm i këtij shteti, nuk e respekton Kushtetutën e Kosovës, mban një post partiak në kundërshtim me dispozitat e kësaj Kushtetute dhe ia përshtat Kushtetutën e Kosovës interesave të tij. Nuk i përshtatet ai dispozitave të Kushtetutës, por dispozitat e Kushtetutës ua përshtat interesave të tij edhe në çështjen e funksionit partiak, edhe në çështjen e zgjatjes së mandatit qeverisës, e tjera. Ne kemi pasur edhe raste tjera, por nuk janë demokratike. Kemi parë rastin, po e zëmë, në Rusi ku ndryshohet kushtetuta për interes të një ose dy individëve, zgjatet mandati në 6 vjet vetëm për interesa individuale e tjera, e tjera. Këto nuk janë pozitive për Kosovën dhe mendoj që nuk duhet të veprojmë kështu. Duhet ta bëjmë të kundërtën, duhet ta zbatojmë Kushtetutën edhe kur nuk është në interes tonin personal, grupor apo të koalicionit qeverisës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala vam, poslaniče Salihaj. Riječ ima poslanik Rasim Selmanaj, neka se pripremi poslanik Naser Rugova.

RASIM SELMANAJ: I nderuari kryesues,  
I nderuari zëvendëskryeministër,  
Të nderuar ministra,  
Të nderuar kolegë deputetë të Parlamentit të Kosovës,  
Në prag të njëvjetorit të Pavarësisë, Republika e Kosovës ka fare pak me çka të krenohet, ka fare pak të arritura, të cilat më 17 shkurt do të mund t'ua prezantonte qytetarëve të saj.

Gjendja aktuale në vendin tonë karakterizohet me një numër sfidash në drejtimin e vendit dhe forcimin e shtetit ligjor. Edhe një vit pas shpalljes së Kosovës shtet i pavarur dhe sovran, nuk e kemi arritur integrimin e tërësisë territoriale të vendit tonë në një sistem të vetëm qeverisës. Veriu përditë e më shumë po aneksohet. Atje nuk ka Republikë, nuk ka Kushtetutë. Me një fjalë, atje nuk ka Kosovë. Drejtuesit institucional të vendit tonë po shprehen optimistë se Kosova së shpejti do të vazhdojë të njihet nga shtetet tjera anëtare të Kombeve të Bashkuara, por deri më tani njohjet janë të pakta. Para një viti ata na patën premtuar për 100 njohje të shpejta në ditët e para të pavarësisë, por edhe pas një viti ne kemi arritur t'i kemi vetëm 54 sosh.

Në vitin e parë të pavarësisë, Qeveria e Kosovës nuk ka treguar përkushtimin për zhvillimin ekonomik të vendit tonë. Kriza sociale dhe varfëria që e ka kapluar një pjesë të madhe të popullit tonë, po thellohet prej ditës në ditë.

Shëndetësia është në kolaps. Policia e Kosovës, e cila ka për detyrë mbajtjen e rendit ka treguar se është e gatshme për t'u futur në greva dhe protesta, shumë herë të paralajmëruara gjatë gjithë vitit të parë të shtetësisë sonë.

Para pavarësisë, autoritetet më të larta të vendit tonë ishin zotuar se do të vepronin në pajtim me të gjitha detyrimet që dalin nga Propozimi gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit të Kosovës dhe se do ta respektonin Kushtetutën e vendit tonë, por të nderuar kolegë deputetë, siç po e shihni edhe ju vet, kjo nuk është duke ndodhur. Pakoja e Presidentit Ahtisari është bërë si tavolinë suedeze, kurse Kushtetuta e Republikës po shkelet sa herë që i teket dikujt.

Të nderuar kolegë deputetë,

Sipas Dokumentit gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisari, zgjedhjet parlamentare në vendin tonë do të duhej të mbaheshin, jo më larg se 9 muaj pas zgjedhjes së statusit, kurse në Deklaratën e Pokantikos, të cilën e kanë nënshkruar të gjithë anëtarët e Ekipit të Unitetit, thuhet se zgjedhjet e përgjithshme duhet të mbahen, jo më larg se 6 muaj pas pavarësisë së vendit tonë.

Ishte vendosur kështu, ngase pas çdo realitetit të ri është e nevojshme të merret edhe konfirmimi i popullit, por kjo nuk po ndodh në Kosovë. Në vendet demokratike, mbajtja e zgjedhjeve të lira bëhet me qëllim që popujt të konfirmojnë legjitimitetin e institucioneve shtetërore, por tek ne në Kosovë, dikush po frikohet nga zgjedhjet edhe pse ato kohëve të fundit janë bërë faktor kryesor i demokratizimit anëmbanë globit.

Siç po shihet nga sjelljet e liderëve tanë institucional, preokupimi i tyre kryesor nuk duket të jetë zbatimi i ligjshmërisë, por ruajtja e pozitave të tyre shtetërore. Ne të gjithë jemi dakorduar vetëm për Pakon, si tërësi, dhe jo për implementimin parcial të saj. Në këtë rast, nëse dikush e prek një detaj të Pakos, e shkel atë hatri i appetiteve të veta, atëherë edhe të tjerët kanë të drejtë të prekin pjesë të tjera të saj e kompromise shumë të dhimbshme që dihet botërisht janë bërë brenda saj.

Kohë më parë, Kryetari i Kosovës me mbështetjen e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar në Kosovë, ka marrë një vendim, siç thuhet të nxituar, për shtyrjen e zgjedhjeve parlamentare për vitin 2011. E tërë kjo ka ndodhur në mënyrë të njëanshme, pa kurrfarë konsultimesh ndërmjet koalicionit qeverisës dhe partive opozitare. Edhe kësaj radhe, Presidenti i shtetit më të ri të botës, ka vendosur për një temë shumë të rëndësishme, pa e debatuar atë në media, duke e anashkaluar shoqërinë civile dhe opinionin publik.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kosova ka nevojë për stabilitet në skenën politike të vendit, prandaj konsultimet e rregullta midis partive politike dhe liderëve tanë institucional janë të nevojshme, po që se jemi të interesuar që ta kemi një stabilitet afatgjatë politik në vendin tonë. Duke i pasur parasysh të gjitha ato që i thashë më lartë, domosdoshmërisht duhet që Presidenti i cili e garanton Kushtetutën dhe që pretendon se përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës, të korrigjojë vendimin e tij të nxituar, duke i shpallur zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës brenda këtij viti. Kjo do të ishte në funksion të demokracisë, në të mirë të Kosovës dhe, natyrisht, në interes të qytetarëve tanë, në radhë të parë 70% prej të cilëve nuk kanë marrë pjesë në zgjedhjet e kaluara.

Të nderuar kolegë deputetë,

Dëshiroj të them se Qeveria e udhëhequr nga Kryeministri Hashim Thaçi, u gjet e papërgatitur për sfidat e mëdha të pas statusit, andaj kjo na nxjerr para domosdosë që zgjedhjet duhet të mbahen sa më parë. E shihni se si institucionet tona e kanë bërë seleksionimin e pjesëtarëve të TMK-së për FSK-në. Mendoj se gjatë seleksionimit është bërë një lojë e pahijshme dhe me plot hile, pavarësisht se kush e ka bërë përzgjedhjen, aty kanë ndodhur shkelje drastike. Shumë ish-ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, shumë meritore kanë mbetur jashtë, mendoj qëllimisht, kurse ndaj tyre në fazën e seleksionimit të kandidatëve të FSK-së ka ndodhur një diferencim i qartë e i kulluar. Me improvizime dhe politika të tilla nuk mund të ndërtohet më tej shteti ynë. Këto konstatime tashmë nuk janë vetëm të opozitës, por edhe të institucioneve ndërkombëtare mbështetëse të fuqishme në rrugën tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala vam, poslaniče Selmanaj. Riječ ima poslanik Naser Rugova, neka se priremi poslanik Gani Geci.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Unë do të fokusohem në pikën e rendit të ditës që është vendimi i Kryetarit të Kosovës lidhur me datën e zgjedhjeve.

Kosova është në gjendje tjetër politike dhe juridike pas 17 shkurtit të vitit të kaluar dhe duhet të logjikojmë si institucione shtetërore dhe si shtetas, e jo me logjikë të protektoratit që fatkeqësisht po vazhdojmë të mendojmë të konceptojmë dhe të veprojmë edhe në prag të kremtimit të njëvjetorit të shpalljes së pavarësisë. Ju lutem, këtu bëhet fjalë për çështje të rëndësishme nacionale. Së pari, po e marrim aktin më të lartë juridik të shtetit tonë- Kushtetutën, e cila shkelet me të dy këmbët. Nga kush? Nga njeriu që në Kushtetutë ka obligim ligjor dhe kushtetues që të jetë simbol i unitetit të popullit. Dhe, dihet çka do të thotë kur Kryetari i vendit e shkel dokumentin më të lartë juridik. Kjo nuk ka koment.

Vendimi për shtyrjen e zgjedhjeve daton që nga marrëveshjet parazgjedhore, qoftë publike, qoftë të fshehta dhe degradimet e tjera që i kanë bërë jo vullneti i zgjedhësve dhe i forumeve të atyre partive që tani e bëjnë koalicionin, por individët me pazare jo të mira që po e dëmtojnë shtetin dhe perspektivën e qytetarit të Kosovës. Pakoja e Ahtisarit është një dokument në bazë të të cilit buron edhe Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, edhe bërja e Kosovës shtet dhe nga ajo rrjedh edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Andaj, si qytetarë, si njerëz të politikës, si deputetë, si Qeveri, si Presidencë, jemi të obliguar që t'i respektojmë dhe në qoftë se nuk i respektojmë këto dokumente, atëherë procesi në Kosovë po degradon dita- ditës. Për këtë jemi dëshmitarë. Në Pakon e Ahtisarit thuhet në mënyrë recidive - zgjedhje 6 deri 9 muaj pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ne jemi legjislaturë e protektoratit. Edhe atëherë tentohej të zgjateshin mandatet 4, 5 e ndoshta për dëshira të Presidentit edhe 20 vjet s'do të duhej të organizoheshin zgjedhje fare. Çështjet kapitale për vendin, siç janë interpretimi i pikave të Pakos së Ahtisarit, implementimi i tyre, kemi marrë obligime ndërkombëtare shumë të dhembshme dhe duhet në mënyrë institucionale me një konsensus politik dhe nacional t'i shtyjme tutje. Jemi dëshmitarë kur u diskutua 6-pikëshi, i cili çdo ditë po implementohet në 30% të territorit të vendit tonë dhe atëherë Presidentit i bie ndërmend që ta ftojë opozitën çfarë të bëjmë dhe kërkonte përkrahje. 6-pikëshi: decentralizimi, bisedimet teknike, trashëgimia kulturore, zonat e mbrojtura, ju lutem, të nderuar partnerë të koalicionit qeverisës, do të na ftoni të bisedojmë e t'i kalojmë këto sfida, por frikohem se nuk do të përgjigjemi, sepse Pakoja e Ahtisarit, e sidomos decentralizimi dhe disa pika të tjera, ka këtu njerëz që folën, por tani e lëshuan Parlamentin, që kanë qenë kreatorë dhe që kanë lëshuar pe me një servilizëm të paparë në dëm të interesave të Kosovës. Këtë duhet ta themi. Këtë e kemi obligim. Ne jemi Republikë parlamentare dhe duhet ta themi në këtë foltore dhe në këtë vend. Mund të mos iu vijë mirë partnerëve të koalicionit, por dihen ata njerëz me emër dhe me mbiemër dhe le ta ulin kryet, le ta ulin kokën, sepse e kanë dëmtuar procesin dhe perspektivën e fëmijëve të Kosovës dhe për të gjitha ato qytetarët e Kosovës e dinë dhe u bëftë mirë! Për këtë arsye duhet të organizohen zgjedhjet, sepse edhe në atë marrëveshjen e famshme nuk kanë qenë dy subjekte politike – partia më e madhe opozitare dhe partia e dytë opozitare dhe një parti që dikur kishte nënshkruar atë marrëveshje, nuk është më në Parlament. Trendet dhe zhvillimet politike dhe socio-ekonomike dhe të gjithëmbarshme kanë

ndryshuar që nga nënshkrimi i asaj marrëveshjeje. Tani jemi edhe në rrethana tjera, edhe në trende të tjerë dhe duhet të marrim vendime konsensuale që dalin nga Pakoja e Ahtisarit dhe nga Kushtetuta e vendit. Në qoftë se po thoni që jemi Qeveria më e mirë në botë, po punojmë mirë dhe kemi pru lulëzim këto 360 ditë, sa po e qeverisni Kosovën, pse po frikoheni të hyni në zgjedhje, atëherë? E, duke e ditur që mbi 60% të qytetarëve të trupës elektorale të Kosovës nuk ka dalë në zgjedhje, t'i organizojmë këto zgjedhje me logjikën e shtetasve, me logjikën e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe demokracia e thotë fjalën e vet. Ju e dini, Presidenti i vendit si është zgjedhur këtu në këtë sallë. Me minus 17 vota të deputetëve të koalicionit qeverisës. Një kryetar i zgjedhur me paterica dhe me infuzion dhe që po vazhdon me infuzion ta çojë vendin në rrugë pa krye.

Duhet që zgjedhjet të organizohen, duhet të caktohet data në mënyrë konsensuale, sepse po degradon procesi i gjithëmbarshtëm që do ta shpie vendin në qorrsokak. Nuk e dëshiron askush një gjë të tillë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Gani, ndoshta, të kanë paralajmëruar ty, unë e kisha marrë fjalën një herë, e pastaj do ta kisha dhënë fjalën ty. Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Zëvendëskryeministër, ministra,

Dola si deputet, vërtet, por ndoshta më shumë dola si një nga njerëzit më të angazhuar në procesin dyvjeçar të bisedimeve në Vjenë, por edhe në procesin e përgatitjeve të zgjedhjeve. Një gjë dua t'ju them, që unë personalisht, edhe si njeri, edhe si deputet, jam i kënaqur më gjithë vështirësitë që i kemi pasur gjatë gjithë atyre bisedimeve, me frytin që ka rezultuar në fund të atyre bisedimeve. Dhe, mendoj se ai fryt që ka rezultuar në fund të bisedimeve, është i favorshëm dhe diçka e mundshme dhe jo e lehtë për Kosovën dhe qytetarët e saj.

Do të dal te çështja për të cilën po flasim. Më lejoni ta bëj një digresion. Kur është formuar koalicioni i kaluar në Kryesinë e Partisë Demokratike diskutohej se qysh t'ia bëjmë? Thashë, pajtohuni për tre dimra të jeni në opozitë e punoni gjatë kësaj kohe për të ardhur në pushtet, se nuk mund të ketë zgjedhje më herët. Do të thotë, edhe juve opozitës ju kisha sugjeruar ta pranoni pozicionin që e keni, se të gjithë ne që jemi këtu e dimë se zgjedhjet që janë bërë në nëntorin e vitit 2007 kanë pasur mandat 2 vjet për pushtetin lokal, 4 vjet për pushtetin qendror dhe 5 vjet për Presidentin e Kosovës dhe ju në këtë sallë, dhe ne së bashku, e kemi votuar me mandat 5 vjeçar Presidentin e Kosovës dhe askush s'ka kundërshtuar një gjë të tillë. E më së paku keni thënë se kjo s'është kushtetuese.

Çështja e zgjedhjeve është se ju po doni marrëveshje. Unë po ju them se marrëveshjet, të gjitha marrëveshjet janë të sublimuara në Kushtetutë dhe në hartimin e Kushtetutës kanë marrë pjesë: Hajredin Kuçi, si kryetar i Komisionit Kushtetues, Nekibe Kelmendi, zëvendëskryetare, Jakup Krasniqi, anëtar, Ramë Manaj, anëtar, Arsim Bajrami, anëtar, Eqrem Kryeziu, anëtar, Kadri Kryeziu, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, ka qenë anëtar, Skënder Hyseni, anëtar, Iliaz Ramajli prej ekspertëve, Luljeta Mushkolaj, eksperte, Mahir Yagcilar, nga komuniteti turk, Ramadan Kelmendi, nga Lidhja Demokratike e Dardanisë, Blerim Shala, atëherë i pavarur, tani nënkryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Riza Smaka, në emër të AKR-së e ka nënshkruar dhe prej Aleancës s'po i përmend të gjithë, sepse të tjerë janë edhe tre ekspertë: Fatmir Fehmiu, Lirie Osmani dhe Bajram Latifi, por edhe Xhevdet Neziraj, tash në emër të Komunitetit,

por që është deputet i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e ka nënshkruar këtë Kushtetutë. Dhe, sipas kësaj Kushtetute, pushteti lokal është 2 vjet, i ka pasur dy vjet, sivjet mbahen zgjedhjet, pushteti qendror 4 vjet, i bie më 2011 të mbahen zgjedhjet dhe Presidenti një vit më vonë, se i ka 5 vjet.

Tjetër, unë i kisha thënë opozitës që nuk është mirë të bëjë zhurmë se vërtet e dëmton Kushtetutën. Po thirrni në Dokumentin e Ahtisarit, por Kushtetuta mendoj që për ju duhet të jetë më e rëndësishme se çdo dokument tjetër, një. Dy, po thirrni në Peter Feith. Po Peter Feith e ka vërtetuar të njëjtën gjë që e ka thënë edhe Presidenti. Kur Peter Feith foli, jo bash krejt pozitivisht për Kuvendin, ju e mbështetët. Atëherë, mbështetni edhe për vendimin që e ka marrë. Mos i bëni, sepse nganjëherë edhe në shkencë njerëzit, për shembull, kur ky shkrimtari, historiani që ka shkruar për Skënderbeun, merr citime për Marin Barletin, për ta dëmtuar historinë e Skënderbeut. Por, kur është e favorshme Marin Barleti për historinë e Skënderbeut nuk e merr, nuk e njeh si burim të saktë. Do të thotë, këto çështje mendoj që janë, të gjithë e kemi ditur që jemi në këtë sallë, nëse jo ata që janë jashtë kësaj salle dhe ne mund të mashtrohemi, por janë zgjedhjet për pushtet lokal dhe mirë që janë në fund të këtij viti. Mateni një herë punën tuaj, shihni sa peshoni, shihni fuqinë tuaj dhe pas këtyre zgjedhjeve kërkon. Unë po dua t'ju them që i lëmë krejt këto. Kosova është në konsolidim të demokracisë. Është në konsolidim të institucioneve të veta. Unë jam i bindur, as politikisht dhe as materialisht, as financiarisht nuk i konvenon Kosovës në këtë kohë kur Kosova duhet të njihet nga vende tjera, të humb kohë në zgjedhjet e parakohshme, që s'ka arsye. Pse nuk ka arsye? Vetëm po të japim një shikim të qeverisë së kaluar, kur çdo ministër nuk ishte kompetent për ministrinë e vet, në këtë mandat, së paku kemi ministrat që në një formë janë edhe kompetent për ministrinë që i drejtojnë. Dhe, dallon shumë. Unë nuk dua të hyj, unë nuk dua t' i lëvdojë për punët se s'jam për ta lavdëruar punën e askujt, as timen. Por, po dua të them, veç po të shikohen emrat e tyre, profesioni i tyre, janë njerëz më kompetentë për t'i drejtuar ministrinë përkatëse. Ju e keni pasur ministrin e Drejtësisë, ka qenë profesor i kimisë.

(Ndërhyrje deputeti)

Atëherë, po na intereson neve. Prandaj, duhet ta dinë. Nuk mund t'i imponohet kurrë as këtij Kuvendi, as institucioneve, as qytetarëve të Kosovës. Dhe, një porosi për opozitën dhe jo vetëm për opozitën, por për të gjitha partitë politike. Le ta harrojnë partitë politike që të vijnë në qeverisje të vendit më 10, 5 e 7%. Ai që e fiton votën nga qytetarët e Kosovës, e merr mundësinë. Jemi mbajtur dhe kemi konfirmuar 4-5 herë që jemi më të fortë se ju. Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala vam, gospodine Krasniqi. Poslanik Gani Geci!

KRYETARI: Gani Geci e ka fjalën. Le të përgatitet Bahri Hyseni.

GANI GECI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Unë do t' i paraqes shqetësimet e mia rreth mbajtjes apo mosmbajtjes së zgjedhjeve. Nuk është për mua shumë shqetësues fakti se a do të mbahen zgjedhjet në vitin 2009 apo në vitin 2011, por është mjaft shqetësues fakti se ju keni filluar ta lexoni Kushtetutën mbrapsht nga neni 161 dhe kur dihet se ne kemi nenin 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku thotë se Kosova është shtet sovran dhe i pandashëm. Gjithashtu, nëse lexojmë nenin 88 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, thotë se Presidenti i vendit

nuk ka të drejtë të mbajë ndonjë post tjetër shtetëror ose partiak. Për mua gjithashtu është shqetësues fakti se Presidenti në zyrën e vet thërret njerëz dhe u premton, duke shkelur Kushtetutën, se do t'i bëjë çau shë, do t'i bëjë asllanë dhe kur të vdes ai ua lë amanet se mund të bëhen edhe mbretër, sepse edhe ai ka ardhur me amanete si President. Ky fakt nuk përshkon me nenin 83 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku thotë se Presidenti është kreu i shtetit që përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës dhe Zyra e Presidentit nuk guxon assesi të shfrytëzohet për thirrje individësh që t'i ftojë në partinë e tij. Unë do ta ftoja Presidentin që të japë dorëheqje nga Presidenti dhe me dëshirë do të prananim që ai të jetë kryetar i Lidhjes Demokratike dhe ne do të ishim të lumtur.

Gjithashtu, mua më shqetëson fakti se Zyra e Presidentit përgjohet dhe në të nesërmen mund të lexoni në gazeta ditore ato që i ka biseduar Presidenti me disa nga njerëzit apo me disa nga deputetët.

Unë po frikohem jashtëzakonisht se në Kosovë është duke u instaluar një ndjenjë e frikës, një frymë e frikës dhe jo më larg se dje tre studentë që bisedonin me mua dhe bisedonim për Qeverinë, njëri i tha shokut: “shuaj se po na ndien dikush”. Kjo ndjenjë e frikës, them sinqerisht, është një ndjenjë e tejkaluar, e tejkaluar e regjimeve diktatoriale dhe është shqetësuese. Prandaj, edhe ne të tjerët duhet të shqetësohemi për këto ndjenja të frikës. Mbahen apo nuk mbahen zgjedhjet, kjo është krejt e parëndësishme, sepse është e vërtetë që mua më shumë më intereson Kushtetuta se Pakoja e Ahtisarit, sepse për Pakon e Ahtisarit keni lëshuar shumë pe dhe Kushtetutën e kemi bërë së bashku, edhe pse nuk kemi pasur mundësi të votojmë për të, por i kemi pasur nga grupet tona parlamentare njerëzit aty. Prandaj, për mua është shumë më e rëndësishme Kushtetuta, po nëse është e rëndësishme Kushtetuta, zbatoheni nën për nën. Mos e zbatoni nënin e fundit, mos ia nisni mbrapsht.

Në zgjedhjet e kaluara, duhet të them se jam i gëzuar që tash nuk po mbahen në këtë vit zgjedhjet, sepse nuk mbahen, sepse ju i keni votat dhe votoni për të mos u mbajtur edhe nëse vjen deri te votimi. Po pse jam i gëzuar? Jam i gëzuar, sepse atje te ne e kanë pas mbushur një autobus dhe kanë pas votuar nja 12 vendvotime me një autobus- me të njëjtit njerëz. Jam i gëzuar sepse do t'ua cek një fakt. Në një vendvotim, një njeri vjen me tesha pune, voton dhe del. Kthehet pas gjysmë ore, vjen me trenerka, voton, del. Kthehet pas gjysmë ore, vjen me farmerka, me jakë, me kapelë, voton del dhe kthehet pas gjysmë ore, me kollare dhe me kat për të votuar. Dhe e zënë vëzhguesit. Dhe thotë, vidhni edhe ju, kush po ju ndal. Kjo është një fakt. Prandaj, po ju them, sinqerisht, unë kërkoj nga Qeveria, kërkoj nga OSBE-ja, kërkoj nga Presidenti që të ndjellin një frymë tolerance që zgjedhjet e ardhshme kurdo që të mbahen ato të jenë të pranueshme për të gjithë dhe ne të jemi ata që t'ia shtrimë njëri-tjetrit dorën për votat që i kanë mbërri. Por, jo t'i vjedhin votat, sepse kjo është e papranueshme, jo të ndalim dritat dhe në kutia të shtinë – të hyjnë vota me grusht. Këto janë të papranueshme. Të pranueshme janë kur Qeveria e Republikës së Kosovës instalon kamerat për t'i vëzhguar zgjedhjet, jo për ta vëzhguar Presidentin dhe ta dijë me kë po flet e çka po flet. E pranueshme është kur Qeveria e ndërron kursin, krijon klimë tjetër, të favorshme për qytetarët, sepse, kjo klimë që po ndjelljet dhe që po frymohet dhe që po krijohet, është një klimë akumuluese. Jam shumë i shqetësuar se një ditë mund të jetë shpërthyesë. Të gjitha këto marrëveshje që po bëhen me sindikata s'po zbatohen, janë akumuluese. Ekziston një rrezik shumë i madh që të jetë një ditë kjo klimë shpërthyesë dhe është në dëm të procesit dhe është në dëm të njohjeve të mëtutjeshme të pavarësisë së Kosovës. Andaj, edhe ne si deputetë, por edhe Presidenti, edhe Kryetari i Kuvendit, ju lutem ta zbatoni Kushtetutën e Republikës së Kosovës, t'i

zbatoni rregulloret që i kemi aprovuar këtu, sepse kështu veprohet në secilin shtet demokratik. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Gani! Veç ta kesh parasysh se je anëtar i Komisionit për Siguri. Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni, le të përgatitet Besa Gaxherri.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritet zoti zëvendëskryeministër, ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pas fjalës së Kryetarit të Kuvendit, nuk kemi shumë çka të themi, mirëpo ndoshta me qëllim të sqarimit e mora fjalën. Së pari duhet ta kemi të qartë, asnjë dokument e aq më pak Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nuk kishte mund të aprovohet në këtë Kuvend po të ishte në kundërshtim me Pakon e Presidentit të Ahtisarit. As Ligji për zgjedhjet nuk do të kalonte, nëse do të ishte në kundërshtim me planin e Presidentit Ahtisari. Neni 84 pikë 3, në të cilin po thirret opozita, unë mendoj që Presidenti i Republikës së Kosovës nuk e ka shfrytëzuar ende këtë të drejtë dhe nuk ka shpallur zgjedhje, prandaj, ta sqarojmë opinionin. Presidenti i Republikës së Kosovës nuk ka shpallur zgjedhje. Presidenti i Republikës së Kosovës as nuk e ka interpretuar Kushtetutën e Kosovës. E ka bërë një qartësim të mandatit që, për të gjithë ne që jemi prezentë, e tha mirë Kryetari i Kuvendit, është shumë i qartë. Mandati është shumë i qartë dhe njerëzit që po debatojnë këtu dhe po i dëgjon opinionin, nuk po e bëjnë dallimin ndërmjet datës së zgjedhjeve dhe mandatit. Janë plotësisht të kundërta. Po më vjen interesant, po thirren në ligj dhe nuk po e lexojnë ligjin. Shumë mirë dikush nga deputetët tha që data e shpalljes së zgjedhjeve duhet të bëhet në konsultim me partitë politike. Është shumë e vërtetë. Presidenti, në momentin e marrjes së vendimit për t' i shpallur zgjedhjet ka për t' u konsultuar për datën, ka për t' u konsultuar me të gjitha partitë politike. Po pse nuk po e lexojnë pak më poshtë, nenin 4.2 pasi po thirren në të njëjtin ligj, ku thotë mandati për zgjedhjet në Kuvendin e Kosovës është 4 vjet, qysh ka qenë. Prandaj mos ta bëjmë në mënyrë selektive.

Ata të cilët po thirren shumë në interesin e qytetarëve të Kosovës është mirë të bëjnë sqarime. Çka ka nevojë Kosova pas një viti të mbajë zgjedhje? Çka ka nevojë Kosova në këtë stabilitet të institucioneve që e ka, që ka shumë projekte, investime kapitale, të harxhojë shumë të holla pa nevojë? Pse këto të holla të mos shfrytëzohen për vende të reja të punës, të mos i shfrytëzojë për paga të policëve të Kosovës dhe për një stabilizim të mëtutjeshëm të institucioneve? Po thirren shumë edhe në Kushtetutë, që është shkelur, por nuk po e lexojnë, është mirë nganjëherë edhe ta lexojmë. Pse askush s'po e lexon nenin 148, pika 2 e Kushtetutës, që është shumë e qartë. Thotë: "Nëse ky mandat zgjat më pak se 2 vjet, nuk konsiderohet mandat". Dhe çka nëse ndodh ky Parlament që e ka shpallur shtetin e Kosovës në të ardhmen do të konsiderohet se s'ka qenë fare mandat zgjedhor? S'po e lexojnë, hiq dhe s'iu ka shkuar askujt ndërmend. Dëgjo! Ne e kuptojmë shumë qartë që opozita edhe t'i mbajmë zgjedhjet pas 5 muajve, pas 5 muajve tjerë nëse e ka të njëjtin fat ka për të kërkuar zgjedhje. Ajo është lojë. Në çdo moment për opozitën nuk bëhet vonë për të kërkuar zgjedhje pas një muaji, mirëpo është mirë që të mos dalim në opinion dhe të themi se Presidenti e ka shkelur Kushtetutën. Presidenti nuk e ka shkelur Kushtetutën. Ka vepruar në bazë të të drejtës që ia jep Kushtetuta dhe e ka përcaktuar nenin. Dhe dikush, po më vjen interesant, atëherë pse lejuat të bëhen ndryshimet e Kornizës Kushtetuese, për çka e lejuat të jetë mandati nga 3 në 4 vjet, një rregullore që e keni nxjerrë? Ju lutem, pse e keni lejuar? Dhe, çka ka pasur nevojë të ndryshohet prej 3 vjetëve në 4 vjet kur zgjedhjet ishin dashur të mbaheshin pas 9 muajve. Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha këto që u thanë, unë thashë i sqaroj shumë mirë

Kryetari i Kuvendit, por është mirë që edhe ligjet edhe Kushtetutën kur ta lexojmë, mos ta lexojmë vetëm mbrapsht se mbrapsht bash po e lexojmë.

Dhe, krejt në fund, një shaka, Gani, sa ishte brenda i paska parë krejt ato, po qysh ka pasur kohë Ganiu të rrijë, që zgjedhjet 2-3 minuta kanë qenë për një kandidat. E qysh ka mund t' i shohë krejt ato duke u veshur, domethënë ka qëndruar tërë ditën në vendvotim atje. Po s' e di, s' qenka këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Pa komente! Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri dhe pas saj, shkojmë me një pauzë. A jeni dakord?

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Realisht, vetë mënyra e debatit të këtij Kuvendi sot është shqetësues, sepse është i paragjykuar, që qoftë pretendimi i opozitës që ka bazë ligjore kushtetuese për t' u ankuar për vendimin që dikush e quan jo vendim, jo ashtu, jo kështu të Presidentit, qoftë vetë ju pozita, është e paragjykuar që Kuvendi do të vendosë në të mirën e mazhorancës, pa marrë parasysh a është shkelur Kushtetuta, a janë shkelur ligjet? Kjo është shqetësuese.

Unë mendoj se nuk duhet të diskutohet as nuk duhet të jetë problem të mbahen zgjedhjet për pushtet, sepse realisht të gjitha subjektet politike aderojnë ose veprojnë për të ardhur një ditë në pushtet. Kjo është krejt normale, por ne po diskutojmë, nuk po flasim për kushtetutën e shteteve me demokraci shekullore. Po bisedojmë për një shtet që ende s' e ka mbushur një vit pavarësi. Po diskutojmë për një shtet që po i vë bazat e demokracisë dhe është shumë fragjil. Po diskutojmë për një shtet që ka aprovuar një Kushtetutë më pak se një vit, s' ka ende një vit. Dhe, është krejt çështje specifike, nuk mund të flasim, të krahasojmë me kushtetutat tjera që përcaktojnë se vërtet mandati i zgjedhjeve është kaq, i Presidentit kaq, e tjera e tjera. Ne jemi rast unik. Kemi një kushtetutë të aprovuar në Kuvendin e Kosovës, Kuvend demokratik dhe shtet parlamentar, një kushtetutë pa debat. Një kushtetutë e cila, megjithatë, i ka bazat mbi një pako të ashtuquajtur Pakoja e Ahtisarit. Dhe, tashti jemi para një momenti që na duhet dhe fatkeqësisht nuk kemi ende Gjykatë Kushtetuese. Dhe, realisht ky koalicion qeveritar që nga marrja e mandatit deri sot, natyrisht se ka dhënë shembull ose na ka dhënë opozitës, na ka shtyrë në një formë të kërkojmë ndoshta edhe pa pasur bazë ligjore të mbahen zgjedhjet. Ka shumë arsye. Unë ju kuptoj juve se ju po ju duket krejt në rregull, por realiteti nuk është qysh ju po e prezantoni.

Kolegët e mi thanë shumë gjëra, por unë po dua ta fokusoj debatin këtu. A ka pasur të drejtë Kryetari të marrë vendim dhe a ka marrë vendim a s' ka marrë vendim? A duhet vërtet gjërat e tilla të merren me konsensus duke pasur parasysh hapat e parë të demokracisë që po i bëjmë si shtet, apo duhen të merren vendime të tilla qoftë nga, kushtimisht, Kryetari i Kuvendit, Kryetari i Qeverisë, Kryetari i Kosovës ashtu qysh iu konvenon për veten e tyre apo duhet të respektohet ky organ më i lartë i shtetit që vërtet për gjëra të tilla duhet të bisedohet ndoshta në vende ku ka vërtet bazë më të fortë të demokracisë. Këtu është problemi dhe këtu nuk duhet të pajtohemi asnjëri, jo pozitë e opozitë, asnjëri. Kësi shembuj kemi çdo ditë dhe këto janë të papranueshme. Në qoftë se, mirë tha kolegu im, Presidenti e merr dhe do ta respektojë me çdo kusht nenin 163, duhet të fillojë ta respektojë nga neni 1. Megjithatë, edhe pse vërtet kjo Kushtetutë është votuar pa debat, po jam shumë e sinqertë, në qoftë se do të kishim pasur debat, do të ishte debatuar shumë rreth këtij neni. Do ishte debatuar, natyrisht, dhe nuk e di a do të kishte kaluar apo s' kishte kaluar edhe nga vetë ju, sepse do të kishte pasur reagim nga qytetarët.

Por, ne e dimë qysh është votuar kjo kushtetutë dhe sot zgjedhim, përfaqësuesit e institucionit zgjedhin nenet të cilat u konvenojnë.

Nuk dua të them asgjë të re, por a ka pasur të drejtë a s'ka pasur të drejtë të marrë Presidenti këtë vendim që unë s'po di a është vendim a s'është, se nëse mendojmë edhe për atë që po flitet se para një kohe qenkan pajtuar subjektet politike për këto zgjedhje, unë pyes prapë a kanë pasur të drejtë farë grupesh kështu të marrin vendime kur t'i mbajnë zgjedhjet, sa ta kenë mandatin e qysh ta kenë mandatin? Këto janë gjëra të papranueshme. Çdo ditë ne kemi problem me çështjet, qoftë të sovranitetit, qoftë të korrupsionit, qoftë të problemeve të shumta dhe këto gjëra nuk janë asnjëherë transparente. Domethënë, kur vjen një moment, thotë, ne kemi biseduar, por në Kuvend as nuk shtrohet çështja e sigurisë, as e korrupsionit nuk diskutohet, as e transparencës, asnjë gjë. Këto janë të papranueshme. Dhe po e citoj, të nderuar kolegë, qoftë ky vendim, unë nuk po di qysh ta quaj dhe, fundi i fundit, nuk ka pasur të drejtë të marrë vendim dhe s'do të mund të marrë vendim. Përkundër asaj, unë pajtohem që vërtet kjo mazhorancë dhe ky koalicion mund të zgjatë deri në fund, qysh po mendoni ju, deri në vitin 2011, por të jeni të sigurt që nuk do të shkojë as deri në vitin 2011. Nuk do të shkojë dhe as Presidenti, as Kryeministri, as Kryetari i Kuvendit nuk do të mund të marrin vendime më kështu, pa marrë parasysh se mendoni që kjo opozitë është edhe numerikisht e vogël, normal, edhe e jashtëzakonshme prej 3 subjekteve e përbërë. Megjithatë, do të na shtyj dikush, deshëm ne a s'deshëm për ta respektuar Kushtetutën dhe ligjet që i aprovojmë ne. Andaj, përkundër asaj që ne kemi dëshirë ta respektojmë këtë Kushtetutë, në radhë të parë i pari i këtij vendi, kjo po shkelet. Po shkelet edhe me atë që në asnjë ligj, as në Kushtetutën tonë, nuk shkruan që Presidenti i shtetit "mund m'u ngri", a për ta ngrirë mandatin, qysh po thotë. Ka mbetur i ngrirë, as s'është President, as kryetar i partisë dhe nuk po dimë ne ku shkruan ajo, as qysh veprohet, megjithatë këto gjëra po ndodhin.

Kushtetuta, po ua lexoj nenin 143, veç pikën 3." Kushtetuta, ligjet dhe aktet tjera ligjore të Republikës së Kosovës interpretohen në pajtueshmëri me Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007". Kuptohet çka është kjo, domethënë është Pakoja e Ahtisarit. Në rast se ka papajtueshmëri si rasti konkret, midis dispozitave të kësaj Kushtetute, ligjeve dhe akteve tjera ligjore të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të marrëveshjes, kjo e fundit, ajo marrëveshja që po e përmendni ju, që nuk dimë ne ku i keni bërë, qysh i keni bërë, kjo e fundit do të mbizotërojë.

Ne, të nderuar kolegë deputetë, kemi aprovuar një kushtetutë, mbi të cilën është Pakoja e Ahtisarit. Që ku e ka nenin dhe që ku e ka pikën. Dhe, ju lutem shumë, përkundër nenit 160 e sa këtu, kur ka papajtueshmëri ne duhet të kthehemi në Pakon e Ahtisarit dhe për shumë çështje tjera shumë të dhembshme të cilat i kemi aprovuar. Andaj, ju lutem shumë, këtë me shumë të drejtë, jo si opozitë për të ardhur në pushtet se nuk po garantojmë, nuk po sigurojmë se ndoshta 100% vijmë në pushtet, por keni obligim, keni obligim të instalojmë demokracinë në këtë vend dhe kemi obligim të jemi të përgjegjshëm ndaj dokumenteve që i aprovojmë vetë e aq më shumë duke filluar nga i pari i vendit deri tek i fundit. Në anën tjetër, si opozitë a kemi të drejtë ose a është e nevojshme të kërkojmë zgjedhje? Shumë kemi të drejtë. Nuk po dua ta zgjas shumë. Veç, normalisht, kemi edhe nevojë. Ka nevojë vendi, nuk kam nevojë unë, se edhe unë jam si ju këtu deputet. Ju s'keni asgjë më shumë se unë. Deputetë jemi të gjithë, por ka nevojë Kosova për zgjedhje, sepse në Kosovë ende nuk jemi në gjendje ta mbrojmë një vit pas shpalljes integritetin e sovranitetin e këtij vendi. S'keni qenë në gjendje. Keni shumë probleme në këtë drejtim dhe s'e keni marrë asnjë hap në këtë drejtim. Në Kosovë po instalohet

korupsioni, që në krye atje po instalohet dhe s'ka kontroll. Në Kosovë nuk ka transparencë për asgjë...

KRYETARI: Për zgjedhje...

BESA GAXHERRI: Për zgjedhje, zoti Kryetar, po kërkoj t'i mbajmë, sepse këto gjëra jeni kah i bëni ju. Në Kosovë po rritet varfëria me të madhe, natyrisht po instalohet një kontroll shumë i madh mbi të gjitha institucionet e pavarura e në veçanti disa mediave. A është nevoja të mbajmë zgjedhje në Kosovë? Është imediate. Megjithatë, Kryetari pak më parë tha, ju s'po pajtoheni, herë po pajtoheni, herë s'po pajtoheni me Peter Feith. Ishte deklarata më e mira e duhur, porosi jo veç për ju, por për të gjithë ne. Për të gjithë neve. Ne duhet të ndryshojmë dhe për të ndryshuar duhet të dalim para qytetarëve të kërkojmë besimin e tyre, pastaj vërtet, sepse është situata specifike. Pakoja e Ahtisarit kërkon, pas shpalljes së pavarësisë 6 deri 9 muaj, duhet të mbahen zgjedhjet. Nuk jemi ne si shtetet as të regjionit as të Bashkësisë Evropiane. Jemi rast unik, specifik dhe ne kemi të drejtë, do t'i kërkojmë dhe do t'i mbajmë. Zgjedhjet do të mbahen para vitit 2011! Faleminderit!

KRYETARI: Shkojmë në pauzë. Zgjedhjet janë më 2009, por për pushtet lokal. Do të bëjmë një pauzë sa për kafe, që do të zgjasë 15 minuta.

#### Vazhdimi i seancës pas pauze

RRUSTEM MUSTAFA: I nderuari Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Sot në rend dite kemi një temë të harxhuar ende pa u diskutuar, edhe për media, edhe te qytetarët e Kosovës, lëre më edhe në Kuvendin e Kosovës. Sidomos pas fjalës së Kryetarit të Parlamentit, ku foli për argumentimin e itinerarit të mbajtjeve të zgjedhjeve, unë nuk do të merrem me ato argumente, sepse konsideroj që janë të mjaftueshme nga ata që u thanë deri tash. Unë jam i shqetësuar që ne dhe qytetarëve po ju ofrohen tema që janë krejt të panevojshme dhe ato janë zgjedhjet, sikur dosjet, shpërndarja e librezave e disa tema të cilat, në fakt, vetëm po i futen në rend dite shoqërisë qytetare të Kosovës edhe vetë ne këtu në Kuvend. Kam vërejtur me shqetësim se mediat apo grupet e interesit, që unë nuk po akuzoj as pozitën, as nga opozita, po ka media dhe grupe të interesit në vendin tonë që po qesin në rend dite tema që nuk i vyejnë vendit tonë, e aq më pakë institucioneve sikur këtu ku jemi ne. Është koha e fundit kur ne duhet të marrim rolin udhëheqës dhe temat mendoj që duhet t'i caktojmë vetë. Këto tema që tash po merren mediat edhe ne me to, kam përshtypjen se grupet e caktuara i bëjnë me qëllim që të largohen nga temat serioze për zhvillim të vendit. Unë po ndalem edhe në tema të cilat më interesojnë, sepse kryesoj Komisionin e Kuvendit për Siguri dhe Punë të Brendshme.

Tema e korupsionit dhe të krimit të organizuar janë tema me të cilat duhet të merren institucionet e vendit edhe ne deputetët. Krejt këto i them, duke pasur parasysh që këto tema krijojnë, prodhojnë pasiguri në vend. Për ditë mund ta dokumentojmë se këto tema krijojnë mallra që lëvizin në të zezën, si janë mësuar te na, apo fshehurazi dhe ato domosdo krijojnë grupe të interesit, të cilat më vonë do t'i kushtojnë vendit tonë dhe të krijojnë pasiguri.

Tema tjera që janë edhe objektivi i Qeverisë, që janë domosdoshme të diskutohen dhe të bëhet debat edhe në Kuvend, edhe te qytetarët e vendit, janë mirëqenia, punësimi, forca e sigurisë së vendit e shumë tema tjera. Këto sikur po ngulfaten nga temat krejt të

panevojshme që po na sillen, unë ndihem keq edhe në Kuvendin e Kosovës. Kërkesa ime kishte për të qenë që të tregohemi lider, ashtu si e kemi pozicionin, që temat për mirëqenie dhe punësim dhe për vazhdimin e funksionalizimit të gjithë mekanizmave të shtetit, të mos lejojmë të tjerët të na nxënë rendin e ditës me tema tjera që janë krejt të panevojshme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Zef Morina, le të përgatitet deputeti Mark Krasniqi.

ZEF MORINA: I nderuari Kryetar i Parlamentit,  
Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Sot po debatohet për një çështje që mendoj se Parlamenti nuk ka pasur nevojë fare të diskutojë duke pasur parasysh se Kushtetuta e Republikës së Kosovës qartë i ka përcaktuar detyrat e secilit prej nesh, edhe të Presidentit, edhe të Kryeministrit, edhe të deputetëve, por sido që të jetë, për hir të opinionit, për hir të qytetarëve dhe të anëtarëve të partive të cilave u përkasim, po diskutojmë edhe po e themi atë çka është e vërteta.

Mua më çudit fakti pse në kërkesën e opozitës shkruan - vendimi i Presidentit për shtyrjen e zgjedhjeve. Vërtet, kjo është e palogjikshme. Presidenti nuk i shtyrë zgjedhjet, por Presidenti ka kërkuar për shkak të kërkesave ende pa u bërë një vit të mbajtjes së zgjedhjeve, kërkesa e disa deputetëve dhe e partive politike ka qenë që të mbahen zgjedhjet sa më shpejt. Tash, natyrisht, është dashur ta dimë a janë zgjedhje të rregullta, apo zgjedhje të parakohshme, apo zgjedhje të cilat i përcakton edhe Kushtetuta. Natyrisht, Presidenti ka deklaruar që zgjedhjet me Kushtetutë duhet të mbahen në vitin 2011, gjë që është shumë e drejtë. Ka të drejtë që opozita të kërkojë mbajtjen e zgjedhjeve, kjo është shumë e vërtetë, ka të drejtë ndoshta edhe në momentin kur e pranon që i ka humbur zgjedhjet, menjëherë kishte për të pasur dëshirë që pas 6 muajve të ketë zgjedhje tjera. Kjo është e drejtë natyrisht morale, por jo edhe e drejtë për interesa të qytetarëve.

Nëse flasim për Planin e Ahtisarit, duhet të jemi shumë korrektë, për hir të opinionit, për hir të qytetarëve dhe për hir të anëtarëve të subjekteve që i përkasim duhet ta interpretojmë drejtë.

Fillimi i negociatave dhe përzgjedhjen e statusit të Kosovës, nëse nuk gabo, ka qenë në nëntor të vitit 2005 dhe ka qenë me mandat të përfundojë në dhjetor 2006. Ashtu kanë qenë bisedat dhe pas përfundimit të bisedave, në mars të vitit 2007 është dashur që Presidenti Ahtisari të paraqesë Plan propozimin, natyrisht të miratuar edhe nga ky Kuvend, edhe nga Grupi i Unitetit, dhe është menduar që në mars të vitit 2007 ka të drejtë ose do të mund Kosova ta shpall pavarësinë pasi të debatohet ose të pranohet në Këshillin e Sigurimit pakoja e Ahtisarit. Kjo nuk ndodhi, sepse propozimi i Ahtisarit nuk hyri hiq në rend të ditës në OKB, këtë e dimë të gjithë arsyen pse. Për shkak të pengesave që u paraqitën në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Duke pasur parasysh këtë dhe duke pasur parasysh që me Kornizë Kushtetuese zgjedhjet është dashur të mbahen në nëntor të vitit 2007, atëherë Presidenti Ahtisari ka kërkuar që pas shpalljes së pavarësisë, gjithnjë duke menduar që në mars do të shpallet pavarësia, të mos mbahen në vjeshtë por të kalojnë së paku 9 muaj ditë. Kjo nuk ndodhi. Të gjithë menduam që pavarësia do të shpallet në qershor, për dy arsye:

Në një, menduam se Rusia do ta ndërrojë qëndrimin dhe do ta pranojë, së paku do të heshtë, dhe ishte ftesa, ardhja e Presidentit Bush në Shqipëri dhe gjithë mendonim dhe kemi...

**KRYETARI:** Debati është i lirë!

**ZEF MORINA:** ... kemi pasur shpresë që pas një deklarate të Presidentit, natyrisht, ne në qershor mund ta shpallim pavarësinë, gjë që vendimi ishte do me thanë i njëjtë, që nëse shpallet në qershor, zgjedhjet të mos mbahen në vjeshtë, por të kalojnë 9 muaj ditë. Edhe kjo nuk ndodhi edhe përkundër vetë Presidentit Bush në Tiranë, kur tha që Kosova do të jetë e pavarur. Çka mbeti pastaj? Në takimin që është mbajtur të shteteve G8, apo si quhej, është vendosur që pas 120 ditësh të merret një vendim. Ky ishte propozimi i Presidentit Francez, kështu ndodhi, asgjë nuk u bë dhe, natyrisht, Kosova pati nevojë të mbajë zgjedhjet dhe të mos mbesim në një farë mënyre pa zgjedhje legale, sepse do të skadonte mandati i Parlamentit, që kemi qenë një numër i madh i këtyre që jemi sot, edhe në atë kohë. Zgjedhjet u mbajtën me pëlqimin e partive politike, me pëlqimin e PSSP-së dhe, natyrisht, fituan ata që i fituan dhe ne duhet të jemi, thjeshtë, krenarë që zgjedhjet ishin shumë ferrë, kaluan mjaftë mirë dhe u konsistuan Qeveria të gjitha institucionet.

Unë mendoj që nëse kthehemi tek interpretimi i kushtetutës, unë nuk jam ekspert i kushtetutës, por duhet ta lexojë secili prej nesh që di. Kishte për të qenë mirë që secili nen të analizohet, një nga një, mos të merret një pjesë nga njëri nen, një pjesë nga tjetri dhe të interpretohet tek qytetarët gjëja që Parlamenti, Presidenti dhe institucionet kanë interes vetëm që të jenë vetë në pozita ku janë. Jam shumë i sigurt që një numër i madh i deputetëve këtu, po ta pyesnin jashtë ndikime politike, kishte për të thënë jo, mos të mbahen edhe tri vjet, por edhe 5 vjet të rrijë këtu në këtë parlamentet, se ndoshta nuk do të jenë në mandatin tjetër. Edhe veten po e shti aty, natyrisht, por po flas, një numër i madh, a! Kështu që mendoj se është shumë më e drejtë që ne t'i japim mundësi Qeverisë, Parlamentit, institucioneve që të kryejnë detyrën e vetë, natyrisht, duke u mbështetur në të drejtën që jep Kushtetuta dhe ligjet që i kemi miratuar vetë. Mos ta pengojnë as Qeverinë, as vetveten këtu në Parlament, për të dalë para anëtarëve tonë ose qytetarëve që ne do të jemi shumë ma të fortë, po s'po na lënë të bëhemi, gjë që s'është ashtu.

Unë mendoj që kjo Qeveri është duke kryer punën mirë, Parlamenti mund të punojë edhe më mirë, është duke punuar mirë, aq më tepër Presidenti është duke kryer detyrën e vetë sipas Kushtetutës, pavarësisht që dikujt ndoshta nuk i pëlqen.

Nuk është e vërtetë që Presidenti e ka caktuar datën e zgjedhjeve. Presidenti veç e ka thënë një, e ka shpreh, do me thënë, një të drejtë kushtetuese që zgjedhjet e përgjithshme do të mbahen në vitin 2011. Dhashë zoti që të shkojë ashtu, mos të kemi zgjedhje të parakohshme, që ndoshta dikush i dëshiron. Dihet për çka vinë zgjedhjet e parakohshme. Ne kemi premtime nga institucionet ndërkombëtare të thithim për tri vjet 1.2 miliardë euro. Nëse ne mbajmë zgjedhje çdo vit, ato nuk do t'i shohim, e ne atëherë nuk kemi nevojë të bërtasim që të kemi një ekonomi më të mirë, një zhvillim më të mirë, por thjeshtë të bërtasim që kush duhet të jetë i pari, kush do të vijë në Parlament, kush duhet të jetë në Qeveri. Ju lutem, interesi ynë është që para faktorit ndërkombëtar dhe qytetarëve tanë të jemi të përgjegjshëm dhe të punojmë për interesat të qytetarëve, jo për interesa të ardhjes së dikujt apo të kalimit të dikujt prej një pushteti në një pushtet tjetër.

Ne, demokristianët, e mbështesim vendimin e Presidentit, e mbështesim punën e Qeverisë, e mbështesim punën e Parlamentit dhe kërkojmë që të gjithë së bashku të

punojmë që Kosova sa më shpejt të jetë anëtare e OKB-së, të njihet prej të gjitha shteteve dhe bashkërisht të punojmë për integrimin në Bashkimin Evropian, sepse moto edhe e partisë është integrimi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Nuk ka vendim, kështu që nuk ka nevojë të mbështesim atë që s'është. Fjalën e ka deputeti Mark Krasniqi, le të përgatitet deputeti Driton Tali.

MARK KRASNIQI: I nderuar Kryetar,  
Të nderuar deputetë,

Unë do të flas diçka në përgjithësi, ndoshta, por edhe në atë përgjithësi jemi edhe ne. Dihet se çdo parti synon dhe vepron që të marrë pushtetin dhe të qëndrojë sa më gjatë në atë pushtet. Mirëpo, kjo, të themi luftë për pushtet, duhet të jetë demokratike, e ndershme, pa presion, pa vjedhje, pa blerje votash, kështu që fituesi i votave të ketë përkrahjen e vërtetë të elektoratit.

Qeveria, institucionet qeveritare duhet të veprojnë, para së gjithash dhe mbi të gjitha, për interesin shtetëror, përkatësisht për interesin e të gjithë qytetarëve. Mirëpo, praktika ka treguar se qeveri përkatëse, të them në përgjithësi, shfrytëzojnë pozitën para së gjithash për interesin e partisë të cilës i takojnë. Kjo praktikë është shumë e dëmshme sepse shteti nuk është i asnjë partie, shteti është i shtetasve, i gjithë qytetarëve, pa marrë parasysh strukturën e tyre.

Politizimi i Qeverisë në relacionin me partinë të cilës i takon, mund të ketë pasoja të instalimit të sistemit monist ose të sistemit një partiak, që për ne do të jetë shumë e dëmshme. Prandaj, kur të vërehen intencat e dëmshme të tilla, kuptohet se interesi i shtetit është që të mendohet dhe të veprohet për zgjedhje të reja. Kjo nuk duhet të kuptohet si një tragjedi për asnjë qeveri, sidomos në kushtet tona specifike, kur duhet të bëjmë çdo gjë që të jetë e mundshme për konsolidimin e Republikës së Kosovës, para së gjithash për sovranitetin e saj, i cili është në pyetje. Në këtë drejtim të interesit të shtetit duhet të koncentrohemi të gjithë me forcat tona politike dhe intelektuale, sepse kështu na imponon momenti momental i Kosovës.

Sukseset e Qeverisë në disa sektorë në fushën materiale janë suksese të popullit, të taksapaguesve, me të holla të cilëve ndërtohen shkollat, ambulancat, rrugët e të tjera. Me një fond të pasur, partia edhe më e vogël mund t'i ketë këto suksese, sepse punën konkrete e kryejnë, do me thënë, ndërmarrjet përkatëse që janë specializuara për atë punë. Prandaj, është gjë normale që t'i mundësohet popullit të zgjedhë në vazhdimësi qeverinë sa më të mirë, sa më të ndershme të pa komprometuar, pa familjarizim, pa participim e të tjera, ta kemi një qeveri që punon vetëm për interesin e Republikës së Kosovës. Duhet kjo Qeveri mos ta ketë asnjë ministër të korruptuar, që s'kemi pasur, sidomos me tenderë është bërë një vjedhje jashtëzakonisht e madhe. Duhet të jetë gjithmonë një kontroll për çdo tenderë, atëherë do të shihet se kush është i ndershëm e kush meriton të jetë në atë vend, të cilin e ka marrë, nuk dihet se si.

A e ka Kosova Qeverinë e këtillë aktualisht, kjo do të shihet edhe nga diskutimi i sotshëm për këtë Qeveri. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë, deputet Krasniqi!

Kisha lutur vërtet ta respektoni kohën si deputeti më i vjetër, Mark Krasniqi, që nuk i kaloi as 5 minuta. Mendoj që për 5 minuta e thotë njeriu atë që e ka për ta thënë. Driton, nëse më lejon, 1 minutë e ka kërkuar Lutfi Haziri, fjalën e pastaj e vazhdon ti. Lutfi, unë ta dhashë fjalën.

**LUTFI HAZIRI:** Faleminderit shumë, zoti Kryetar!

Meqë zoti Makolli nuk është këtu, e ka përmend, dëshiroj të sqaroj. Ajo që unë e quajta harta zgjedhore, ka të bëjë me mandatin që janë definuar tash. Pushteti Lokal, në këtë vit, ju e konfirmuat gjatë fjalës tuaj në nëntor, Pushteti Qendror në vitin 2011, në nëntor prapë, dhe për president është janari i vitit 2012. Sa u përket dy çështjeve që i përmendi Ardiani dhe Lulzim Zeneli më vonë, marrëveshje të mandateve apo marrëveshje për zgjedhje sido që e kanë cilësuar, unë dëshiroj të sqaroj edhe një herë, sepse kam qenë edhe në Pokantiko pjesë e angazhimeve tona për të përgatitur legjislacionin dhe zgjedhjet ka qenë koncentrimi që pas statusit, 17 nëntori, si zgjedhje nuk kanë pasur të bëjnë me Pakon e Ahtisarit, sepse Pakoja e Ahtisarit ka hyrë në fuqi pas deklaratës kushtetuese apo me deklaratën kushtetuese, kështu që mandati dhe interpretimi për mandate është diçka tjetër sa i përket...

**KRYETARI:** Ardian, një minutë! Mos përmendni emra!

**ARDIAN GJINI:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Mua më vjen mirë që zoti Haziri e tha këtë që e tha. Me qenë se mu përmend emri, e kërkoja replikën vetëm që ta nënvizoj edhe njëherë. U tha shumë shpesh, nuk guxojmë na t'i themi njëri-tjetrit tani këtu se zgjedhjet e 17 nëntorit të vitit 2007 janë mbajtur në bazë të Kushtetutës dhe në bazë të Planit të Ahtisarit. Ne të gjithë e dimë që nuk janë mbajtur, gjithë e dimë që ato zgjedhje kanë qenë emergjente për shkak se kanë qenë në skadim të mandatit të shtuar për një vjet të zgjedhjeve komunale dhe se është dashur që të blihet kohë se nuk është shpallur pavarësia as në qershor, as në vjeshtë të vitit 2007, qysh kanë pritur qytetarët e Kosovës. Kjo ka qenë arsyeja pse ka ndodhur ndryshe. Dhe, tani, nëse ato zgjedhje nuk do të ishin mbajtur, kush e di se ku do të kishim qenë sot dhe, tjetra është se nëse dikush pretendon se ato zgjedhje janë mbajtur në bazë të Planit të Ahtisarit, atëherë duhet të na tregohet ne, le t'i nxjerr dokumentet kush i ka dekretuar zgjedhjet, kush i ka shpall zgjedhjet, në bazë të cilës rregullore janë shpallur zgjedhjet. Nëse këto dalin në shesh, atëherë gjithkush do ta dijë se në Kosovë...

**KRYETARI:** Faleminderit!

Urdhëro Lulzim, po nuk është mirë ata që kanë qenë në proces dhe e dinë, ju lutem, ata që kanë qenë në proces dhe e dinë si kanë ardhur zgjedhjet, nuk është mirë vërtetë të mashtrohet askush, as veten. Po ua përkujtoj një fjalë. Sami Frashri, thotë: "Mes njerëzve të ndershëm, fjala është vendim". Urdhëro!

**LULZIM ZENELI:** Faleminderit!

Unë, prapë duhet të sqarohem. Në diskutimin sa i përket burimit të mandatit, ne duhet ta kuptojmë se mandati ekzistues buron prej një kornize, e cila është e tejkaluar. Mandati i institucioneve në Republikën e pavarur të Kosovës duhet ta ketë mbështetjen nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Aktualisht, ky Kuvend dhe institucionet e vendit kanë mandat që buron nga Korniza Kushtetuese. Ky është edhe një argument edhe më shumë pse duhet të mbahen zgjedhjet. Ndërsa, pjesa tjetër që ka të bëjë me dokumentet apo marrëveshjet në fjalë, unë vetëm po e ripërsërisë, gjithçka ka nuk e merr formatin legal, që ka mbështetje në Kushtetutë dhe në ligje, janë pjesë e një tregimi që mund të bisedohet, por nuk imponon dhe nuk obligon asgjë. Faleminderit!

KRYETARI: Lexoje nenin 161 dhe e sheh atë! Dirton, e ke fjalën!

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar të pranishëm,

Unë do të deklarojem në pika të shkurta pse jam që të mbahen zgjedhjet. Arsyeja kryesore është se në vitin e parë ministrave qeveritarë, nuk po them veç të kësaj Qeverie, por edhe të qeverive të tjera, po ju shkon derisa po i fusin njerëzit besnik të tyre në postet e caktuara të rëndësishme dhe viti i fundit po ju shkon duke u angazhuar për zgjedhje, për fushatë, prandaj atëherë po ka më shumë efikasitet, po ka më shumë punë.

Të gjitha korrupsionet, keq menaxhimet po ndodhin brenda këtyre dy pikave, andaj unë jam që ato vite në mes të vitit të parë, domethënë të konsolidimit të Qeverisë, derisa po them edhe një herë, ministrat po i fusin “akronat” e vetë në vendet e rëndësishme të qeverisë, u mor vesh, për nevoja të atyre, interesat e tyre dhe viti i fundit kur po ka më shumë punë.

KRYETARI: Jemi duke folur për zgjedhje, ju lutem!

DRITON TALI: Po ashtu, nuk dua që zgjedhjet edhe më tej të përdoren si xhoker sa herë që të rritet pakënaqësia e qytetarëve, të përdoren zgjedhjet për t'i shuar ato pakënaqësi, për t'i mashtruar qytetarët. Reflektimi i kësaj taktike po shihet, sa herë e më pak po na dalin qytetarët në zgjedhje. Herën e fundit, siç e dini, zyrtarisht kanë qenë 40.1%, kurse jo zyrtarisht deri 38% shkon statistika e qytetarëve që kanë dalë në zgjedhje dhe kjo tregon se kjo formë e organizimit të zgjedhjeve nuk është produktive.

Mua më vjen keq, po këtu i kam sjellë disa gazeta, copa të gazetave dhe datojnë në muajin qershor, korrik, pak edhe fillimi i gushtit të vitit 2007. Siç e dini, unë nuk kam qenë pjesë e marrëveshjes, nuk kam qenë fare në politikë, por si qytetar i Kosovës arsyet pse janë mbajtur zgjedhjet, atë që e tha zoti Gjini, të paktën ashtu na i keni reflektuar në media. Unë po i citoj, po them, udhëheqësit e PDK-së se çka patën deklaruar më 5 korrik të vitit 2007. “Nuk ka kurrfarë nevoje për zgjedhje të jashtëzakonshme, vetëm duhet respektuar afatin e rregullt, sepse nuk ka kurrfarë arsye për shtyrje të zgjedhjeve”. Institucioneve lokale, siç dihet, vjet, pra në tetor të vitit 2006, ju ka kaluar afati por, siç dihet, PSSP zoti Petersen ua pati shtyrë afatin, kurse institucioneve qendrore afati ju kalon me këtë tetor, më 22 tetor të vitit 2007. Andaj këto institucione, pra ato të vitit 2004 – 2007, nuk do të kenë legjitimitetin dhe nuk do të jenë legale për të udhëhequr me procesin e statusit përfundimtar të Kosovës. Institucionet duhet të legjitimitohen, andaj duhet mbajtur zgjedhjet e rregullta parlamentare, sepse legjitimiteti dhe legaliteti buron nga zgjedhjet.

Nuk duhet harruar se Kosova ende nuk ka sistem të ndërtuar zgjedhor, nuk ka ligj për zgjedhjet e tjera, e tjera, domethënë duke iu referuar kornizës kushtetuese ekzistuese. Siç e dimë, ajo ka ndryshuar.

Po e citoj zëvendësin e PDK-së, më 23 korrik, e dimë në atë kohë kush ka qenë. “PDK konsideron se procesi i statusit duhet ndarë nga zgjedhjet. Në fakt, ne besojmë që pa legjitimitet dhe pa mandat nga qytetarët, Ekipi i Unitetit është i pafuqishëm dhe i pa autorizuar për të udhëhequr procesin, aq më tepër kur qytetarët ballafaqohen me një keq qeverisje ekstreme. Pavarësia nuk është qëllimi i fundit i yni. Ne duam që Kosova e pavarur të jetë pjesë e familjes evropiane dhe është e qartë që me këtë lloj qeverisje rruga

e Kosovës drejtë integrimi është shumë e vështirë, por mos të them e pamundur”. Pra, arsyet kanë qenë legjitime duke u bazuar në kornizën ekzistuese kushtetuese, e cila më nuk është valide. Nuk është e vërtetë se janë mbajtur ato sipas marrëveshjes së Ahtisarit, andaj edhe unë nuk po e marrë nëpër gojë fare atë. Siç dihet, Kushtetuta e re e cila e rregullon mandatin e institucioneve të ndryshme, ka hyrë në fuqi pas organizimit të zgjedhjeve. Këto vlejnjë, do me thënë, këto institucione vlejnjë vetëm se pas zgjedhjeve të ardhshme, e jo të zgjedhjeve të cilat janë mbajtur në bazë të kornizës kushtetuese.

Unë po them edhe një herë, nuk po futem në atë se Presidenti a e ka sqaruar, a ka marrë vendim apo interpretim, por ajo tregon edhe një herë se sa i pavlefshëm është ky Kuvend. Në të gjitha debatet serioze për qytetarin e Kosovës, ky Parlament anashkalohet, së pari përgatitet terreni me ndihmën e mediave të afërta me pushtetin, pastaj ne dalim para aktit të kryer këtu dhe flasim kot. Unë pajtohem se ky debat i sodit është debat i kotë.

Unë, edhe një arsye tjetër po them, tash mos t’i citoj të gjithë liderët e partive politike, por njëri nga liderët politik, po them, e kam këtu deklaratën e tij, është e 18 ngushtit, ai ka qenë kundër zgjedhjeve, titulli është - Prioritet shtetit e jo zgjedhjeve. Siç e dini, disa liderë ish kundër zgjedhjeve të nëntorit të vitit 2007, për shkak se na jepnin datat e pavarësisë, jo më 28 nëntor, jo me krishtlindjet, e tjera, e tjera. Andaj, zgjedhjet, ta kemi të qartë, zgjedhjet e nëntorit unë nuk i di, po them edhe në marrëveshjet të cilat kanë qenë në mes të përfaqësuesve të partive politike të atëhershme parlamentare, por ato kanë qenë bazë e legjitimitetit, i cili ka rrjedhë nga korniza kushtetuese, e cila më nuk ekziston. Është ndërruar kushtetuta, andaj duhet mbajtur zgjedhjet, po them në kuptim legal, kurse në aspektin pse unë dua të ketë zgjedhje më të shpeshta në Kosovë, është për shkak të rritjes së efikasitetit. Ne e dimë që zgjedhjet na kushtojnë diku 8 milionë, por që po na keq menaxhohen brenda atyre 2 viteve, po them, vitit të parë dhe vitit të fundit, me dhjetëra miliona euro, kështu që në interes të Kosovës është që të kemi sa më shpesh zgjedhje, e mos të them pastaj edhe ajo zbavitja të cilën po ua japim qytetarëve gjatë fushatës duke iu dhanë atje premtime qesharake e tjera, e tjera. Faleminderit!

**KRYETARI:** Përsëri kisha një kërkesë, vërtet mos ta zgjasim diskutimin më shumë se 5 minuta, se edhe ashtu s’po kemi çka të themi. Fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi, le të përgatitet Naim Maloku.

**AHMET ISUFI:** I nderuar Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ne tash kemi themeluar një shtet të ri dhe ky shtet i ri do vizion të ri, do njerëz të përkushtuar që respektojnë të gjitha aktet e këtij shteti. Nuk kam nevojë të mbroj ose të akuzoj, por kam nevojë të tregoj që ka ndryshuar një sistem kushtetues dhe shoqëror në Kosovë. Në rastet e tilla, veprimet shkojnë në bazë të parimeve dhe në bazë të akteve ligjore, kushtetuese dhe bëhet rregullimi i ri me këto dokumente. Ne edhe si Parlament, edhe si Qeveri, edhe Presidenti, jem produkt i një akti që nuk ekziston më. Korniza kushtetuese nuk ekziston, tani kemi kushtetutë, prandaj kërkohet mbajtja e zgjedhjeve. Kemi një ndryshim edhe të rendit shoqëror, kemi pasur një administrim që e ka pasur fjalën kryesore në Kosovë, kemi një qeverisje të vendit që ka marrë fuqi shumë më të madhe për ta udhëhequr vendin dhe për atë duhet qeveria që del, del nga Kushtetuta e Kosovës nëse duam të kemi respektim të këtij akti.

Po thirrmi në dokumente, në marrëveshje. Ekzistojnë vetëm ato të shkruara dhe ato të cilat në fakt i dimë të gjithë që janë. Shpiken këtu edhe marrëveshje inekzistente, që askush nuk është në gjendje ta qesë në tavolinë e të thotë, që ku e keni. Pse? Pse bëhet

kjo edhe nga njerëzit që madje sot udhëheqin vendin. Nuk ka kuptim! Ne e përmendëm Pakon e Ahtisarit, të cilën duhet zbatuar në tërësi. Nuk është fontanë dëshirash që për dikë të vlejë pakoja e Ahtisarit, se po duhet plotësuar do kushte, e për këtë që është në opozitë ose në pozitë ose në cilëndo..., nuk po bëka të zbatohet. Pse? Pakoja e Ahtisarit duhet të zbatohet në tërësi dhe këtë duhet ta kuptojmë të gjithë, nëse thirrëmi në te.

Marrëveshja e Pokantikos që është bërë nga liderët e Ekipit të Unitetit, është bërë nga ata që, në fakt, kanë përfaqësuar deri në momentin kur Kosova është shpallur shtet i pavarur, janë njerëzit që kanë kontribuar dhe i kanë qitë nënshkrimet e tyre. Ne po flasim për akte të nënshkruara dhe s'po ju flasim asgjë tjetër. Në njëërën thuhet 6 deri 9 muaj, në tjetërën thuhet 6 muaj dhe po flasim me afate, pas pavarësismit të vendit.

Pse Presidenti interpreton Kushtetutën, pse zvarritet, Gjykata Kushtetuese nuk formohet që pikërisht Gjykata Kushtetuese ta luaj rolin e vet, po Presidenti e merr atë rol dhe këtu pastaj ka dilema. A ka marrë vendim, se vendim nuk paska drejtë të marrë, a po e interpreton a çka është kah bën. Presidenti e ka rolin e vet dhe duhet Kushtetutën ta respektojë nga pika e 1 deri 160 e sa përfundon. Ky është obligim i secilit prej nesh, madje më së shumti nga ai që është në krye të shtetit. Kemi problem, jo që të mbahen zgjedhjet parlamentare, se po shihet që s'ka vullnet fare, po as lokalet bile. Ku është KQZ-ja? Sot është e bllokuar dhe në kohën kur duhet të merret vendimi për shpalljen e zgjedhjeve lokale dhe, në fakt, është dashur të merret tash veç, ne e kemi të bllokuar. Për çka? Për interesa të cilat ekzistojnë brenda koalicionit, që nuk do, në fund të fundit, të merret me atë punë, do të neglizhojë, do edhe t'i shtyjë ndoshta.

Po ashtu, Gjykata Kushtetuese, pse nuk formohet më shpejtë, që ne të kemi mundësi që të ecim përpara. Shumë institucione të tjera janë vonuar, ju e dini, me paragjykime të ndryshme, të cilat nuk është dashur të ndodhin. Dhe, po ju them diçka, nuk është vetëm e neve, do të vinë edhe parlamente të tjera e deputetë tjerë pas nesh. Nëse e marrin këtë praktikë që po e ofrojmë ne, atëherë çka po ju lëmë të tjerëve pas veti. Po ju lëmë të neglizhojnë gjithçka, të shkelin aktet normative kryesore të vendit, t'i realizojmë qëllimet tona kur të duam ne, kur na garanton Pakoja e Ahtisarit ose Kushtetuta, kur na leverdis, po atje ku na nuk na konvenon, bën edhe ta lëmë. Nuk mund ta respektojë qytetari i Kosovës Kushtetutën, nëse institucioni më i lartë i vendit nuk e respekton. Prandaj, ne nuk po thirrmi as në individ, as në një grup, se s'është interesant, po është interesant që parimi të vlejë për të gjithë njësojë, sepse shteti bazohet mbi norma dhe funksionon si i tillë, shteti bazohet mbi të drejtën e realizimit të qytetarit për votën, për zgjedhje. Dhe, ju lutem, mos i neglizhoni këto, se po instalojmë një praktikë të cilën do ta bartin të tjerët pa fajin e tyre. Kemi obligim të respektojmë aktet më të larta të vendit dhe, po ju them, Kushtetuta është tani në fuqi, me Kushtetutë duhet t'i mbajmë zgjedhjet për të pasur institucione të cilat e respektojnë Kushtetutën. Këto institucione që janë të Kornizës kushtetuese nuk kanë për ta respektuar, qysh nuk janë kah e respektojnë as tash. Faleminderit!

KRYESUESI DŽEZAIR MURATI: Hvala vam, kolega Isufi!

Reč ima poslanik gospodin Naim Maljoku, neka se pripremi poslanica Kaqusha Jashari.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Pas krejt kësaj që u tha në këtë debat, më lejoni që t'i kundërshtoj të gjithë ata që akuzojnë opozitën që bën zhurmë. Kjo nuk është zhurmë, ky është debat, i cili i ka kaluar të gjitha procedurat me Rregullore të Kuvendit të Kosovës dhe është thirr në

lidhje me një çështje të rëndësishme, jo vetëm për këtë Kuvend, por edhe për Kosovën në tërësi.

Gjatë këtij debati, të mos i përsëris parafolësit e mi, u vërtetuan disa gjëra. Nën një, që marrëveshje aq shumë të përfolur nga mediat, që janë pro pozitare, nuk ka pasur për mandatet e këtij Kuvendi dhe për mandatet e Qeverisë dhe të Presidentit.

Tjetër, që janë shkelë Kushtetuta e Kosovës, Ligji për zgjedhjet, Kushtetuta, neni 83, që përkufizon statusin e Presidentit, citoj: “Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës”.

Vendimin që e ka marrë Presidenti, bie ndesh me këtë nen për shkak se nuk ka pasur dialog intern, dialog institucional në mes të pozitës, opozitës dhe partive tjera dhe shoqërisë civile në Kosovë për t’u marrë ky vendim.

Është shkelur Ligji për zgjedhjet, u tha, dhe janë shkelur parimet demokratike të funksionimit të shtetit demokratik, që po mundohemi ta ndërtojmë dhe kemi plotë gojën demokraci. Ky është mesazh i keq për Kosovën, ky është mesazh dhe shenjë e keqe për imazhin e Kosovës.

Unë ftoj Presidentin, pozitën, Kryeministrin, Qeverinë që ta kthejnë dialogun aq shumë të rëndësishëm për çështjet madhore që janë për Kosovën dhe për vendin tonë dhe për ndërtimin e shtetit demokratik dhe për funksionimin demokratik të tij. Kjo, pra, është shkelje e parimeve demokratike në një shtet që pretendon të jetë demokratik.

Të nderuar të pranishëm,

Të thirrmi këtu në fjalët e shkrimtarëve të mëdhenj, që fjala është për marrëveshje ose vendim në demokraci dhe në ndërtimin e shtetit, këtu kërkohen marrëveshje që praktikisht të nënshkruara nuk pati.

Opozita e atëhershme, opozita e tashme e ka pasur në mandatin e kaluar plotë gojën para politikë, marrëveshje në kafe, ndërrime të ministrave nga kafeneja e tjera, e tjera. Mendoj që ajo praktikë që vet e ka kundërshtuar dhe që nuk ka ekzistuar atëherë, por të gjitha janë bërë në institucionet e Kosovës, nuk duhet tani ta instalojë gjatë mandatit qeverisës që e ka.

Zgjedhjet janë të nevojshme për t’u legjitimuar pushteti në bazë të Kushtetutës së Kosovës. Zgjedhjet janë të nevojshme për shkak të keq qeverisjes në Kosovë që po e bën kjo Qeveri dhe zgjedhjet janë të nevojshme për të ndërtuar shtetin e pavarur të Kosovës, duke u bazuar në Kushtetutën e Kosovës dhe për t’u shkri mandatet e ngrira ose postet e ngrira, por të ketë mandate dhe poste në bazë të Kushtetutës, të cilën e kemi miratuar në Kuvend.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala vam poslaniče Maljoku. Dakle, imate reč poslaice Kaqusha Jashari, neka se pripremi profesor Riza Smaka.

KAQUSHA JASHARI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë, se këtu Qeverinë nuk e kemi. Jemi duke folur këtu vet. Kishte qenë mirë prej fillimit të ishte edhe kryetari këtu, por ndoshta edhe po e përcjellë.

Të gjitha partitë politike janë të interesuara të marrin pjesë në diskutim për tërë procesin..., jo vetëm për mbajtjes, duke filluar prej hartimit të ligjit, pjesëmarrjen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për monitorimin e tyre, për vëzhgimin, sidomos. Me një fjalë, të gjithë me siguri kanë dëshirë, të gjitha partitë të kenë ndikim në këtë proces, mos të humbim pozitën të cilin e kanë ose të krijohet pozita më e volitshme për partitë tjera. Edhe kjo kurrë nuk është e re, gjithkund po veprohet kështu. Kjo është edhe e drejtë e të gjithë spektrit politik dhe për këtë temë nuk ka parti të vogla, parti të mëdha, parlamentare, jo parlamentare dhe për këtë temë duhet të jenë të gjitha partitë të barabarta.

Normale është që opozita është më e zëshme, bën edhe më shumë zhurmë për të krijuar opinionin se janë partitë më të mëdha, me më shumë përkrahje, se do ta ndërrojnë spektrin politik edhe ky aderimi prej partisë në parti e ka këtë qëllim dhe kjo temë po shfrytëzohet në këtë mënyrë. Edhe për këtë nuk kam vërejtje dhe është e drejta e partive. Më në fund, ky është kuptimi i ekzistimit të partisë, se partia nuk ka kuptim në qoftë se nuk lufton për pushtet. Le të jetë përgjegjësia e votuesit, kur të vijë zgjedhjet ta vlerësojë cila parti synon pushtetin për të mirën e vendit dhe të qytetarëve dhe cila parti ka qëllime tjera.

Prandaj, për këtë temë është jo vetëm mirë, për shkak të stabilitetit politik, por është edhe obligim të hapet dialogu demokratik, me kohë. Pa marrë parasysh që Kryetari ka të drejtë me Kushtetutë të shpallë zgjedhjet, mendojmë se jemi në situatë specifike dhe jemi në situatë të krijimit, në fazën e krijimit të shtetit dhe ka pas vyer të jetë dialogu ndërpartiak.

Te ne, pas shpalljes së pavarësisë, kemi aprovuar shumë ligje të cilat janë nga pakoja e Ahtisarit, të cilat kanë qenë edhe i kemi pranuar si obligim, ndër to kemi aprovuar edhe Ligjin zgjedhor dhe ky inercion po duket është reflektuar edhe në marrjen e vendimit nga Presidenti i Republikës për mbajtjen e zgjedhjeve lokale në vjeshtë sivjet dhe zgjedhjet parlamentare në vitin 2011.

Pa marrë parasysh a është vendimi e drejta e Presidentit nga Kushtetuta dhe a është edhe obligim nga pakoja e Ahtisarit apo ndonjë marrëveshje tjetër e nënshkruar apo gojore, vendimi aq i rëndësishëm duhet të jetë i përkrahur nga shumica e partive politike, por me siguri të respektohet ligjshmëria. Prandaj, diskutimi dhe dialogu me partitë politike duhet të bëhet para marrjes së vendimit.

Pa diskutim, vendimi i Presidentit edhe pa e mohuar drejtën e tij, në opinion krijon një mendim se është jodemokratik, mos të them edhe imponues, dhe mendoj se ky vendim i ligjshëm nga ai, me veprimin, me paraqitjen në opinion është apolitik.

Ne në Partinë Socialdemokrate kemi pasur pikërisht këtë vërejtje. Pse vendimi i Presidentit pa diskutim dhe pa dialog, kështu nuk krijohet shoqëria demokratike dhe nuk kultivohet demokracia.

Kjo mënyrë e veprimit ka nxitur reagimet edhe me vend, edhe pa vend, ka mundësuar të shprehen edhe mos kënaqësi të llojllojshme, të cilat nuk i kanë synimet e shëndosha të formimit të shtetit funksional.

Dialog mes partive politike serioze të cilat e kanë në vëmendje zhvillimin dhe përparimin e vendit peshojën arsyen e mbajtjes së zgjedhjeve, pos ligjshmërisë. Në dialog me siguri kishte për të peshuar, në Social demokratët kështu e kemi bërë, në një anë çka është obligimi nga Kushtetuta, nga pakoja e Ahtisarit, marrëveshjet e tjera, me një fjalë, ligjshmëria. Në anën tjetër, duhet të vlerësohet realiteti, situata dhe zgjedhjet mund të bëhen edhe të parakohshme në qoftë se kërkon realiteti i ri i krijuar nga ngecja e zhvillimit të vendit. Po, a është ky momenti? Dhe a është pyetje? Prandaj, për neve argument që nuk merr, ne nuk e marrim parasysh mos kënaqësinë, e cila buron se dikush është jashtë lojës së Qeverisë, ose e ka kapluar emocioni politik. Ky argument momentalisht që paraqitet në opinion, për ne nuk është argument. Për ne është i rëndësishëm edhe një argument tjetër, a është ndryshuar spektri politik në Kosovë? Cili është preokupimi i partive politike ose, më mirë të them, i liderëve të partive politike? A është vetëm pushteti? Unë mendoj, në këtë moment është vetëm pushteti.

Ku është përgjegjësia për krijimin e partive politike moderne evropiane, partitë e profilizuara, sepse nesër ne duam të jemi pjesë e familjes evropiane në Parlamentin Evropian. Aty janë partitë të profilizuara me programe konkrete dhe po e ndërpres këtë temë me këtë konstatim: Mendoj se na mungon një impuls brenda partive për t'i bërë edhe partitë evropiane.

Te ne partitë janë për liderin, Ligji zgjedhor është për liderin, kur ta kthejmë të kundërtën, lideri për partinë, partia me programin për qytetarin. Sa për ne socialdemokratët, ne jemi të gatshëm për të dy palë zgjedhje të sivjetme, se jemi parti e profilizuar me programin e qartë, por jemi që të peshohet a janë ato në favor të zhvillimit të vendit, zgjedhje lokale po, për zgjedhjet parlamentare, kemi menduar, ta kishim hapur dialogun, që ndoshta situata do të krijohet që të mbahen edhe para vitit 2011, ndoshta ka qenë një kompromis 2010, por nuk është ky propozim sot për këtë datë, por është diskutuar. Prandaj, në qoftë se dikush mendon se jam në kuadër të Partisë Demokratike, e këtu e kam qëndrimin e veçantë, ne do të krijojmë një mendim të lirë, konstruktiv dhe nuk mund ta mbrojmë kërkesën e cila nuk është e shëndoshë, as t'i mbrojmë edhe veprimet, të cilat janë në kundërshtim me zhvillimin demokratik të shoqërisë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala vam poslanice Jashari! Reč imate poslaniče Smaka, neka se pripremi gospodin Berim Ramosaj.

RIZA SMAKA: Të nderuar deputetë,

Si temë bosht e kësaj seance -shtyrja dhe mbajtja e zgjedhjeve, unë natyrisht kam obligim edhe moral, edhe juridik për ta bërë interpretimin sa më objektiv të dispozitave kushtetuese. Nuk mund të flitet për shtyrjen e zgjedhjeve përderisa nuk kanë qenë të caktuara, të konvokuara, por fjala është se Presidenti e ka bërë komentimin e dispozitës përkatëse të Kushtetutës dhe nuk e ka bërë interpretimin që nuk do të ishte i autorizuar, interpretimin do të duhej ta bënte ekluzivisht Gjykata Kushtetutare, ama kjo çështje nuk është ngritur dhe nuk ka arritur te gjykata sepse ende nuk e kemi atë.

Apelimet për marrëveshje, ka pas marrëveshje, ka pasur ku ta di unë, ose dikush thotë pakoja, gabimisht, nuk është fjala për pako. Vetë Ahtisari, autori nuk e ka quajtur pako, e ka quajtur propozim. Madje, madje ai ka mbetur propozim për shkak se nuk është shndërruar në dokument politik, juridik, bilateral, përkatësisht trilateral, por ka mbetur si i tillë. Prandaj, ju lutem, nuk është fjala për një dokument, i cili do të obligonte në këtë rast, sepse vetëm Kushtetuta e obligon presidentin, jo presidentin po edhe bujkun, edhe

blegtorin, edhe deputetin, ndërsa plani i Ahtisarit e marrëveshjet ato merren si dokumente, nëse merren si dokumente burime, a burime juridike, janë burime fakte, burime akte. Në këtë rast do të ishin burime fakte, ama burimet nuk merren bazë as për komentim akademik, por natyrisht për diskurse etj. etj., ama për komentim të Kushtetutës kurrësi, merret vetëm dispozita përkatëse e Kushtetutës që, dorën në zemër, Presidenti e ka përfillë në mënyrë korrekte.

Sa iu përket interpretimeve, ka shumë libra, veç shkurtimisht do t'i them disa gjëra. Do të ishte fort, fort mirë që ato të vireshin në mënyrë korrekte, se ka interpretime juridike, logjike, sociologjike, historike, teologjike, gjuhësore e të tjera, a juristi më i mirë e më i mirëfilltë gjithmonë ato në kompleks do t'i merrte dhe më pastaj do të konkludonte logjikisht, apo jo, e jo fragmenatirisht, sepse dalin natyrisht rezultate krejt tjetër fare nga vullneti politik i popullit.

Unë do të isha angazhuar në këtë kontest, që fillimisht ne, ja prej tashti po e zëmë, ta rishikojmë Ligjin për zgjedhjet. E kemi një Ligj edhe është një projekt që ende nuk ka arritur në bankat tona, që ndër të tjera, ju lutem, është një dispozitë apriori antikushtetutare, e po qe se do të miratohej nga shumica, apo jo, unë po e zëmë do të isha një ndër ata që do të kisha inicuar nulimin, kontestimin në Gjykatën Kushtetutare. Ja, e cila dispozitë, që është në fuqi dhe që është propozuar prapë. Qe, bie fjala votuesi për ta votuar, po e zëmë Primusin, paraprakisht duhet të përcaktohet për partinë që është në rregull, partinë politike, ama nuk është në rregull që ajo votë t'i shkojë automatikisht liderit të partisë politike, se krijohet lider artificial, fiktiv, e jo real. Pse mos të jetë shef i partisë politike ai apo ajo që e merr shumicën e votave. E pse të krijohet një, do të thotë, ta bëjmë një ligj të mirë, ta diskutojmë gjithanshëm dhe më pastaj mund të flasim edhe për zgjedhjet po e zëmë. Ka baza tjera, ka baza tjera, po e zëmë, edhe që mund të krijohet si mono kërkesa, mocioni për zgjedhjet. Unë angazhohem që Kushtetutën që e kemi, çfarë që është, nuk ka diskutim aty se ka dobësi, ka, ka kundërthënie të plota, ka mangësi, vakume, ama është një rregull që quhet Dura lex ser lex.

Ligji, në këtë rast Ligji suprem, çfarë është ai, më e mira e më të mirave është që të përfillet nga të gjithë, nga të gjithë jo se ka burgje edhe në Kosovë, edhe në Gjermani, edhe në SHBA, por nga shumica, aludoj nga shumica absolute të përfillet nëpërmjet ligjeve, të bëjmë ligje të mira, akte nënligjore edhe të punojmë shumë më tepër, se unë e kam një përshtypje që institucionet tona nuk janë efikase, nuk janë efëçiente, ka shumë dobësi dhe ato dobësi mund të eliminohen nëpërmjet punës së organizuar dhe serioze. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala vam, poslaniče Smaka! Naredni govornik je, umesto kartice Nexhat Daci, gospodin Berim Ramosaj. Izvolite gopsodine Ramosaj, a neka se priremi poslanik Ibrahim Selmanaj.

BERIM RAMOSAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Pa dashur t'i përsëris të gjitha ato që i thanë kolegët deputetë, kolegët e nderuar, unë sa munda të vërej, kanë mbetur edhe disa arsye plotësuese që në fakt të zbatohet ajo që ne e thërrasim ligjshmëri apo kushtetutshmëri.

Pa dashur të hyjë në aspektet juridike të cilat shumë bukur i foli profesori Smaka, pa dashur të shikoj anën juridike mbi të drejtën e shpalljes së zgjedhjeve dhe kur të

shpallen ato, meqenëse nuk jam profesionist i kësaj fushe, unë në parim jam që këtë çështje t'ia lëmë Gjykatës Kushtetuese në aspektin juridik. Por, fatkeqësia është e madhe se nuk e kemi ende të ndërtuar Gjykatën Kushtetuese, ende nuk kemi gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, që në fakt është një dobësi e institucioneve të Kosovës, është dobësi ndoshta edhe e këtij Kuvendi dhe e Qeverisë në përgjithësi.

Arsyet pse ishte dashur të mbahen zgjedhjet janë kryesisht të natyrës politike dhe të natyrës së zhvillimit të jetës institucionale dhe të ndërtimit të institucioneve të shtetit të Republikës së Kosovës. Arsye e parë që ndoshta është më e arsyeshme, të thirrem apo të bëhem vetëkritik, nga ky Kuvend është niveli i seriozitetit të këtij Kuvendit, të Republikës së Kosovës, që në fakt është nën çdo nivel në aspektin e shqyrtimit të çështjeve që preokupojnë qytetarët e Kosovës dhe që preokupojnë problemin e shtet ndërtimit, ku shumë çështje të natyrave kruciale, të natyrave shumë të rëndësishme nuk debatohen, nuk shqyrtohen dhe nuk nxirren konkluzat e duhura. Kjo ndoshta, zgjedhjet i bën më aktuale, edhe procesin zgjedhor me qëllim që të ndërtojmë edhe një strukturë të re të këtij Parlamenti, që të jetë strukturë, respektivisht Parlament i shtetit funksional të Republikës së Kosovës.

Arsye tjetër e mbajtjes së zgjedhjeve që do të rifreskonin jetën politike në Kosovë dhe ekzekutivin në vend, është keq menaxhimi, respektivisht qeverisja politike në Kosovë që bëhet pa vizion, që bëhet pa strategji, qoftë të zhvillimit politik, qoftë të strategjisë së shtet ndërtimit, qoftë të strategjisë së zhvillimit ekonomik. Edhe kjo është në arsye plotësuese që të mbahen zgjedhje dhe t'iu japim shans edhe njëherë qytetarëve të Kosovës të zgjedhin një qeveri funksionale, vërtet ekzekutiv i cili do të merret me çështje fundamentale dhe për aq sa është e mundur të krijojë një mjedis të përshtatshëm politik për mirë zhvillimin edhe të qytetarëve në aspektin individual, por edhe të Kosovës si tërësi.

Një arsye tjetër e mbajtjes së zgjedhjeve është mos dalja e qytetarëve të Kosovës në zgjedhjet e fundit mbi 40%. Kjo është një arsye që do t'iu japim shans qytetarëve që vërtet në Republikën e Kosovës, për zgjedhjet e reja të cilat do të mbështeten në Kushtetutën e Kosovës, sigurisht që do të dalin në zgjedhje më shumë se 40% dhe sigurisht që qeverisja dhe institucionet tjera do të kenë bazën më të gjerë edhe politike, edhe juridike dhe do të kenë edhe fuqinë më të madhe për vendimmarrje.

Një çështje tjetër që më jep edhe një argument plotësues, është thyerja e disa organizimeve joformale që bëhen në klanet politike të partive që janë sot në koalicion, të cilat sigurisht nuk kishin për të reflektuar ashtu si po reflektojnë vazhdimisht. Vetë fakti i moszgjidhjes së Ombudspersonit për katër herë me radhë tregon mosfunksionimin e Qeverisë, respektivisht mos aftësinë për të nxjerrë në mënyrë konsesuale një institucion i cili kishte për t'u marrë me të drejtat fundamentale të qytetarëve. Faktikisht, ka shumë arsye të tjera, qoftë të natyrës politike, qoftë të natyrës krejtësisht ekzistenciale, që të mbahen zgjedhjet.

Republika e Kosovës, në qoftë se dëshirojmë të funksionojë si shtet funksional, duhet të ndërtojë institucione funksionale që mbështeten në votën e lirë të qytetarëve të Kosovës. Këto zgjedhje që janë mbajtur, ne që jemi produkt i atyre zgjedhjeve, nuk janë mbajtur duke u mbështetur në shtetin e pavarur të Republikës së Kosovës, janë zgjedhje që janë mbajtur në një dokument, një kornizë institucionale që kishte kuptimin e një kornize shumë afatshkurtër, respektivisht provizore dhe ato institucione janë quajtur si

institucione të përkohshme. Nuk kemi nevojë në Kosovën e pavarur, të shpallur mbas Kushtetutës, ne të sillemi si institucione të përkohshme të vetëqeverisjes.

Binomi Thaçi – Sejdiu, në njëfarë forme po e dëmton edhe partneritetin real që kishim për ta pasur me bashkësinë ndërkombëtare, pa dashur të ndërhyjmë. Ne kemi nevojë të krijojmë partneritet me bashkësinë ndërkombëtare në kuptimin institucional, jo të ndonjë servilizmi. Edhe shtyrja e zgjedhjeve si mu ka duktë mua në aspektin e ndjeshmërisë, është më tepër rezultat i ndonjë qëndrimi politik të ndonjë institucioni ndërkombëtar, se sa i ndonjë institucioni vendor. Unë mendoj që edhe marrja e qëndrimit të fundit të Presidentit të Kosovës, ka qenë i influencuar kryesisht nga qëndrimet e bashkësisë ndërkombëtare.

Bashkësia ndërkombëtare më nuk na duron të jemi vetëm ata që shkojmë mbrapa dikujt. Ata kanë dëshirë të ndërtojmë një shtet funksional, një shtet që krijojmë partneritet dhe perspektiva e Kosovës qëndron në partneritet, por partner me dikë mund të jesh vetëm në qoftë se je i barabartë edhe në dije, edhe në vendimmarrje, e ne e këtë nuk po e dëshmojmë ende. Kjo është edhe një shtesë që duhet të mbahen zgjedhjet për Republikën e Kosovës, zgjedhjet qendrore apo të përgjithshme, me qëllim që ky Parlament dhe ajo qeveri që do të dalë nga ato zgjedhje, të jetë partner i barabartë në kuptimin e vendimmarrjes dhe partner në kuptimin e krijimit të raporteve këshillëdhënëse me bashkësinë ndërkombëtare.

Këto ishin disa arsye plotësuese të cilat mendoj që duhet të shkojnë edhe në vesh të qytetarëve, edhe në vesh të institucioneve. Unë shpreh keqardhje pse para këtij debati nuk janë aktorët themelorë, edhe Presidenti i Kosovës, edhe Kryeministri.

Nuk kemi dalë, nuk kemi dalë këtu, se u dëgjua nga disa kolegë deputetë, pa qëllim të nënçmimit të dikujt, debatet në Parlament nuk bëhen për të bërë zhurmë, por për të nxjerrë rezultate. Edhe këto kërkesa tona për zgjedhje të reja janë për rifreskim të jetës institucionale në Kosovë dhe nuk kemi nevojë t'i frikohemi një ambienti të ri, t'i frikohemi një raporti të ri, më së pari me vetveten e pastaj edhe me bashkësinë ndërkombëtare.

Integritet e Kosovës në jetën edhe evropiane, edhe euroatlantike, janë kusht por vetëm me partneritet të plotë të ndërtojmë një shtet funksional. Kështu, ky seriozitet, ky nivel i seriozitetit të këtij Parlamenti dhe të kësaj Qeverie, nuk po dëshmojmë se ne jemi duke ndërtuar institucione funksionale dhe, tek e fundit, shtet funksional që njihet me emrin - Republika e Kosovës.

KRYESUESI: I vama gospodine Ramosaj! Udvostručiliste vreme dogovora u vašoj diskusiji. Tokom diskusije, jedno obaveštenje gospodo poslanici. Tokom diskusije gospodina Ramosaja, broj prisutnih poslanika je pao na 36. Ovog momenta iznosi 39. Obaveštavam prisutne da skupštinska administracija pribeleži imena prisutnih, odsutnima će biti odbijena dnevica, a sada u ovom momentu imamo 40 prisutnih. Nastavljamo rad sa diskusijama kako smo se dogovorili od po 5 minuta, jer se nijedan diskutant u nastavku od pauze nije pridržavao tog djentlemenskog nepisanog dogovora.

Dakle, nastavljamo. Administracija će propisati imena prisutnih poslanika. Sledeći diskutant je... Vi ćete iskoristiti pravo, gospodine Gjini, vi ćete iskoristiti pravo kao pokretači današnje debate. Završnu reč ćete dati. Do tada, prozvan je poslanik Ibrahim Selmanaj. Izvolite poslaniče Selmanaj! Sledeća poslanica Sala Berisha Shala da se

pripremi za diskusiju. Gani Buçinca, sačekajte, vi, šta u njeno ime? U redu, u redu. Izvolite, režija molim mikrofon!

IBRAHIM SELMANAJ: Përshëndetje, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë, edhe pse numerikisht jo shumë,

Do të isha i vullnetit të mirë që këtu para meje ose prapa meje të ishte vet Kryetari i Kuvendit, i cili edhe më shtyri që të dal dhe të bisedoj. Më bëri përshtypje një element pak sa interesant te ajo forma e prezantimit të neneve të Kushtetutës nga vetë deputetët, dhe mesazhi që rrodhi në vazhdimësi, lexojeni ne këtë nen, lexojeni këtë nen. Unë do t'ia kisha bërë një përkujtim kryetarit të Kuvendit sikur edhe shefit të Qeverisë së Kosovës, kurrë nuk ka filluar në vitin 2007, as në vitin 2008. Duhet ta kenë parasysh edhe një fakt se kemi pasur një qeveri të përkohshme të Kosovës, që kemi pasur një kryeministër, por që kemi pasur edhe një mandat të dytë, të cilin e kemi pasur edhe një kryeministër dhe në këtë foltore jo më pak se qindra herë e kam dëgjuar një fjalë tepër fyese, tepër nënçmuese që është korrupsioni.

Unë besoj se do të përcillet kërkesa ime. Unë jam i gatshëm të ballafaqohem edhe si subjekt politik, edhe si individ edhe si ish ministër me një komision hetues. i cili do t'i nxjerrë të vërtetat prej vitit '99 deri në vitin 2009. Kjo mund të rrjedhë si kërkesë e paarsyeshme, por duke pasur parasysh në vazhdimësi prezantimet, qoftë para deputetëve të Kuvendit të Kosovës edhe në këtë mandat dhe në mandatin e kaluar, por edhe duke i pasur parasysh edhe qëndrimet të cilat janë paraqitur edhe para mediave, frustrimi, stresimi, destresimi, parapolitikat, prapapolitikat, paraskenat, prapaskenat, do të nxjerrin në pah një element krejt ndryshe pasi që Komisioni hetues do t'i bëjë vlerësimet e veta.

Një element tjetër, i cili sot ishte ende më nënçmues dhe mesazhi që e solli kryetari i Parlamentit të Kosovës, një pyetje që do t'ia drejtoja do të ishte kjo: Në mandatin e parë të Qeverisë së Kosovës, çfarë ministrie ka drejtuar Kryetari i Parlamentit tash dhe cili është profesioni i kryetarit të Parlamentit të Kosovës? Këto janë ato kërkesa që do t'ia parashtrij kryetarit të Parlamentit, dhe në të njëjtën kohë, unë mendoj dhe konsideroj se zgjedhjet të cilat shtyhen e kanë edhe një mesazh te qytetarët e Kosovës dhe te votuesit e Kosovës, pavarësisht numrit të vogël që kanë dalë në zgjedhje, mesazhi është i qartë.

Kryetari i Kosovës, Presidenti i Kosovës donë t'i zgjasin mandatin vetit dhe t'ju ofrojnë kushte më të mira familjes së vet, sidomos rreth punësimit në postë. Kryeministri i Kosovës, me mandatin e vet si kryeministër i vendit, do t'i kontrollojë dhe të bëjë monopol në shfrytëzimin e parave publike dhe monitorimin e tenderëve në Kosovë. Ky është një mesazh i qartë dhe kjo është porosia që me përgjegjësi të plotë e them para deputetëve të Parlamentit të Kosovës. Ju faleminderit, zoti Kryesues!

KRYESUESI: Hvala vam, poslaniče Selmanaj! Dakle, poslanik Gani Buçinca, neka se pripremi poslanica Teuta Hadri.

GANI BUÇINCA: I nderuari zoti kryesues, ju falënderoj që ma dhatë fjalën!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo është hera e dytë që dola para kësaj foltoreje. Kam qenë vetë opozitë 30 vjet dhe me të vërtetë shpreh keqardhje që shumë miq të mi që sot janë në opozitë, nuk po e ndiejnë veten mirë. Është një problem esencial në të kuptuarit e demokracisë si sistem. Mua më

vjen shumë keq që ju akoma nuk e keni kuptuar fuqinë e votës edhe fuqinë e pushtetit që ua ka dhënë qytetari i Kosovës.

U dëgjuan shumë diskutime të cilat vërtet ishin të paargumentuara, as në aspektin profesional, edhe në aspektin politik. Unë kërkoj nevojën tuaj emergjente që të vini në pushtet, se akoma nuk jeni mësuar të bëni oponencë profesionale dhe të bëni një kontroll demokratik të qeverisjes në Kosovë. Besoj se në rast se intimisht e pranoni humbjen në zgjedhje, edhe persekutimin që ua ka bërë elektorati i Kosovës, atëherë nuk do të akuzoni Qeverinë dhe Parlamentin se po ju persekutojnë juve këtu dhe nuk po ju jep hapësirë demokratike.

Demokracia nuk është një sistem i përkryer dhe i ka të metat e veta dhe fatkeqësisht edhe numrat e luajnë rolin e vet në ligjërimin politik, në luftën për pushtet dhe në të gjitha aspektet e tjera. Mos mendoni se një opozitë kaq minore, siç është Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në një vend diku kudo qoftë demokratik, do të mund ta ndryshonte agjendën e Qeverisë, strategjinë e programit qeverisës dhe agjendën e Parlamentit. Është e kotë, kolegë të nderuar, me disa prej jush jam edhe miq, mirëpo frustrimi i juaj nga vogëlsia që ua ka caktuar elektorati dhe dëshira për t'u faktorizuar duke hapur dialog me Presidentin e Kosovës, me Kryeministrin e Kosovës, është krejtësisht për nevoja personale dhe individuale të liderëve, të liderit të juaj politik dhe të disa eksponentëve të kësaj partie.

Nuk mund të vijë edhe të bëhen zgjedhjet në Kosovë pse dikush do të bëhet kryeministër, zotëri! Nuk është logjike, as reale. Ju duhet të kuptoni demokracinë si një rregull, si një shumësi rregullash, normash dhe parimesh. Nuk mund të kemi zgjedhje në Kosovë sa herë dikujt t'i teket të provoj të bëhet kryeministër ose sa here një partie politike t'i teket që të vijë në pushtet. Ky është hazarder, vetëm hazarderët bëjnë kështu kur luajnë bixhoz. Sa herë humbin, thonë, edhe njëherë ta provoj derisa të humbin edhe shtëpinë. Nuk është demokracia lojë bixhozi, zotëri, dhe mos u mundoni ta paraqitni si interes të qytetarëve të Kosovës fragjilitetin politik dhe institucional të Kosovës.

Çdoherë kur hyhet në zgjedhje, institucionet e humbin funksionin e vet që e kanë dhe nuk mund të ushtrojnë pushtetin ashtu siç duhet për arsye se energjia kanalizohet diku tjetër.

Nuk është në interes të qytetarëve që ju të mohoni legjitimitetin dhe legalitetin e mandatit të institucioneve të Kosovës. Është interes i liderëve të juaj partiak dhe i juaji personal. Ju e dini shumë mirë, se që 8 muaj me radhë ju terrorizoni tërë opinionin publik në Kosovë gjëja se gjendja në Kosovë po vjen duke u përkeqësuar. Nuk është e vërtetë. Ju, kur vini në këto konstatime, nuk keni asnjë kriter relevant, racional, profesional. Vazhdimisht ju mohoni të arriturat e Qeverisë dhe, në rast se vazhdoni kështu, kolegë të nderuar, jam i bindur se një ditë do ta akuzoni këtë Qeveri pse në Kosovë po bie shi, po bie borë e nuk po bie dollarë e euro që të dalin qytetarët e Kosovës dhe të mbledhin, të mbledhin nëpër rrugë.

Kur vlerësohet puna e një qeverie dhe kur gjenden argumentet për të dalë në zgjedhje të parakohshme, duhet vendosur disa kriterë, kurse ju i bëni të gjitha këto vlerësime pa asnjë kriter. Kriteri i parë është buxheti i Kosovës, kriteri i dytë janë rrethanat politiko-shoqërore dhe ekonomike, konteksti historik kur një qeveri vjen në pushtet. Kriteri i tretë është teoria e komperacionit. Këtë duhet të kemi një pikë referimi dhe të krahasohet me një qeveri paraprake dhe, normalisht, kriteri i katërt duhet të jetë programi i Qeverisë, strategjia, filozofia qeverisëse. Ju, kur i bëni vlerësimet, nuk

bazoheni në asnjë kriter dhe kësaj Qeverie ia atribuoni dështimet tona njëshekullore si popull. Pse kjo Qeveri nuk po arrin t'i zgjedhë të gjitha këto probleme me një shkop magjik për tetë muaj.

Dhe, tash të kthehemi te disa diskutime që ishin krejtësisht të paargumentuara. Thotë, kjo Qeveri po e çon vendin në katastrofë, kjo Qeveri po keq menaxhon, kjo Qeveri nuk ka as rezultat, s'ka kapacitete qeverisëse, s'ka kapacitete intelektuale. T'ju them të drejtën, nuk desha t'iu përgjigjem në këto pyetje, se ata që po na shikojnë dinë të na vlerësojnë edhe ju, edhe ne që jemi këtu. Mirëpo, të akuzosh për gjëra të tilla, pa asnjë argument, sidomos nga ish-ministrat të cilët nuk mund të jenë shembull absolut i një partie, që nuk mund të jenë shembuj absolut i mirë i qeverisjes, siç ishin ministrat e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, është krejt absurde. Krejt absurde! Ka ndryshuar kursi qeverisë në Kosovë. Pajtohem me një diskutues që tha ka ndryshuar kursi, po ka ndryshuar për të mirë. Ka ndryshuar kursi se në Kosovë nuk ka më informalitet ekonomik, siç kishte në një qeveri dhe që favorizohej nga disa ish-ministra të qeverisë që e kemi lënë prapa. Nuk ka shantazhe më në Kosovë, siç kishte më herët. Nuk ka informalitet të pushtetit më në Kosovë dhe unë e kuptoj se ju jeni shumë të brengosur për këtë. Nuk ka më dhe jeni të brengosur edhe për shumë arsye tjera se kjo qeveri po funksionon shumë bukur dhe koalicioni dhe partnerët e koalicionit janë dakorduar që hap pas hapi të ndryshojnë shumë gjëra që ishin të nevojshme të ndryshohen në Kosovë. Askush nuk e ka akuzuar një qeveri më herët pse s'e ka bërë këtë e këtë, se nuk i ka zgjidhur problemet shekullore të këtij populli, për arsye se edhe kufizime kanë pasur qeveritë e mëherëshme, nuk kanë pasur edhe kompetenca sa duhet. Mirëpo, është koha t'i lëmë kohës kohë dhe të shohim se si do të vazhdojë kjo qeveri qeverisjen e vendit dhe është koha që t'i qojmë mesazh faktorit ndërkombëtar që në Kosovë ka stabilitet institucional, se në Kosovë ka të arritura në të gjitha sferat. Duhet t'ua përkujtoj këtu edhe një thënie të Skenderbeut. Kur arriti në Krujë, populli me ovacione iu falënderua për lirinë që ia solli popullit. Ai iu drejtua, tha: "lirinë nuk ua solla unë, por e gjeta në mesin tuaj". Kjo qeveri korrupsionin e ka gjetur këmbëkryq në Kosovë dhe këtë korrupsion e kanë favorizuar edhe administrata e UNMIK-ut, edhe do ish-ministra të qeverisë paraprake, sidomos të partisë më të vogël opozitare, e cila po ka dëshirë sa më shpejt të vijë dhe ta drejtojë vendin. Kanë ikur këto kohë, zotëri, dhe unë besoj se edhe ato institucione të cilat e kanë për detyrë ta luftojnë korrupsionin, i ka krijuar administrata e UNMIK-ut dhe nuk i ka krijuar kjo qeveri dhe ka nevojë për reforma të thella. Le të tregojë një shembull opozita kur kjo qeveri e ka përdorur autoritetin e vet dhe e ka penguar hetimin për korrupsion në Kosovë. Të vetëm!

Dhe, u përmend këtu edhe Peter Feith për deklaratat e tij. Peter Feith ka probleme me burokracinë evropiane në Kosovë. Probleme të theksuara ka dhe të gjitha ato akuza që vijnë nga Peter Feith duhet t'ia adresojë administratës së UNMIK-ut dhe tash të EULEX-it. Janë këto kompetenca të rezervuara, rendi dhe ligji dhe siguria në të dy këto segmente, ai duhet t'ia adresojë kritikën aty ku e kanë vendin. Urojmë që UNMIK-u, urojmë UNMIK-un që të shkojë sa më shpejt nga Kosova, se ka ardhur koha, se është i vdekur si institucion, mirëpo urojmë që EULEX-i të mos i përsërisë gabimet e UNMIK-ut në sferën e sundimit të ligjit. Urojmë që KFOR-i dhe organizatat e tjera mos t'i përsërisin gabimet e UNMIK-ut në sferën e sigurisë në Kosovë. Urojmë që të ndryshojë diçka për mirë në Kosovë dhe urojmë që kjo qeveri të vazhdojë mandatin e vet dhe të punojë me përkushtim, siç është duke punuar. Unë ju dëshiroj shumë sukses dhe mos u brengosni, kini kohë të përmirësoheni dhe të funksiononi e të veproni si opozitë, e cila ka për qëllim të jetë ndërgjegje e vërtetë e Qeverisë, kurse ju si opozitë jeni vetëm ndërgjegje e vërtetë e liderëve të juaj, të cilët unë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Hvala vam, poslaniče Bućinca! Deset minuta je prošlo. Dakle Teuta Hadri ima riječ. Sledeći izlagač je poslanik Berat Luzha.

TEUTA HADRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Arsyeja që më shtyri mua për ta marrë fjalën është nxitja që më bënë diskutuesit apo parafolësit e këtij Kuvendi, duke dalë sot, duke keqpërdorur foltoren dhe fjalën e tyre në vend që të diskutohet për rendin e ditës për zgjedhje, më tepër u nisën nga motivi i tyre për t'u ngritur kundër qeverisë se sa që u ndalën te koncepti i fjalës zgjedhje, se koncepti i fjalës zgjedhje edhe unë kam pritur sot se do të dalin me të vërtetë të mbështeten te ky koncept, e jo të dalin nga ky koncept dhe të kenë mbështetje tjera. Parafolësit e mi folën, unë mendoj se asnjëri prej tyre, përveç Driton Talit, nuk doli me një propozim për koston e këtyre zgjedhjeve. Të jesh deputet i këtij parlamenti, mendoj se duhet të mendohet edhe politikisht, edhe ekonomikisht. Të jesh politikan dhe të propozosh sot zgjedhje, 8 milionë euro, kur kriza botërore kudo na ka kapluar, kur Kosova nuk ka miniera dhe sot propozohen zgjedhjet, kur arsimtarët e presin ngritjen e pagave, kur shëndetësia ashtu i pret, policia e cila me marrëveshje me qeverinë e kanë kaluar këtë gjendje, unë mendoj se sot nuk je as politikan as patriot. Unë mendoj se sot më tepër je bajraktar dhe e them fjalën bajraktar. Dikush tha, zhurmë. Unë them dy herë bëhet zhurmë, se me të vërtetë ky parlament nuk e ka pasur një opozitë aq të fuqishme për t'i ndihmuar këtij institucioni që sot Kosovën ta njohin shumë shtete demokratike. Kanë bërë zhurmë se s'na njohin kaq shtete. Pse s'po njihen nga Kosova po nga liderët tanë. Pse s'bëhet një angazhim më i madh politik. E sot, kërkojnë zgjedhje, 8 milionë euro. Unë besoj se qytetarët tanë, zonjë, unë ju dëgjova të gjithëve dhe ju dëgjoni. Qytetarët tanë sot dalin nga këto institucione, kanë me na thënë të gjithëve, edhe në familje tuaja, a ju vjen turp të kërkonin zgjedhje në këtë gjendje që ka këtë kosto buxheti i Kosovës. Këto pesha që i kemi në buxhet, duke i paraparë të gjitha ato që i folëm me arsim, unë e them, prapë kthehem te fjala bajraktarizëm. Kur kam dëgjuar kërkesën e deputetëve përpara, vërtet i kam analizuar mjetet e informimit në media se kanë të drejtë, se duhet ta mbajnë gjallë opozitën e vet se kanë humb dhe kështu t'i tregojnë opozitës se po bëjmë diçka, po duam zgjedhje. Mirëpo, sot të hyhet në rend dite, mendoj se nuk janë politikanë të mëdhenj. Kosova ka nevojë për ngritjen e institucioneve, ta njohin ndërkombëtarisht më shumë dhe vërtet edhe unë kam qejf të jem kryeministër apo ministër, se asnjëri s'ka bërë prej liderëve të opozitës më shumë se ne. E mendoj si ish-dikur e dënuar politik apo njerëz që i kemi shërbyer politikës kosovare dhe të gjithë kemi qejf, edhe ata që sot kontribuojnë, mirëpo sot është ndërtimi i funksioneve, i institucioneve të Kosovës dhe funksionalizimi i tyre. Prandaj, kam propozim që tjera herë opozita me të vërtetë të dalë me fakte, të mos dalë të humb kohë kaq shumë, mos të bëjnë zhurmë, të dalin me llogari, të mendojnë sa kushtojnë zgjedhjet dhe besoj se na kanë bërë një fushatë shumë të madhe, se qytetarët kanë për t'i kritikuar – çfarë zgjedhje doni ju, në fakt, na kanë bërë fushatën. I falënderoj!

KRYESUESI: Hvala vam poslanice Hadri! Gospodine Luzha, imate riječ. Neka se pripremi poslanik Ramadan Avdiu.

(Ndërhyrje e deputetes Teuta Hadri)

Režija, možete li minut samo produžiti, s obzirom da nije iskoristila vreme, poslanici Hadri.

TEUTA HADRI: Unë mençurinë time e kam treguar, i them zonjës Gjylnaze, se nuk jam rrokullisë rrugëve të qyteteve të Kosovës, kam dalë aty ku e ka lyp zëri i Kosovës, qoftë në luftë, qoftë në lëvizje, e nuk iu kam bërë servil asnjë lideri politik dhe ta marrë fjalën në emër të inteligjencës, e në emër të patriotizmit të dalë gjithkush e të flasë këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Pomenuti ste poslanice Syla. Molim režiju, imate pravo jedan minut.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit zoti kryesues!

Më vjen shumë keq që zonja Teuta ndihet kështu. Shpresoj se do të qetësohet, ndoshta është mirë të dalë në pauzë nga 5 minuta të pijë një ujë të ftohtë. Personalisht, ofroj veten për të punuar dhe konsideroj se jam konstruktive në të gjitha debatet dhe jam këtu për atë për çfarë më kanë zgjedh qytetarët e Kosovës dhe do të vazhdojë me këtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ja bi molio poslanike koji će tek imati diskusije, da ne pominju imena. Sačuvajmo dostojanstvo današnje seanse! Dakle, prozivam poslanika Berata Luzhu. Imate reč, gospodine Luzha. Molim reziju....!

BERAT LUZHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ka disa muaj që opozita bën një zhurmë të madhe për zgjedhjet, e cila uzhurmë tash është shëndrruar në një kakofoni shurdhuese. Desha t'ia kujtoj me pak fjalë opozitës disa fakte se që nga pakoja e Ahtisarit ka ndodhur shumë çka, siç e thanë edhe ata, ka ndryshuar shumëçka. Dhe, që nga pakoja e Ahtisarit është bërë marrëveshja e partive politike, të cilën e shpjegoi mirë zoti Haziri, e cila e ka rregulluar çështjen e sistemit të zgjedhjeve, të mandateve, zonat zgjedhore, pragun zgjedhor, format e votimit dhe modalitetet e tjera të zgjedhjeve. Për marrëveshjen është prononcuar edhe ish-zyrtari i lartë i AAK-së, i cili ka qenë një nga liderët e opozitës dhe kanë shkruar edhe një mori mediesh, të cilat nuk kanë shkruar për hatër tonë për shkak se atëherë kemi qenë opozitë.

Që nga pakoja e Ahtisarit ka ndodhë Rregullorja e UNMIK-ut, e cila është nënshkruar nga zoti Rycker, e cila ka rregulluar edhe mandatet e zgjedhjeve të ardhshme. Ka ndodhur gjithashtu Kushtetuta e Kosovës, e cila ka rregulluar, gjithashtu, edhe çështjen e zgjedhjeve. Që nga pakoja e Ahtisarit, ka ndodhur edhe deklarata e zotit Ahtisari, i cili nuk e ka pa të domosdoshme që zgjedhjet të mbahen sipas propozimit të tij.

Edhe komentimi i Kryetarit të Kosovës, komentimin e Kushtetutës në fakt, i cili është i autorizuari kryesor për ta komentuar Kushtetutën dhe gjithashtu edhe interpretimi i zotit Peter Feith, i cili është njeriu më i autorizuar për interpretimin e pakos së Ahtisarit.

Unë mendoj se kriza nuk është te pozita. Kriza është te opozita. Opozita është e përçarë, është e dobët dhe është e dështuar në qeverisjen e mëparshme. Prandaj, ajo ka nevojë që të konsolidohet dhe të dalë në zgjedhjet lokale dhe ta shoh se ku ndodhet, të matet mirë dhe pastaj të kërkojë zgjedhje të ardhshme parlamentare.

Nuk është mirë të matesh shpesh për shkak se sa herë që të matesh, aq më lehtë vjen. Kosova ka nevojë për njerëz të ri, është e vërtetë, por Kosova nuk ka nevojë për njerëz të dështuar, për njerëz të opozitës për shkak se të gjithë i dimë marifetet e tyre, për shkak se të gjithë e dimë se si kanë dështuar ata dhe çka kanë bërë ata gjatë qeverisjes së tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala vam, poslaniče Luzha! Sledeći govornik je Ramadan Avdiu, a neka se pripremi poslanik Sadik Idrizi.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të jam shumë i shkurtër. Dua të them se në debatin e sotëm të iniciuar nga deputetët e AAK-së, iniciuesit e këtij debati nuk kanë mundur me asnjë argument që të argumentojnë se ka nevojë për zgjedhje të parakohshme në Kosovë. Ajo çka më shtyri të flas është që do të dëshiroja t'i kundërshtoja disa parafolës të cilët debatin e shfrytëzojnë për t'i përsëritur në vazhdimësi disa akuza të paqëndrueshme, për të përsëritur në vazhdimësi domethënë në mënyrë edhe të paargumentuar dhe të shfrytëzojnë edhe mos prezencën e vet ministrave këtu, për të thënë se, jo, nuk kanë vizion, jo, nuk janë... duke keqpërdorur apo duke keq qeverisur, e të gjitha këto. Ne kemi thënë një herë, e përsërisim, që të gjithë ata që mendojnë dhe kanë argumente për keq qeverisje, në radhë të parë do ta kenë edhe mbështetjen e Grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës për ta denoncuar këtë qeverisje, por në institucionet përkatëse. Jo, kjo po më ngjason në atë lojën kile, t'ia lë kile dhe pastaj unë të dal prej këtu. Dhe, thuhet në njëfarë forme shumë pezhorative, kryeministri ka punë për t'i kontrolluar tenderët dhe për të kontrolluar shfrytëzimin dhe shpenzimin e parasë publike. Ajo është një detyrë e tij dhe është shumë mirë, domethënë, që ka vendosur kontroll dhe ka kontroll të plotë edhe në shpenzimin e parave publike, po ka kontroll edhe në procedurat e tenderimit. Ky është mandati i kryeministrit, përndryshe ndoshta dikush është mësuar që të mos ketë kontroll fare dhe pastaj të vazhdohet me atë avazin e vjetër. Është shumë mirë, vizioni i Qeverisë është parë deri tash, brenda këtij viti çka është punuar. Besoj se në vazhdim, deri në fund të mandatit më 2011, kjo Qeveri do t'ia ndërrojë komplet pamjen Kosovës dhe besoj se deri atëherë edhe kolegët tanë, domethënë edhe partitë opozitare do të mund të konsolidohen më mirë, kurse sa u përket zgjedhjeve lokale ato do të mbahen sivjet. Për shkak të opinionit, jo për shkak të deputetëve, duhet t'i sqaroj që ditën në kur kemi ardhur të nënshkruajmë mandatin tonë, secili nga deputetët e pozitës dhe opozitës në ndërdijen e tyre e kanë pasur se do të jenë deputet katërvjeçar, me mandat katërvjeçar. Prandaj, do të thotë, krejt kjo nebulozë, krejt ky debat i cili është hedhur në publik, vërtet për mendimin tim është i kotë dhe, aq më keq, kur shfrytëzohet ashtu në Parlament për të akuzuar në mënyrë shumë të pabazuar institucionet e vendit, qeverinë ose cilindo prej ministrave. Ai i cili ka një argument, domethënë, janë institucionet përkatëse, mund të shkojë dhe të mos e shfrytëzojë foltoren e Parlamentit për të dalë në publik se unë ia lash kile një ministri ose një deputeti të cilësdo parti qoftë. Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala vam poslaniče Avdiu! Imate riječ poslaniče Idrizi. Neka se pripremi poslanica Myfera Shinik.

SADIK IDRIZI: Hvala, predsedavajući!

Ja mislim da je legitimno pravo opozicije da traži izbore, kao što je pravo opozicije da traži ostavku vlade, ostavku ministara. U ovom slučaju, naša opozicija to ne traži jer je svesna da nema snagu da to uradi jer za to je potrebno da ima, da napravi većinu, ali je u svakom trenutku pravo opozicije da vrši pritisak da dodje do preveremenih izbora i tako dalje.

Na Kosovu smo od 2000. do 2007. godine imali šest izbora, po tri u oba nivoa. Neki izbori sa mandatom od 2 godine, pa tri godine, neki četiri godine i tako dalje, što znači da Kosovo nije bilo bez izbora, nije bilo da se izbegavalo, odnosno da se nisu izbori

održavali. Za ovo što imamo danas ovaj problem, krivi su Rusi. Znači, isključivi krivac su Rusi, jer nisu glasali, nisu dali da prodje Ahtisarijev paket kada je trebalo. Da je prošlo negde u proleće 2007.godine, sve bi bilo u redu. U ovom slučaju, s jeseni 2007. godine dogovor je bio da se izbori održe sa mandatom od 2, odnosno 4 godine – lokalni i centralni. Ako insistira opozicija danas a insistira u poslednje vreme da legitimitet prema Ahtisarijevom paketu ovoj Skupštini 15. marta ističe. To je znači od 15. juna, do 15. marta je 9 meseci, i ako je po tome, ovaj parlament ima mandat još mesec dana. Međutim, Ustav ne govori tako. Ustav je dao mogućnost odnosno da do kraja mandata institucije održe onaj mandat koji je bio odredjen 2, odnosno 4 godine.

Ja bih pozvao ljude koji nisu zadovoljni ovim da iskoriste svoje moralno pravo i da 15. marta vrata mandat, pa kažu mi više nismo, jer nije u skladu sa ovim što je u Ahtisarijevom paketu i kaže, ja ne mogu da budem u ovom parlamentu, jer mu je istekao mandat, odnosno nije više, nema legitimitet. Ali svi smo svesni da naš legitimitet traje do kraja, znači lokalnim izborima do kraja ove godine, tamo do 17. novembra, a 17. novembra 2011. godine traje mandat ovom parlamentu. Ukoliko se ne dogodi nešto drugo, da vlada ima nešto drugo, da nema većinu, da propadne većina u Parlamentu, to je sasvim normalno, onda se raspisuje izbori. Predsednik nije doneo nikakvu odluku, to svi znaju, predsednik je dao jedno razjašnjenje o tome da su lokalni izbori na kraju ove godine, a oni drugi 2011. godine. Ustavni sud će dati svoje mišljenje i mislim da bi trebalo da se ovde sačuvamo od kvalifikacija, jer smo kolege, da nekada ne prelazimo granicu dostojanstva. Mislim da se ovaj parlament često puta suzdržavao od loših kvalifikacija i mislim da nastavimo tu praksu, jer smo pod prismotrom i naših birača, građana, međunarodne zajednice i mislim da treba da sačuvamo dostojanstvo. Hvala!

KRYESUESI: Hvala, poslanice Idrizi! Imate reč poslanice Mufera Shinik, a neka se za diskusiju pripremi poslanik Sabri Hamiti.

MÜFERA ŞINIK:

Sayın Başkan, Milletvekilleri ve televizyonları başında bizleri saygıyla izleyen değerli halkımıza selamlarımı ve saygılarımı sunuyorum

Bu gün burada, yani Kosova Meclisinde, Kosova Meclisi genel seçimleri tartışılıyor. 2007 yılının Kasım ayında yapılan yerel ve genel seçimler, Ahtisari planına göre yapılmıştır. Kosovanın bağımsızlığının ilan edilmesinden hemen sonra, Kosova Anayasası kabul edilerek, yürürlüğe geçmiştir.

Kosova Anayasasına göre, genel ve yerel seçimlerin yapılmasının ilan edilmesinde Kosova Başkanı yetkili olduğu görülmektedir.

Anayasanın 66. maddesine göre, Kosova Meclisi temsilcilerinin, yani milletvekillerinin görev süresi dört yıldır.

Anayasanın yürürlüğe geçmesiyle, her konuda olduğu gibi, bu konuda da ister Kosova Başkanı, ister de Kosova Meclisi, yasalara, Anayasaya ve demokratik süreçlere saygı göstererek hareket etmesi gerekmektedir.

Bunun dışında, Kosova Cumhuriyetinin dış ülkeler tarafından tanınmasının gündemde olduğu bu yıl içerisinde, seçimlerin değil de tanınma sürecinin hızlandırılması için lobicilik yapmanın zamanının olduğuna inanmaktayım.

Bundandır Anayasaya saygı duyarak, genel seçimleri tarihinin 2011 yılında olması gerektiğini düşünmekteyim, buna da bütün milletvekillerinin saygı duyacağına inanıyorum.

Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Hvala poslanice Shinik! Professore Hamiti, imate riječ. Vi ste poslednji diskutant. Neka se pripremi predstavnik Parlamentarne grupe koja je pokretač današnje debate.

SABRI HAMITI: Zoti kryesues!

Zonja ministre Kelmendi,

Deputetë, kolegë të nderuar,

Unë e kam respektuar një kërkesë procedurale të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës që të diskutohet për këtë temë, si për tema tjera, aq më tepër sepse si kurdoherë, siç ngjet, problemet bëhen publike pa u shoshitur në substancën e vet nëpër institucione e mandej njerëzit po lodhen – argumentet dhe jo argumentet po i ..., po i hanë në publik pa i pru në institucione, që nuk është mirë. Këtë iniciativë unë e kam mbështetur dhe me durimin më të madh për ta respektuar edhe Kuvendin, edhe kolegët, i kam dëgjuar të gjithë me radhë. Po e them këtë për shkak se është në natyrën demokratike të Parlamentit që edhe të dalin njerëzit, mërzen, nuk dëgjojnë dhe duhet të mësohemi me këtë, mos t'i mërzisim duke thënë pse e lëshuat diskutimin, por ata që e respektojnë, rrinë. Unë jam një prej atyre që e respekton dhe i kam dëgjuar të gjithë.

Më lejoni që t'i them edhe unë 3-4 fjalë për këtë problem. Këtu tema ka qenë e formuluar gabim, por ashtu e kanë formuluar paraqitësit dhe është e drejtë e tyre, thonë për vendimin. Unë, edhe një herë po ju them, kam thënë edhe atje ku kam biseduar për këtë problem më herët, që nuk ekziston kurrfarë vendimi i Presidentit Fatmir Sejdiu, si thuhet, për të shtyrë zgjedhjet. Pse? Sepse me Kushtetutën e Kosovës, Kryetari i Kosovës, në këtë rast zoti Fatmir Sejdiu, nuk ka të drejtë të marrë vendim për shtyrje ose për mos shtyrje, por e ka detyrë t'i shpallë zgjedhjet për Parlamentin e Kosovës dhe ta organizojë seancën e parë. Pikë! Kjo është germa e Kushtetutës. Fatmir Sejdiu, Kryetar i Republikës së Kosovës as s'ka shtyrë zgjedhje, as ka shpall zgjedhje, as s'ka anoncuar se kur do t'i shpallë. Ai e ka bërë një interpretim, unë do ta quaja, interpretim të një neni të Kushtetutës së Kosovës në fuqi, që ka të bëjë me mandatet e pushtetit lokal, të këtij që i themi ne të pushtetit nacional, edhe të atij legjislativ, edhe të atij ekzekutiv, dhe këtu përfundon diskutimi i formulimeve të sakta, mendoj unë.

Është punë tjetër që unë kam parë vullnet edhe para andej, edhe tash, edhe në shtyp, njëfarë vullneti të çuditshëm që të kritikohet Presidenti i Republikës së Kosovës, zoti Fatmir Sejdiu edhe për punë që janë të tij, dhe s'janë të tij. Është problem i njerëzve. Kanë vullnet të kritikojnë dhe kritikojnë. Po, unë po ju them, edhe me Kushtetutën në fuqi dhe me sistemin që e kemi në fuqi, zgjedhjet as te ne, as tjetërkund, ku s'ka republikë presidenciale, askush nuk lyp zgjedhje për ta rrëzuar presidentin e republikës, por lyp zgjedhje për të krijuar qeveri tjetër dhe këtë punë le ta mësojnë këta 120 vetë, më në fund, edhe në parlamentin tonë. Kështu ndodh ajo! Mundet në Francë të kërkojnë zgjedhje të parakohshme për Sarkozyn, që është sistem parlamentar. Në një sistem çfarë kemi ne, zotëri, mund ta keni simpati, antipati një njeri që kryen një funksion publik, konstitucional, por zgjedhje për ta hequr Fatmir Sejdiun ose dikë që do të jetë pas tij, në këtë sistem nuk bëhen. Bëhen zgjedhje për ta ndërruar qeverinë, parlamentin, parlamenti prodhon qeverinë. Dhe, unë po pushoj këtu me këtë... Unë, veç për shkak të sqarimit, se ka shumë nebuloza kur po bisedohet për këto probleme.

U përpoqa t'i dëgjoj të gjithë me radhë dhe është e drejta e opozitës të kërkojë zgjedhje, të parakohshme quhen. Unë do t'ia përmend emrin zotëri Malokut, se e kam kolegë të

nderuar. Mua më duket se ai e ka sublimuar pak a shumë këtë çka po do opozita, me nja tri pika që i tha. Një, mendon që në bazë të rregullës në fuqi, do të duhej të mbahen zgjedhjet. Dy, mendon që zgjedhjet duhet të mbahen se po qeveriset keq dhe, ajo e treta, prapë shkon kah presidenti, jo pozicioni i ngrirë e i shkrirë, që për atë e dhashë, kujtoj, shpjegimin e parë.

Sa i përket zbatimit të rregullës, ju e patë se ka mendime të ndryshme. Ekziston një dokument që quhet propozim i Ahtisarit, që zoti Smaka, le të më lejohet ta përmend edhe këtë, e ka shpjeguar në mënyrë fundamentale sot këtu, që është një propozim që s'është dokument. Është dokument kontraktues politik me Kuvendin e Kosovës, sepse e kemi bërë gurë ku e qesim këmbën për ta shpall pavarësinë, po nuk është dokument i pranuar ndërkombëtarisht në Kombet e Bashkuara. Është dokument që në kontratë me miqtë e pavarësisë së Kosovës është përdorur si argument, për ta mbështetur këmbën, por nuk është dokument ndërkombëtar obligativ, i tipit shumë kontraktues. Dhe, për këtë, unë i besoj juristit, sepse unë i besoj interpretimit juridik. Pra, ata që e bëjnë dokument substancial këtë, thonë se do të duhej për shkak të një neni atje që të mbahen zgjedhjet. Është okej, le ta mbajnë atë vendim, le ta interpretojnë. Unë nuk dua ta interpretoj, po unë dua të shtroj veç një pyetje: ne që duam të jemi sovranistë dhe, u tha këtu, mirë u tha, le të lexohet neni i parë i Kushtetutës, e jo i fundit, është i parafundit. Si sovranistë, ai që është dhe e lexon nenin e parë, atëherë atij, po i drejtohem edhe vetes, se unë kam qejf të jem sovranit, një prej të parëve të tyre. Atëherë, pse të shtrohet dilema a është më i madh një propozim i Ahtisarit sesa Kushtetuta. Nëse jam sovranist, them: jo, jo, unë e dua Kushtetutën, s'e dua propozimin e Ahtisarit. Është punë etike politike. Nuk po them se është më e drejta kjo, por njëri që e mban këtë qëndrim, thotë jam sovranist, thotë: jo-jo, një është kushtetuta, dy-tre, pesë Ahtisari, e tjera, të marrëveshjes. Kaq kisha për të nënvizuar për këtë problem. E pra, Kushtetuta nuk është veç neni 1, që flet për sovranitetin dhe, ai i parafundit, që flet për mandatet e vazhduara të këtij legjislacioni, po flet në të gjitha faqet, sepse një dokument i tillë duhet të lexohet në çdo germë, se çdo germë e kushtëzon tjetrën dhe finalisht për temën që kemi sot, ne kemi një interpretim të dy njerëzve përgjegjës për këtë punë – të Presidentit të Republikës së Kosovës dhe përfaqësuesit... qysh e quajnë tash me këtë emrin e ri, këtë mbetjen e administrimit, se mos kujtoni që ka pak fuqi ky njeri. E ka një fuqi të madhe, prandaj unë po them, jam sovranist, por unë e di që s'është Kosova sovraane e plotë sot. Edhe unë e them para qytetarëve të Kosovës dhe para jush, që ju kam kolegë.

Dhe, le të më falin, në daç le të më replikojnë, në daç jo, janë dy njerëz që i përmenda se e respektoj logjikën çka folën, pa marrë parasysht mendimet.

Sa iu përket zgjedhjeve, prapë më duhet ta përmend Smakën, sepse e përmendi ligjin. Keni kujdes, lexoni mirë ligjet që i kemi. Në Ligjin në fuqi për zgjedhjet, që është, të gjithë shefat aktual të partive, nisur nga Fatmir Sejdiu që e ka mandatin e ngrirë, si kryetar Partie, te Hashim Thaçi, që është kryetar Partie dhe i Qeverisë, te Nexhat Daci, që është shef i Dardanëve, te Pacolli që është shef i të rinjve, te Haradinaj, që është shef i Ardhmërisë – të gjithë njëzëri e kanë pranuar, duke qeshur e duke u kënaqur, këtë ligj. Çka thotë ai ligj? E kanë pranuar se iu garanton që ata e kanë vendin në kryelistë dhe nuk votohen. E, pra, unë zotëri, të gjithëve që po i mbron këto pikëpamje, nisur prej vetes dhe ju të tjerëve, çfarë ndërrimi, çfarë thirrje të elektoratit dhe çfarë ndërrimi politik do të injektojnë të gjithë këta njerëz të cilët e donë një ligj që i bën pronarë të partive të tyre. Unë mendoj se me këtë nuk kanë ndërrua kurrgjë.

Ma lejo vetëm edhe një gjysmë minute, ta them tash krejt personalisht. Nuk flas për partinë, flas personalisht. Unë mendoj që zgjedhjet parlamentare në Kosovë nuk duhet të mbahen, duke lexuar mirë Kushtetutën në fuqi, assesi pa u bërë dy vjet nga miratimi i Kushtetutës. Kjo është për interes të Kosovës. Janë dy mandatet të garantuara proahtisariane, të cilat....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Molim režiju, produžite još pola minute!

SABRI HAMITI... dhe e dyta, unë mendoj që nuk duhet të mbahen zgjedhjet parlamentare në Kosovë pa u bërë regjistrimi i popullsisë. Në Kosovë kurrfarë zgjedhjesh nuk duhet të mbahen pa u bërë regjistrimi i popullsisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala vam, profesore Hamiti!

Ovako, dozvolite mi jedno obaveštenje. Na osnovu Pravilnika rada Skupštine Kosova, pokretač današnje debate o odluci Predsednika Kosova o izborima, bila je Parlametnarna grupa Alijanse za budućnost Kosova, i prema Pravilu 25. Poslovnika Skupštine Kosova i članu 7. kao uvod za današnju debatu imate pravo na minutažu ne više od 10 minuta, a kao zaključak na minutažu ne više od 5 minuta. Izvolite, poslaniče Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Me siguri nuk do të më duhen më tepër se 5 minuta...

Kolegë deputetë,

Ajo që folëm ne sot, prej fillimit, do të thotë, kur e nisa fjalën, ishte se janë 3 aspekte të cilat na shtynë që ta thërrasim këtë debat dhe të marrim vendim. Aspekti i parë është provizionet kushtetuese, të cilat i nxjerrim qartë dhe më vjen keq që duhet ta përsëris edhe një herë për disa kolegë të respektuar.

Neni 143 i Kushtetutës, jo i planit të Ahtisarit, por i Kushtetutës, zotëri Smaka, thotë “Kushtetuta, ligjet dhe aktet tjera ligjore të Republikës së Kosovës interpretohen në pajtueshmëri me propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007 në rast se ka mospajtueshmëri midis dispozitave të kësaj kushtetute dhe akteve, ligjeve dhe normave tjera, marrëveshja mbizotëron”. Do të thotë, unë po e citoj një nen të Kushtetutës. Nuk po e citoj një nen të propozimit gjithëpërfshirës dhe unë nuk e di qysh mund të ketë jurist i cili thotë duhet këqyrë kushtetutën e jo planin. Po, Kushtetutën po e citojmë. Për Kushtetutë po flasim. Ky është nen kushtetues, është provizion kushtetues. Në bazë të këtij provizioni që e kam përmend unë, është edhe një provizion tjetër kushtetues, e ai provizion tjetër kushtetues është një nen tjetër, i cili thotë se përpos, do të thotë neni 161, me përjashtim të rasteve kur ka mënyra tjera, ose kur ka tranzicion tjetër, që është ky rasti që e përmenda pak më përpara, atëherë vazhdon interpretimi qysh e ka bërë Presidenti i Kosovës. Kjo, do të thotë, është ajo për çka kemi folur ne. Ne mendojmë se në bazë të Kushtetutës ka qenë dashur të shpallen zgjedhjet. Po ashtu, ne mendojmë se në bazë të asaj se çka shohim ne si qeverisje, është dashur të ngutemi të shpallen zgjedhjet. Këto janë mendime tona që i kemi thënë prej fillimit.

Tani, më lejoni t’i them dy ose tri fjalë për shumë gjëra që i kemi dëgjuar këtu sot, gjatë diskutimit, nuk do të zgjaten. Ne kemi dëgjuar deputetët që janë profesionistë universalë, që i dinë krejt, dhe çka do që flet dikush, ata dalin dhe komentojnë. Domethënë, janë disa profesionistë universalë, nuk e di çka kanë kryer, por gjithçka dinë, bile-bile dinë edhe t’iu bëjnë analiza psikologjike kolegëve të vetë deputetë.

Mendoj se këta deputetë ndoshta dinë, nuk e di, veç me të vërtetë po del shumë – shumë qesharake kjo formë e komentimit të gjendjes psikologjike të njerëzve. Këtu pati deputetë që e dinë edhe çka kemi ne në ndërdije, secili prej nesh. Bile-bile edhe ju, zotëri kryesues, se u ndërrua kryetari... Tha, ne e dimë çka keni ju në ndërdijen e juaj. Hallall! Krejt në rregull është!

Diçka tjetër është, që u përmend këtu, u përmend që 8 milionë euro janë shpenzim tepër i madh për zgjedhjet. Ndoshta janë. Mirëpo, po ju tregoj juve! 8 milionë janë kursim enorm kur dihet se me dhjetëra miliona po vidhen në Kosovë. Është kursim enorm i parasë publike 8 milion euro për zgjedhje.

Çështja tjetër, çështja tjetër te mbajtja e zgjedhjeve është shumë interesante. Mos harroni se këto institucione që kanë dalë prej zgjedhjeve të fundit janë institucione që kanë dalë prej zgjedhjeve që janë shpallë në bazë të Kushtetutës, të kornizës kushtetuese, më falni,. Tani, po krijohet njëfarë përshtypje se dikujt nuk po i konvenon të shpallë zgjedhje dhe të thotë: – këto zgjedhje shpallen në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. A janë këta njerëz ndërkombëtarë, apo janë të partive në pushtet, unë nuk e di, por të opozitës nuk janë, se opozita po thotë që në Kosovë për herë të parë në histori të saj duhet të shpallen zgjedhje në të cilat shkruan – këto zgjedhje shpallen në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kurrë nuk ka ndodhur! A mos po frikohet ndokush që ndoshta dikush i thotë se s'bën të shpallen zgjedhje në bazë të Kushtetutës, se ka dikush përreth nesh që mund të hidhërohet. Nëse është, le të na tregojnë të paktën, por po ju them se po i vjen një erë shumë interesante gjithë kësaj pune dhe, në fund të fundit, është përmend disa herë lideri i partisë ,të cilin unë e përfaqësoj këtu në Parlament. Po më vjen mirë që shumë deputetë po tregojnë se ku po iu dhemb. Duhet t'i u dhemb se shumë shpejt kemi për t'ju ndërruar. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Ju lutem, unë do t'i them 2-3 fjalë dhe po e mbylлим këtë. Falënderoj Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës që e ka thirrur këtë debat. Profesor, ju lutem! Ju lutem, deputet, absolutisht s'ke të drejtë. Merre lexoje Rregulloren. Dëgjoni, me Rregullore të Punës të Kuvendi, pas fjalës përfundimtare të atij që e ka bërë kërkesën, deputetët nuk kanë të drejtë më, këtë e ka vetëm kryetari. Prandaj, ju lutem, lexoni Rregulloren dhe e keni. Nuk është pjesë e debatit. Ai e ka përmbyllur debatin dhe debati është përmbyllur. Do të thotë, të mësohemi me rregullore dhe t'i respektojmë ligjet. Ju faleminderit!

Pasi shumë nene u lexuan, unë do ta lexoj nenin 146, 147 i cili thotë – pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Kushtetute, përfaqësuesi ndërkombëtar civil në pajtim me propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, është autoriteti përfundimtar në Kosovë lidhur me interpretimin e aspekteve civile të propozimit gjithëpërfshirës dhe ky autoritet e ka dhënë fjalën e vet. Prandaj, respektoni edhe këtë. Faleminderit shumë!

Kalojmë në pikën e dhjetë:

#### **10. Propozimi i GP të AAK-së dhe të PDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare**

Kemi dy njoftime. Ju lutem, shkurt janë. Dy njoftime i kemi.

(Ndërhyrje)

Ju njoftoj se Grupi Parlamentar i AAK-së ka vendosur që anëtar në Komisionin për Punë të Brendshme e Siguri, në vend të deputetit Naim Maloku të emërohet deputeti Ibrahim Selmanaj, ndërsa në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në vend të deputetit Ibrahim Selmani emërohet deputeti Naim Maloku.

Tjetër. Ju njoftoj se Grupi Parlamentar i PDK-së ka vendosur që në Komisionit për Media, Imunitete dhe Rregullore të Punës të Kuvendit, në vend të deputetit Fehmi Mujota të emërohet deputeti Berat Luzha.

Dhe, me këtë e mbyllim seancën. Mirë u pafshim në seancën e radhës, në atë solemne, të martën.

E përgatiti: **Njësia e Transkripteve**